



947.65  
192

Koli Xoxi

**MARKO BOÇARI**

949.65

892

KOLI XOXI

MARKO BOÇARI

(FATOSI I MESOLONGJIT)

1790-1823



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»



Marko Boçari

## SULI DHE SULIOTËT

Suli është një krahinë malore (në Çamëri) rreth 7 orë më këmbë nga deti Jon, afro 50 km në jugperëndim të Janinës; konsiderohej edhe pjesë e Kasiopisë në Epir.<sup>1</sup> Popullsia e këtij vendi ka qenë ortodokse dhe jetonte në fise, farë apo gjini. Për vendosjen e saj në atë krahinë ka mendime të ndryshme. Suli nga të katër anët ka qenë i rrethuar me shkëmbinj, kështjella mbrojtëse natyrore në kushtet e atëhershme, që suliotët i quanin dhëmbë, sepse u ngjanin dhëmbëve.<sup>2</sup> Shkelja e të huajit në këto male ishte pothuajse e pamundur pa luftë.

Me kohë popullsia u shumua dhe nga fundi i shekullit XVII përbëhej prej rreth 100 familjesh. Emri Suli nuk dihet nga e ka prejardhjen. Në bazë të një logjike që nuk përbën një fakt shkencor, një komandant ushtarak osman me emrin Sulo u përpoq të pushtonte krahinën, por banorët morën armët, në betejë e sipër e vranë dhe për nder të fitores filluan ta quajnë vendin e tyre Suli.<sup>3</sup>

1) *Le guerre dei Suliotti contro Ali Bassà di Janina*, f. 1.

2) *Storia di Suli e di Parga, contenente la loro crolonogia, le loro guerre e specialmente quelle de Sulloti con Ali Bascià, Principe della Grecia, scritta in greco volgare da Vuk, Pso, Eksi, Aoka*, Milano, 1912, f. 22.

3) *H. Hristovasilis, Ta Eroika thaynata ton Soulioten qe Souliotidhon*, Londons, 1887, f. 3-4; Perrevu, *Kristo, Istorja tu Sulu*, Athinë 1933, f. 11.

Kjo nuk mund të quhet e saktë dhe për arsye se suliotët ishin autoktonë në trojet e tyre dhe Suli ka patur historinë dhe emrin e vet, megjithëse u bë më i dëgjuar në periudhën e historisë mesjetare dhe asaj të re. Studiuesi suliot Niku Zhagu vëren se suliotët kishin marrë pjesë si luftëtarë në gardën e heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ata qëndruan në Suli gjer në fillim të shekullit XIX si zotër të asaj krahine.<sup>1</sup> Studiuesi arbëresh Furiqi, emrin Suli e nxjerr nga fjala shqipe shul, sepse për të hyrë në atë krahinë duhej kaluar nga një majë mali në formë shuli, prej nga mund të kontrollohej gjithçka, prandaj mori edhe kuptimin figurativ — roje.<sup>2</sup> Afërsisht po këtë mendim mbi pjesëmarrjen e suliotëve në gardën e Skënderbeut ka edhe historiani Anastas Guda<sup>3</sup> dhe të tjerë.<sup>4</sup> Sidoqoftë emri i Sulit hyri dhe mbeti në tërë historinë e Shqipërisë, por edhe në atë të Ballkanit, emri i një vatre të lavdishme antiosmane.

Fakti se suliotët kanë qenë shqiptarë është pohuar nga shumë studiues. Është e natyrshme që të përmendim disa syresh. Përveç burimeve të mësipërme kemi edhe këto. P. A. Sallabanda ka shkruar «Banorët e parë të Sulit ishin të racës shqiptare».<sup>5</sup> Historiani i njohur grek, Jani Kordhatos, ka theksuar se suliotët ishin shqiptarë çamë.<sup>6</sup> Edhe Mendelson Bartoldi pohon se «Suliotët janë pas-

---

1) Niku Zhagu, *I antistasis ton Sulioton qe o Llambro Xhavelas*, Athinë, 1964, f. 8.

2) *Po aty*, f. 8.

3) A. Guda, *Paralili Vii*, Athinë 1870, vëll. 8, f. 47.

4) H. Hristovasil, *Polemi tu Suliu ja tin patridhas*; Athinë, 1901, f. 124. Niku Zhagu, *vep. e cit.*, f. 15 dhe Markos Boçaris Athinë, 1966, f. 13.

5) P. A. Sallabanda, *To Suli, i ti ta iroita thagmata ton Suloton*, qe Sulotidhon, Athinë, 1860, f. 7.

6) Jani Kordhatos, *Neoliniki politiki istoria*, vëll. I, Athinë, 1957, f. 411.

ardhës të krishterë nga kombësia çame».<sup>1</sup> Po kështu edhe Tasos Vurnas.<sup>2</sup> Dora d'Istra i quan suliotët «lavdia e Shqipërisë ortodokse»<sup>3</sup>, ndërsa Pukëvili nënvizon se suliotët janë shqiptarë të papërmbytur.<sup>4</sup> Udhëtari francez Zhan Puzhad vë në dukje se midis tyre «suliotët flasin vetëm shqip», «shqipja është gjuha e tyre dhe ata e quajnë veten shqiptarë».<sup>5</sup> Dhe për këtë ata ishin krenarë.<sup>6</sup> «Suliotët flisnin shqip».<sup>7</sup> Serijani pasi vë në dukje se suliotët kishin prejardhje shqiptare dhe flisnin shqip, mendon që të kenë ardhur nga Dibra e largët dhe lufta antiosmane i lidhte me shqiptarët e krishterë të Çamërisë dhe me grekët përreth.<sup>8</sup> Kosta Biri i quan shqiptarë të ardhur nga fshatrat e Delvinës, që ishin larguar prej andej për shkak se kishin vrarë një turk që u kishte rrëmbyer një vajzë.<sup>9</sup> Kurilla ka shkruar se ai vetë ishte origjinal suliot dhe se suliotët janë shqiptarë dhe flasin shqip<sup>10</sup>.

Deri në ditët tona në More dhe në Greqinë e Veriut është ruajtur një këngë ku, midis të tjerave, thuhet:

---

1) Mendelson-Bartholdy, *Geschichte Griechenlands, von der Eroberung Konstantinopels durch die Turken in Jahre 1453 bis auf unsere Tage*, V. I, Leipzig 1870-1874, f. 31.

2) Tasos Vournas, *Ali Pasa Tepelenes, tiranos e idlophyes politikos*, Athinë, 1978, f. 38.

3) Dora d'Istra, *Excursions en Roumélie et en Morée*, Zurich, Paris, 1867, f. 253.

4) F. C. H. L. Pouqueville, *Histoire de la régénération de la Grèce*, Livre premier, f. 70.

5) Eugène Poujade, *Chrétiens et turcs, scènes et souvenirs de la vie politique, militaire et religieuse en Orient*, Paris 1859.

6) Aristidhis P. Koliass, *Arvanites qe i takagogji ton elinon*, Athinë, 1983, f. 244.

7) H. Hristovasilis, *Suliotet qe lapides*, Athinë, 1905, f. 10.

8) Jorgos N. Seriani, *Dhimiurgjia anaptikis qe o skimatismos tis suliotikis simpolitios*, Janinë, f. 16-18.

9) *Po aty*, f. 21.

10) Aristidh Koliass, *vep. e cit.*, f. 358.

*Kjo gluha arbërishte  
Është gluhë trimërishte  
E flit Navarko Miauli  
Boçari dhe gjithë Suli.*

X  
Kështu në qoftë se nuk është vendosur ende përfundimisht se prej nga kanë ardhur suliotët në Suli, apo ndoshta kanë qenë atje që në kohët më të lashta, është më se e provuar se ata kanë qenë shqiptarë. Ata kishin traditat e tyre, visheshin, mbatheshin, gëzonin, vallëzonin, këndonin, vajtonin, jetonin dhe luftonin si shqiptarë. Shkaku themelor i qëndrimit në ato male dhe i luftës së ashpër që bënë për të mos u shkullur prej andej, ka qenë që të mos binin në kthetrat e pushtuesve osmanë. Pavarësisht se shumica dërrmuese e tyre ishin analfabetë, dashuria për lirinë ishte lumturia më e madhe për ta. Kjo është arsyeja që ata u bënë luftëtarë të pashembullt antiosmanë në të gjithë perandorinë e sulltanëve. Ndoshta këtej vjen edhe emri Suli, «Su-ul» (nuk u përkul).<sup>1</sup>

Banorët e Sulit në fillim ishin vendosur në katër fshatra shkëmborë afër njëri-tjetrit: Suli, Qafa, Avariku, Samoniva. Në fshatin Suli banonin nëntëmbëdhjetë fise ose fara të përbëra nga 450 familje me rreth 2000 anëtarë nga i njëjti gjak. Fiset më të rëndësishme ishin ata të Xhavellajve, Boçarëve, Drakove, Dangëllive, Kuconikëve, Karabinëve, Malamejve, Buzëve, Kallogjerëve, Zarbenjëve, Papajanëve, Shahinëve. Në Qafa ishin katër fise që kishin 90 familje me afro 360-400 anëtarë. Këta ishin: Zervat, Pantazenjtë, Nikajt, Fotenjtë; në Samonivë ishin tre fise: Bejkot, Dangëllenjtë dhe Irajt me 50 familje dhe rreth 200-250 anëtarë; në Avariku ishin tre fise: Salarenjtë, Bufajt dhe Xhorazët. Me kohë të katër fshatrat morën emrin e përgjithshëm Suli.<sup>2</sup> Thuhet se familja e parë e vendosur në krahinën e Sulit ka qenë ajo e Zervatëve, nga fshati Zerva i Artës, pastaj ajo e Boçarëve

1) Aristidh P. Kolias, *vep. e cit.*, f. 362.

2) Jorgo M, Serijani, *vep. e cit.*, f. 25.

nga fshati Dragani, e Drakove nga fshati Martani i krahinës së Lamarit, i Buzbatëve nga fshatrat e Vallakisë, e Dangëllive nga Fanari.<sup>1</sup> Po të jetë kështu duhet pranuar se suliotët e parë të vendosur në Suli kanë qenë fshatarë nga fusha e Çamërisë.

Disa familje suliote u larguan nga katër fshatrat e mësipërm dhe me kohë formuan në rrëzë të malit shtatë fshatra të tjerë: Cekurin, Alpohorin, Gjonolën, Perihatin, Vilën, Kondatin dhe Çifligun. Këto 11 fshatra në fillim i paguanin detyrimin spahiut me qendër në Janinë. Çdo i martuar i paguante 30 ovulla në vit, beqarët 10, një të dhjetën e gjalpit e të djathit, ndërsa për prodhimet e tjera si gruri, misri, fasulet nuk paguanin sepse nuk konsideroheshin prodhime të Sullit.<sup>2</sup> Me kalimin e kohës ky detyrim, për shkak të forcimit të bashkësisë suliote që nuk i druhej më armikut, filloi të mos paguhej, gjë që duhet të ketë ndodhur andej nga viti 1740, sepse deri në këtë kohë ndeshjet e suliotëve me armiqtë përreth kishin patur si qëllim kryesor mbrojtjen e vendit.<sup>3</sup>

Në luftë e sipër me osmanët të shtatë fshatrave iu shtuan edhe 60 të tjerë të krishterë e myslimanë, të cilët u paguanin suliotëve detyrimet. Më kryesoret ishin: Zavruho, Gliqi, Potamia, Nemica, Kacanohori, Januzi, Zaravina, Gorica, Koritiani, Koroni, Koronopuli, Qeli, Turkopaluko, Spathari, Skandali, Shalësi, Kulluri, Cangari, Stanovo, Mukovina, Dragoveci, Ardoshi, Sistruni, Romano, Alpohori, Vila, Sericani, Dervizani, Golemi, Lipa, Toskësi, Çifliku, Zhermi etj., të cilët gjendeshin 7 km larg Sullit.<sup>4</sup>

Ata shtriheshin në krahinat e Paramithisë, Fanarit, Artës dhe Margëllicit.<sup>5</sup> Në qoftë se banorët e të shtatë

---

1) Niku Zhagu, *I antistasis...* f. 11-12.

2) *Storia di Suli e di Parga...* f. 23-24.

3) Joanu Llambridhu, *Epirotika Istorika Meletimata*, vëll. X, *Suliotika*, Athinë, 1904, f. 21.

4) Kristu Pervu, *vep. e cit.*, f. 15-16.

5) H. Hristovasilis, *vep. e cit.*, f. 78.



fshatrave quheshin suliotë, të tjerët quheshin parasuliotë. Këta u paguanin një detyrim vjetor fiseve sulioete prej të cilave vareshin. Popullsia e parasuliotëve arrinte në 7000 veta.<sup>1</sup> Fshatrat Hojka, Turkopaluko dhe Stanovo i paguanin detyrimin fisit të Dangëllive, Potamia-Xhavelljave, Romano-Mallamenjve, Nemica-Zervatëve, Palahori-Boçarajve, Sistruni, Skiadhia-Kuconikëve.<sup>2</sup> Heteristi Perevu thotë se këtë detyrim nuk e paguanin me kënaqësi, por e kishin të qartë se po të pushtohej Suli nga osmanët, pavarësisë së tyre do t'i vinte fundi njëherë e mirë dhe do ta pësonin keq.<sup>3</sup> Me një fjalë ata e konsideronin varësinë nga suliotët njëfarë çlirimi. Kështu fiset sulioete që merrnin këtë detyrim ktheheshin në feudalë të vegjël. Megjithatë, ata shpeshherë i punonin vetë tokat, që vareshin prej tyre. Kështu vepronte Gjergj Boçari me qetë e tij në tokat pranë Ruciatës, si edhe të tjerë në Palohori, duke i mbjellë këto toka me misër dhe oriz.<sup>4</sup>

Në kohë luftime parasuliotët u bënë shërbime të ndryshme luftëtarëve suliotë, duke i furnizuar me municione, ushqime dhe ujë. Në fund të shekullit të XVIII të shtatë fshatrat së bashku me ata të parasuliotëve përfshinin territorin midis Filipiadhës, Carkavicës, Paramithisë, Margëllicit dhe Pargës. Shtatë fshatrat në kohë luftime nxirrnin një forcë ushtarake prej rreth dy mijë vetash të armatosur. Suliotët që vetë ishin të përbërë gjithsej prej 47 fisesh tani ushtronin kontrollin e tyre mbi 60 fshatra.

Rendi ekonomik, shoqëror e politik i suliotëve ishte i prapambetur në krahasim me fshatrat përreth. Toka arë pothuajse mungonte dhe i vetmi profesion i tyre ishte blegtoria. Kjo ishte pronë private, ndërsa kullotat dhe pyjet ishin kolektive. Diferencimi ekonomik, pra, ishte bërë, paria e pasur kishte kope të shumta bagëtish,

1) Niku Zhagu, *I Antistasis...* f. 27.

2) Jorgos M. Seriani, *vep. e cit.*, f. 34; Joanu Llambridhu, *vep. e cit.*, f. 28..

3) Kristu Perevu, *vep. e cit.*, f. 15.

4) Joanu Llambridhu, *vep. e cit.*, *Suliotika* f. 30.

ndërsa anëtarët e thjeshtë të bashkësisë — të pakta. Zëj-taria dhe tregtia nuk njiheshin, kallajxhinjtë apo rroba-qepësit ishin të ardhur. Ushqimet e nevojshme që nuk u mjaftonin dhe armët i siguronin nëpërmjet sulmeve kundër bejlerëve dhe agallarëve shqiptarë, ose kundër pasanikëve grekë kudo që ishin. Në rast fitoreje, pjesën më të madhe të plaçkës e merrnin komandantët, kapedanët e tyre, teprica ndahej midis luftëtarëve të thjeshtë. Kishte raste kur fiset më të varfëra, me nismën e tyre, organizonin inkursione fitimtare dhe atëherë plaçkën e ndanin sipas numrit të pjesëtarëve të familjes në ngarkim.

Mbledhja e të gjithë suliotëve të seksit mashkullor të të katër fshatrave ishte njësia themelore e qeverisjes së të gjithë banorëve të Sulit. Ajo merrte në shqyrtim çështjet kryesore dhe vendoste për ato më themeloret. Në të merrnin pjesë edhe fëmijët mbi 5 vjeç. Ajo zgjidhte këshillin e pleqve, pleqësinë, nga anëtarët e fiseve më të pasura, ndër të cilët më kryesorët ishin Xhavellajt dhe Boçarët. Pleqësia zgjidhte edhe komandantin e përgjithshëm të ushtrisë, zakonisht nga dy fiset e mësipërme, por më të urtin dhe më trimin. Këta nuk ishin të përgjithshëm por të zëvendësueshëm. Familjet e veçanta brenda fisit ishin lidhur shumë ngushtë njëra me tjetrën. Babai i çdo familjeje ishte i tërëpushtetshëm. Po të vdiste ai, vendin e zinte nëna. Gruaja suliote kishte një vend të shquar në bashkësinë suliote. Ajo konsiderohej forca prodhuese e luftëtarëve pa të cilët ajo bashkësi nuk mund të ekzistonte dhe po të ishte nevoja i vishte vetë armët për luftë.

Nga gruaja kërkohet një moral i lartë. Gruaja suliote nga burri i ardhshëm kërkonte mbi të gjitha trimërinë, frikamanin e urrente. Për trimërinë e gruas suliote historiani dhe poeti francez Alfons de Lamartin ka shkruar: «Është e vështirë të merret me mend kurajua që ato tregojnë në luftën partizane».<sup>1</sup> Gratë suliote vdisnin duke

---

1) Alphonse de Lamartine, *Le dernier chant du pèlerinage de Childe Harold en Orient*, A Genève, 1825, f. 155.

luftuar krah për krah me burrat e tyre, të tjerat për të mos rënë në duart e osmanëve asgjësonin veten dhe fëmijët. Vrasësi i gruas së pafajshme merrte dënimin kapital sepse mendohej se i kishte hequr shoqërisë nënat e fëmijëve të mëvonshëm, luftëtarë të bashkësisë. Si duket gjurmët e matriarkatit ndiheshin edhe në atë shoqëri patriarkale. Megjithatë, vendimet e rëndësishme të politikës së brendshme e të jashtme i zgjidhte pleqësia e bashkësisë suliote, e cila quhej ndryshe gjykata e vendlindjes. Vendimet e përgjithshme, si rregull, merreshin verbalisht dhe ishte e drejta e pleqësisë të kërkonte zbatimin rigoroz të tyre. Kishte raste kur vendimi merrej me shkrim dhe shoqërohej me vulën, e cila në mes kishte një shqiponjë me një kryq dhe përreth fjalët: «Gjykata e vendlindjes». Për çështjet kryesore që shtronte për diskutim, pleqësia thërriste edhe kryetarët e familjeve. Mosmarrëveshjet e vogla brenda familjeve i zgjidhte kryetari i fisit, ndërsa çështjet që kishin të bënin me parasullotët i zgjidhte pleqësia e shtatë fshatrave me përjashtim të rasteve të veçanta kur vendosej bashkarisht vetëm nga pleqësia e katër fshatrave.

Në goftë se një anëtar i një fisi fyente anëtarin e fisit tjetër, fyerja i përkiste tërë fisit të të fyerit. Kishte kontradikta midis fiseve, që pleqësia përpiqej t'i zgjidhte me drejtësi dhe durim që të mos ndodhte përçarja.

Fisi nuk ishte krejt i mbyllur për anëtarët e fiseve të tjera. Ai pranonte anëtarë nëpërmjet vëllamërisë apo adoptimit. Në këtë rast vëllami ose «biri i adoptuar» gëzonte të drejta të barabarta me anëtarët e tjerë. Zakonisht ishin pjesëtarët e katër fshatrave që pranoheshin me kusht që të ishin të dalluar në betejat për trimëri e guxim. Nga të gjitha këto del se bashkësia e suliotëve ndodhej në etapën përfundimtare të shthurjes së bashkësisë primitive, në atë të demokracisë ushtarake, kur klasat antagoniste në kuptimin e vërtetë të fjalës ende nuk ishin formuar, pra as shteti, që do të qëndronte mbi popullin, ndërsa luftërat e suliotëve për qëllime mbrojtjeje ishin dukuri të zakonshme.

Marrëdhëniet patriarkale ishin shumë të forta tek ato. Por ato u ruajtën edhe nga domosdoshmëria e mbrojtjes nga jashtë. Kjo demokraci ushtarake krijonte një unitet më të fuqishëm nga ai i viseve ku sundonte feudalizmi ushtarake osman, me kontradiktat e tij të brendshme antagonistike. Shoqëria sulioete ishte shumë më monolite nga kjo e dyta. Tek ajo ndiheshin fort veti të tilla, si: ndershmëria, çiltërsia, bujaria, besnikëria, trimëria, disiplina, respekti dhe dashuria. Suliotët nuk e njihnin rushfetin dhe nuk paguanin kurrë për të shpëtuar nga të tjerët; «nuk e njohin këtë zanat, gjithçka e fitojnë me hekur, me zgjuarësi, mënyra më të sigurt dhe më bujare».<sup>1</sup> Udhëtarë anglez Holland kishte arsye kur shkruante: «Suliotët kanë trimëri të rrallë».<sup>2</sup> Ishte rendi fisnor që u kishte siguar atyre mbijetesën për një kohë të gjatë, pa u kaptuar në raji. Kjo nuk do të thotë se nuk kishte kontradikta. Ishte krijuar ftohtësi midis Xhavellajve dhe Boçarëve dhe nuk bënë krushqi me njëri-tjetrin. Thuhet se prindët e të dy fiseve donin të vendosnin ngrohtësinë duke martuar Gjergj Boçarin, gjyshin e Marko Boçarit, me një vajzë të Xhavellajve, por ai jo vetëm nuk pranoi, por u largua nga Suli për aq kohë sa ajo u martua me një tjetër.<sup>3</sup> Megjithatë, kur rreziku kërcënonte Sulin të gjithë pajtoheshin.

\*  
\*   \*  
\*

Që nga themelimi i bashkësisë sulioete deri më 1730 përmenden rreth gjashtë ekspedita osmane kundër saj. Ato dështuan që të gjitha dhe suliotët dolën fitimtarë. Ekspeditat ishin: ajo e Ali Pashës (1721), e Mustafa Pa-

1) *Le guerre de Sullioti...* f. 17.

2) Henry Holland, *Travels in the Jonian Isles, Albania, Thesaly, Macedonia etc, during the years 1812-1813*, v. 2, London, 1819, f. 213.

3) Niku Zhagu, *I antistasis...* f. 19.

shës (1754), e valiut të Delvinës (1759), e Mazut agait nga Margëlliçi (1762), e Sulejman Çaparit (1772), e Kurt Pa-shës (1778). Ky i fundit u detyrua të tërhiqet nën goditjen e Gjergj Boçarit, gjyshit të Markos. Suliotët u bënë tmerri i feudalëve përreth. Kjo nuk ishte diçka e vogël në ato rrethana, kur Perandoria Osmane e mbante ende kokën përpjetë në Ballkan dhe territori i saj mbetej i paprekur, pavarësisht nga përpjekjet e venecianëve për të depërtuar në Peloponez, austriakëve në Ballkan apo rusëve në Detin e Zi. Prandaj luftërat fitimtare të suliotëve ngritën lart dëshirën për liri në të gjithë Epirin e Jugut, në Akarnani e gjetkë ku më vonë u zhvillua lëvizja e komitëve që në Greqi do të merrte emrin kleftike. Në vitin 1750 bashkësia e Sulit numëronte 80 fshatra me një popullsi prej 25.000 frymësh. Kjo ishte pasojë e burrërisë së suliotëve, e luftës së tyre të drejtë. Lufta e suliotëve, kontribuoi shumë për fitoren e luftës për pavarësinë e Greqisë në vitet 1821-1829. Me kujtimin e këtyre luftërave u rrit dhe u edukua më vonë fatosi Marko Boçari, të cilin e kanë quajtur ndryshe Shqipja e Sulit, Shqipja e Samonivës apo Marko Suli, figura e të cilit u bë ajo e një luftëtari legjendar.<sup>1</sup>

Familja e Boçarëve ishte nga më të vjetrat e më të dëgjuarat e bashkësisë sulioete. Burrat më të shquar të saj, deri më 1821-1829, kanë qenë: Spiro Boçari, kryetari i saj i parë me sa mbahet mend, pastaj i biri i tij Qiriako (1680-1755), djali i këtij Gjergji (1719-1803), i martuar me sulioten Dhespo Kuconikën, me të cilën pati 4 djem e 1 vajzë: Tushen (Thanasin), Kiçon, Notin, Nikitën dhe Marian. Tusha pati një djalë me të njëjtin emër për arsye se lindi menjëherë pas vdekjes së të atit, i cili nuk la trashëgimtarë të tjerë. Tusha ra në gjak me Çaraprenjtë dhe u vra prej tyre pabesisht. Vendin e tij si kryetar i fisit e zuri i vëllai Kiço Gjergj Boçari, i cili u martua tri herë, lindi 18 fëmijë, nga të cilët

1) Stefanu i. Papadhopullu, *To Mesolongji qe o Filelinismos*, Janinë, 1978, f. 28.

5 i vdiqën të vegjël. Nga martesë e parë me Krisulla Papazoti Jotin pati këta fëmijë: Janin, Helenën (Lenin), Marian, Anastasinë dhe fatosin tonë të ardhshëm, Markon. Djali tjetër i dëgjuar i Kiços, si duket me martesën e dytë, ka qenë Kostandin (Kosta) Boçari, i cili u shpall udhëheqës i suliotëve pas vrasjes së Markos. Nga martesë e dytë Kiços i rrojti, përveç Kostës, një vajzë, Angelika. Ndërsa nga e treta, pas vitit 1804, pati katër fëmijë: Helenën, Nikollën, Gjergjin dhe Stratin.

Vëllai i Kiços, Noti Boçari, ishte martuar me Kristina Bejkon sulioete, me të cilën pati 12 fëmijë. Njëri prej tyre, Gjergji, u vra në Korfuz, Thanasi në Revolucionin Grek, Vasilika, po ashtu, pas betejës së Mesolongjit, Dhespon dhe Dhimitrin. Ka një mendim se Tushi Boçari, nënkomandant i reparteve të Marko Boçarit, që mori pjesë në betejën pranë Karpenisit, mbeti i vrarë në betejën e Falirës. Ai ka qenë kushëri i parë i Markos, ndoshta biri i Notit. Noti Boçari mori pjesë në luftërat e Sulit kundër Ali Pashë Tepelenës dhe në vitin 1804, u plagos rëndë e u kap rob. Aliu e dërgoi në Këlcyrë (Përmet) prej nga u largua dhe u strehua për pak kohë te Kurt Pasha në Berat. Më vonë Aliu e fali. Noti u kthye te ai dhe u bë vëllam me të birin e Aliut, Veliun, çka e vuri në dyshim pashanë e Janinës. Pastaj shkoi në Volo, në Hidra dhe më në fund arriti në Korfuz. Kur Ali Pasha u ngrit më 1820 kundër sulltanit, Noti kaloi në Prevezë për të ndihmuar vëllamin e tij, Veliun. Pas kësaj ai u bashkua me të atin dhe mori pjesë aktivisht në Revolucionin Grek.

\*

\* \*

Një gabim i rëndë i Ali Pashës ka qenë lufta e tij kundër shqiptarëve të Sulit, e cila, megjithëse e shtytur nga sulltani, ishte thjesht një luftë midis shqiptarëve ortodoksë dhe bejlerëve myslimanë. Suliotët me të drejtë u ngritën si heronj në sytë e opinionit publik botëror

përparimtar, ndërsa figura politike e pashait ra mjaft. Suliotët shikonin te presioni i vazhdueshëm i Aliut, dëshirën që ata të ktheheshin në raja të tij, gjë që për ta ishte e papranueshme. Bashkësia sulioete ishte autonome brenda pashallëkut. Në vitin 1820 suliotët u bashkuan me Aliun, sapo ai pranoi që të ktheheshin në malet e vendlindjes, ku qenë varrosur stërgjyshërit, etërit dhe të afërmit e tyre. Po kjo ndodhi kur Ali Pasha e kishte pisk me Portën e Lartë.

Në malet që jetonin, suliotët e kishin ushqimin të pamjaftueshëm për familjet e tyre. Për ta siguruar, ata shkonin deri në viset e largëta të Epirit dhe në fushat e Tesalisë.<sup>1</sup> Në këto sulme që nuk ishin të shpeshta, ata ktheheshin në komitë dhe i goditnin fort armiqtë. Komitëria apo klefturia ka qenë një formë lufte, një protestë e fuqishme shoqërore<sup>2</sup> kundër pushtuesit të huaj, kur nuk ekzistonte bashkimi dhe organizimi. Me këtë protestë komitët ndihmuan që lufta e tyre të kthehej në revolucion kombëtar.

Ali Pasha nuk bëri asnjë dallim midis pashallarëve e bejlerëve shfrytëzues dhe suliotëve liridashës. Ai i trajtoi ata njëllëj. Suliotët, megjithëse të paktë në numër, në krahasim me forcat e Aliut, qenë shumë kompaktë. Pashai i Janinës nuk u përpoq seriozisht që t'i bënte ata për vete duke i marrë në shërbimin e tij ushtarak, prandaj për suliotët Ali Pashai ishte një me sunduesin osman.

Për t'u mbrojtur ata kërkonin armë, ndaj kthyen sytë nga bejlerët e Çamërisë, nga Venediku, nga rusët e vendosur në Shtatë Ishujt, si dhe nga francezët, duke i shkaktuar Ali Pashës telashe të mëdha. Koloneli francez Vutje, që i kishte njohur mirë, thotë se suliotët e shikonin trimërinë si një dhunti të natyrës. Për ata ishte njëllëj mposhtja e armikut në pritë apo në ndeshjet trup me trup. Një njeri nuk u dukej atyre i përshtatshëm për luftë në qoftë se nuk tregohej i palodhur në mar-

1) *Historia e Shqipërisë*, vëll. I, (1959), vep. e cit., f. 456.

2) Spyros Asdhrahas: *Zitimata Istorias*, Athinë, 1983, f. 133.

shim, nuk kënaqej me ushqim të paktë, nuk duronte urinë dhe etjen, nuk kishte syrin e mprehtë dhe nuk i dallonte mirë sendet dhe njerëzit gjatë natës së errët.<sup>1</sup> Ushtarë të tillë duhej t'i pëlqenin Ali Pashës dhe jo të përpiquej t'i nënshtrohte ata me dhunë.

Ali Pasha e bëri këtë me nxitjen e Portës së Lartë së cilës i interesonte ta izolonte Aliun nga forcat serioze brenda vendit e t'i krijonte atij armiq. Ali Pasha nuk arriti ta kuptonte dredhinë e armikut të vet.

Në fund të vitit 1803, ushtria e madhe e Aliut i theu më në fund forcat e pakta suliothe. Por dështimi i suliotëve, qoftë edhe me pasoja të rënda që një fitore morale për ta. Dhembja e suliotëve që shumë e madhe. Ajo vihet re në këtë vajtim popullor:

*Të të zinte një rrebeshe o Kak-Suli i mjerë,  
Si ishe, si u katandise që të shkelën turqit,  
Ju zogj fluturak që ecni nëpër ajër,  
Çoni haber në More, te kapedan Markoja  
I thoni përshëndetje nga Kako-Suli,  
E morën Sulin, e morën, morën dhe Avarikun,  
Qafën kryelartë, Kunjin e dëgjuar.<sup>2</sup>*

Pjesëmarrja në shërbimin ushtarak të të huajt, nuk i bëri krerët suliotë vegël të shteteve të asaj kohe. Qëllimi i tyre ishte që në aleancë të përkohshme me ta, të dobësonin Perandorinë Osmane në Ballkan, të rrëzonin Ali Pashën, të fitonin lirinë dhe të ktheheshin në vendlindje. Ata nuk shpresonin shumë, aq më pak nga Rusia, ndaj së cilës u zhgënjyen krejt. Në një këngë shohim se ata ankohen për komandantin e tyre Foto Xhavella, që i pajtoi tek ushtria ruse në Shtatë Ishujt, prej së cilës

---

1) Voutier Colonel, *Memoires sur la guerre actuelle des grecs*, Paris, 1823, f. 216-217.

2) Niku Zhagu, *I antistasis...* f. 172.



nuk fituan asgjë. Dhe ata qanin për vendlindjen e tyre dikur të lirë që me gjithë gjakun e derdhur s'kishin qenë në gjendje ta mbronin.

*Ti more Foto Xhavela,  
Seç na bëre me kapella,  
Seç u premë e seç u vramë,  
Sul e shkretë ku e lamë?  
Ali Pashait ia dhamë.  
Natë e ditë rrimë e qajmë,  
Fati në Korfuz na hodhi,  
Të vemë të marrim vendin,  
Vemi e vdesim në dhe tënë,  
Atje tek e patëm thënë,  
Vdesim me dyfek në dorë,  
Si dhëndurë me kurorë.<sup>1</sup>*

Suliotët qenë dëbuar me dhunë nga vendi. Ata kurrë nuk kishin shërbyer vetëm për të holla. Qëllimi i tyre ishte dobësimi i pushtetit osman në tërë Gadishullin Ballkanik. Kjo qe arsyeja që ata u bashkuan me Ali Pashën në vitin 1820 dhe pas vrasjes së këtij u hodhën në Revolucionin Grek gjithmonë me kusht që të ishin të lirë në vendin e tyre. Në takimin që pati me Noti dhe Marko Boçarin në fillim të vitit 1820, Ali Pasha i tha të parit: «O Boçar i urtë, të përqafojmë çështjen e për-bashkët». — «Po zotëri, u përgjigj sulioti, por si njerëz të lirë, sepse ju e keni provuar se skllëverit, gjithnjë e braktisin çështjen e princërve.»<sup>2</sup> Ali Pasha nuk e kishte kuptuar më parë këtë veçori fisnike të suliotëve, merita e madhe e të cilëve është se kur u bashkuan me të i qëndruan atij besnikë deri në fund. «Virtuti i dëgjuar shqiptar dhe besa triumfoi edhe njëherë».<sup>3</sup>

1) I. M. Qafzezi, *Marko Kio Boçari*, AIH, dosja nr. 11.

2) F. C. H. L. Pouqueville; *vep. e cit.*, f. 209.

3) Vurnas asos, *vep. e cit.*, f. 114.

Merita e Marko Boçarit ishte se për çështjen e përbashkët të popujve shqiptar e grek ai hodhi prapa kra-hëve ngjarjet e hidhura dhe të dhimbshme të së kaluarës dhe e ndihmoi çiltërsisht Ali Pashën deri sa ky u vra. Njohja me idetë e Revolucionit Francez, që i përhapte ushtria franceze e Napoleonit, ushtri në të cilën kishte bërë pjesë për ca kohë edhe Marko Boçari, e kaliti atë si revolucionar të vërtetë. Prandaj edhe historiani rumun, N. Jorga e quan atë «Heroi revolucionar Marko Boçari».<sup>1</sup> Shqiptarët e Sulit e kishin ringjallur frymën e qëndresës në popujt e Ballkanit<sup>2</sup> dhe përfaqësuesi i tyre i ardhshëm më në zë, këtë ringjallje do ta çonte më tej me guxim dhe burrërinë e tij. Niku Zhagu me të drejtë thotë: «Qoftë e bekuar ora kur kjo pjesë e lumtur e Shqipërisë u tregua aq e gjallë, goditi aq shumë armikun me qëndresën e saj dhe na la për sot e për nesër këngën e lirisë:

*Në stere nuk rron peshku  
Dhe as luleja në rërë,  
Dhe suljotët nuk rrojnë  
kurrë pa lirinë<sup>3</sup>*


Megjithatë, nuk është plotësisht i saktë mendimi i origjinës së suliotëve nga garda e Skënderbeut. Ai mbetet vetëm një traditë me vlerë. Ata kanë qenë aty që në kohët më të lashta, në qoftë se është e vërtetë se edhe romakët i konsideronin ata si edhe shqiptarët e tjerë të panënshtueshëm.<sup>4</sup> Për shkak të famës së tyre prej-

1) N. Jorga. *Les voyageurs français dans l'Orient européen*, Paris, f. 123, shënimi 2.

2) Catherine Koumarianon, *The Contribution of the Intelligentsia to War the Greek independence Movement, 1798-1821*, në *The Struggle for Greek independence*, 1973, f. 73.

3) Niku Zhagu, *I antistasis...* f. 26.

4) G. A. Henty, *In Greek Waters: A Story of the Grecian war of independence (1821-1827)*, London, 1893, f. 40.



ardhjen e suliotëve dhe të Boçarajve e pretenduan hungarezët, serbët, rumunët e bullgarët<sup>1</sup> por historia, kjo mësuese e përjetshme e njerëzimit, e kreu detyrën tërësisht, duke i lënë ata siç kishin qenë: shqiptarë të kulluar.

Njëri nga luftëtarët e mëdhenj të Revolucionit Grek, Theodor Kollokotroni, me bindje vinte në dukje se njëra nga kështjellat e lirisë, në luftë për pavarësi, kishte qenë Suli.<sup>2</sup> Marko Boçari, përfaqësuesi më i denjë i kësaj kështjelle, u bë njëra nga shtyllat e asaj lufte. Ai shquhej për fisnikëri shpirtërore, gjykim dhe trimëri, që e bënë atë më të dëgjuar nga të gjithë kapedanët e kryengritjes greke.

Pa u dëshpëruar në vitet e zymta, pa eufori në ato të sukseseve, stoik në çastin e rrezikut, ai shkroi një nga faqet më të bukura të historisë së dy kombeve: shqiptar dhe grek.

---

1) V. A. Ikonomu, *To Suli*, f. 19.


2) Terceti, *Erga*, 1958, v. I, f. 179.

Shkëmb i Sulit



Fshati Qafa në Suli





Kulla e Ali Pashës në Suli



Grua suliote



Tip sulioti



Marko Boçari  
në rininë e tij

Shtëpia e Gjergj Boçarit (gjyshit të Markos) në Suli



Kosta Boçari  
(vëllai i Markos)



Roza Boçari  
(vajza e Markos)



## RINIA

Marko Boçari lindi në Suli, në vetë fshatin me këtë emër. Për vitin e lindjes ka mendime të ndryshme. Sami Frashëri jep vitin 1789<sup>1</sup>, në enciklopedi të tjera gjejmë vitin 1788<sup>2</sup>. Data e vërtetë e lindjes është viti 1790, me të cilën janë të një mendimi studiues të ndryshëm.<sup>3</sup> Ai është biri i Kiço Boçarit, një nga kapedanët më në zë të suliotëve. E ëma kishte qenë një nga heroinat e luftës kundër Ali Pashë Tepelenës në korrik 1792. Kjo la foshnjën mënjane dhe nën urdhrat e Mosko Xhavelës së bashku me katërqind gra të tjera sulioete ndihmuan burrat për të mposhtur kundërshtarit.<sup>4</sup> Për herë të parë fëmija dyvjeçar vështronte një betejë të rëndë. Ndoshta ajo që për të klasa përgatitore e shkollës së luftës për liri. Për vëllezërit dhe motrat e tij u bë fjalë më lart. Dimë se një nga motrat e Markos ka qenë martuar me Gjergj Lolio Suliotin, gjyshi i të cilit, Panoja, pas rënies së Sulit, bashkë me disa suliotë të tjerë, u vendos në

---

1) Sami Frashëri, *Kamus-ul'Alam*, vëll. 2, f. 1368.

2) *The Enciklopedia Britannica*, vëll. 3, 1929, f. 957, *Der Grosse Boochausse*, vëll. 1, 1926, f. 200, *Enciclopedia Hoepli*, vëll. 1, 1963, f. 745.

3) Jani Benekos, *I Alithi Suliotes*, Athinë 1966, f. 85.

4) Niku Zhagu, *Markos Boçaris*, f. 15.



Dardhë të Korçës, prej nga më vonë u largua për në Mesolongj.<sup>1</sup>

Mësimet e para Markoja i mori në fshatin e lindjes. Mësuesi i tij i parë thuhet se ka qenë murgu shqiptar Samuel<sup>2</sup>, i cili, në dhjetor 1803, për të mos rënë në duart e Ali Pashës, me disa suliotë të tjerë hodhi në erë depon me barut në Qyngji, ku u vranë të tërë. Ai nuk ishte nga Suli, por ai u shkri kaq shumë me suliotët sa që nuk dallohej më prej tyre. Gjuha e përbashkët shqipe kishte ndihmuar shumë për këtë.<sup>3</sup>

Fëminia e Markos kaloi në periudhën e vështirë dhe heroike të luftës së suliotëve kundër pashait të Janinës. Në muajt e fundit të vitit 1800, për shkak të mosmarrëveshjeve me pjesën tjetër të parisë së suliotëve, sidomos me Xhavellajt, familja e Boçarajve u largua nga Suli. Babai i Markos, Kiço Boçari, ishte përpjekur të gjente gjuhën e pajtimit midis suliotëve dhe Ali Pashës. Por pas vrasjes së disa suliotëve në Renjasa, në dhjetor të vitit 1803, Kiço Boçari u pendua për veprimin e tij. Për këtë ai dërgoi pranë Aliut në Janinë dhëndrin e vet, Palaskën, për të hetuar për ngjarjet në Renjasa. Pashai i qe përgjigjur se ai s'kishte pasur gisht në këtë dhe e këshillonte Kiço Boçarin që të kthehej në Janinë me shokët e tij e të banonte atje. Me t'u kthyer, Palaska u tregoi suliotëve të Boçarit propozimin e Aliut. Kiçoja e kuptoi djallëzinë e vezirit, qëllimi i të cilit ishte të zhdukte suliotët dhe atë vetë. Zëri i Sulit e detyroi<sup>4</sup> që të marrë vendim të kundërt e të matej me luftë. I vetëdijshëm se forca shumë të mëdha do të sulmonin suliotët, Kiço Boçari i bindi bashkëvendësit e tij (ishin 1148 veta) që të largoheshin për në Agrafa, nga ku mund të mbro-

---

1) Zenko Spiru, *Viografia Polikarpi tu Dhatdheu Mitropolitu Larisas*, Athinë, 1927, f. 131.

2) Titos P. Jochallas, *To elleno alvanikon leksikon tu Marko Boçari*, Athinë 1980, f. 6.

3) Niku Zhagu, *I antistasis*, f. 159.

4) *Po aty*, f. 99.

heshin më mirë. Më 2 janar 1804 ata arritën në fshatin Selcë, në rrëzë të malit Nikozi, ku gjendej edhe një manastir pranë lumit Akelou. Nga numri i lartpërmendur vetëm rreth 300 ishin në gjendje të ushtronin armët dhe të luftonin deri në vdekje. Të tjerët qenë pleq, fëmijë dhe gra. Në këto kohë kemi edhe ngjarjet e Zallongut, të cilat njihen.

Në nëntor 1803 Markoja shkruante në një greqishte të varfër se ushtria e Ali Pashës kishte mposhtur suliotët dhe kishte hyrë në Suli vetëm nëpërmjet rrethimit me forca shumë të mëdha dhe të urisë.<sup>1</sup> Këtë fakt historik ai do ta kishte parasysh në tërë veprimtarinë e vet të mëvonshme luftarake.

Më 21 janar 1804 ushtria e Ali Pashës arriti në Selcë dhe rrethoi manastirin ku ishin vendosur gratë dhe fëmijët e suliotëve. Më 15 janar filloi beteja me suliotët, të cilët kishin zënë pozicionet jashtë manastirit. Beteja zgjati tri orë dhe ushtria e Aliut u detyrua të tërhiqet. Pas pak, pashai dërgoi forca të freskëta, të cilat për tre muaj rresht nuk arritën ndonjë sukses. Më 20 prill forcat suliotë u detyruan të futen brenda në manastir. Të nesërmen, pas shumë përlëshjesh gjakësore, ku morën pjesë edhe gratë e reja me fëmijët në gji, ushtria e Aliut mundi t'i pushtojë pozitat e kundërshtarit. Gratë suliotë luftuan me gurë, drurë, thika. Disa prej tyre nuk pranuan të dorëzohen, por u futën në lumë dhe aty luftuan derisa u mbytën me gjithë fëmijë. Në këtë betejë u vra edhe biri i Kiços, vëllai i Markos, Janaqi. Shpëtuan vetëm 60 burra me një grua, Maria Pantazi. Të tjerët u vranë ose u zunë robër, midis të cilëve xhaxhai i Markos, Noti Boçari, dhe gruaja e tij, të dy të plagosur rëndë. Ra rob vëllai i vogël i Markos, Kostandini, dhe dy motrat, Dhespoja dhe Angjelika.<sup>2</sup> Motra tjetër e Markos, Leni, që ishte shumë e bukur, qe përlëshur me trimëri me armiqtë. Kur arriti afër lumit atë e vuri re një ushtar i Aliut.

---

1) Niku Zhagu, *Markos Boçarisi*, Athinë, 1966, f. 17.

2) P. A. S. *vep. e cit.*, f. 192-197.

Ajo u fut në lumë për të shpëtuar, ushtari i foli shqip: «S'të vjen keq moj vajzë për rininë tënde? Mos u mbyt se unë do të shpëtoj». «Eja të më shpëtosh», u përgjigj suliotja e re. Ushtari hyri në lumë dhe, kur arriti deri në brez, i zgjati dyfekun, që ajo të shpëtonte. Vajza iu afrua, e mbërtheu dhe e zhyti në ujë ku u mbyt edhe vetë.<sup>1</sup> Leni ishte gjasthtë vjet më e madhe nga Markoja, rreth 20. Ai tanimë ishte rritur dhe po kalonte në pjekuri. Mbresat e thella nga lufta e suliotëve kundër Ali Pashës kishin bërë punën e tyre. Noti Boçarin Aliu e futi në burg, por ai mundi të largohej dhe arriti deri në Berat pranë Kurt Pashës dhe pastaj në Korfuz.<sup>2</sup>

Në këtë betejë Markoja 14-vjeçar luftoi si hero bashkë me të atin. Suliotët e mbetur mundën të arrinin në Parga. Aty u takuan me suliotë të tjerë nën komandën e Foto Xhavellës, por u larguan shpejt për në Korfuz, për të mos u përgjysmuar nga moçalet dhe malarja. Përpjekjet për t'u lidhur me bejlerët dhe agallarët e Çamërisë kundër Ali Pashës nuk dhanë asnjë përfundim. Po kështu dështuan edhe lutjet e presionet e Aliut drejtuar senatit të Korfuzit për t'ia dorëzuar suliotët atij.<sup>3</sup> Markoja 14-vjeçar tani ishte kapëdan suliot krahas Foto Xhavellës, Dhimo Drakos, Tusha Zervës etj.<sup>4</sup>

Banorët e Pargës kishin hedhur poshtë me neveri këshillat e mitropolitit grek Jerotheut: «Edhe herë tjetër ju kam shkruar dhe kur kalova nga vendi juaj ju fola dhe ju këshillova shpirtërisht e në mënyrë atërore që të hiqni dorë nga suliotët dhe të mos u jepni asnjë ndihmë, as t'i pranoni në vendin tuaj, sepse janë kriminelë dhe janë shpallur fermanli nga Dovleti».<sup>5</sup>

1) Niku Zhagu, *I antistasis*, f. 159.

2) Spiru Mella, *To Liantari tis Ipiru I*, f. 181-183.

3) Perikleus G. Zerbeanus, *Stmfiki Eptanasion qe Ali Pashas*, Athinë, 1921, f. 20.

4) P. A. S. *vep. e cit.*, f. 204, H. Kristovasil, *Minies...* f. 9.

5) Leander I. Vranusi, *Athanasis Pealidhas o dhidhaskallos tu jenus* (1767-1829), Janinë, 1952, f. 33.

Korfuzi më 1804 ishte nën sundimin rus dhe suliotët, përfshirë dhe Markon, hynë në shërbim të ushtrisë ruse, së pari, e përsërisim për të fituar bukën e gojës për vete dhe për familjet e tyre, së dyti me perspektivën për të çliruar vendlindjen. Suliotët krijuan 10 batalione dhe korpusin e «Gjuetarëve të lehtë». Markoja ishte njëri nga komandantët e këtyre batalioneve. Qysh atëherë ai ishte i pajisur me karakter të fortë, kurajë, shkathtësi dhe vullnet të hekurt. Ai dhe suliotët e tjerë, herë pas here, merreshin me pastrimin e armëve, i binin kitarës dhe këndonin shqip heroizmat e etërve të tyre.<sup>1</sup>

Më 1807 rusët ua dorëzuan Shtatë Ishujt francezëve dhe suliotët kaluan me këta; Markoja si nënoficer, ndërsa i ati dhe ungji me gradën major. Por ka edhe mendime se Kiçoja u bë kolonel. Në radhët e ushtrisë së Napoleonit Markoja shërbeu në Itali, në Napoli, ku mësoi italishten. Në këtë kohë bie në kontakt me idetë e Revolucionit Francez, të cilat i përhapnin kudo që shkelnin ushtarët dhe oficerët e Napoleonit. Në Korfuz Markoja u njoh edhe me njërin nga arbëreshët kryesorë luftëtarë të paepur antiosmanë të Polepenezit, Teodor Kollokotronin. Kiço dhe Noti Boçari tanimë komandën e ushtrisë sulioje ia kishin dorëzuar Markos. Kollokotroni në këtë kohë lexonte një libër mbi jetën e Skënderbeut, nga i cili mësoi shumë gjëra që i vlejten pastaj në jetë.<sup>2</sup> Skënderbeu u bë heroi i tij i dashur dhe Kollokotroni gjatë Revolucionit 1821-1829 u përpoq ta vinte veten në rolin e Heroit të madh.<sup>3</sup>

Deri më sot nuk kemi hasur gjëkund që Marko Boçari të ketë lexuar ndonjë vepër mbi jetën e Fatosit të madh shqiptar, i cili për një kohë të gjatë kishte qenë tmerri i turqve dhe shpresa e të shtypurve. Por fakti

---

1) Hioti, *Istoria tis Eptanisu qe idhios tis Zakinthu apo Venetokratias cos tin katohin tus Englezus (1550-1816)*, Korfuz, 1862, cituar prej Aristidh Kelias, *vep. e cit.* f. 308.

2) Spiru Mella, *O Jeros tu Moria*, Athinë, 1931, tomos A, f. 137,

3) Eugèna Yemèniz, *La Grece moderne*, *vep. e cit.*, f. 176.

që gojëdhëna sulioje fliste për origjinën e banorëve të Sulit prej gardës së Skënderbeut dëshmon më së miri se ai i kishte dëgjuar dhe i njihte bëmat e tij.

Në Korfuz Markoja dhe Kollokotroni u bënë vëllamër, gjë që konsiderohej shumë e shtrenjtë. Vëllamërit duhej të kishin të njëjtën moshë, të ishin miq dhe mbi të gjitha të çmonin njëri-tjetrin. Vëllai i gjakut ishte afërsisht si vëllai i vërtetë. Jemenizi shkruan për nënën e Kollokotronit: «Një grua shqiptare e mbante atë mbi kurriz, një dyfek mbi supet, fishekë në përparësen prej leshi, e gatshme për të mbrojtur ajo vetë peshën e saj të çmuar».<sup>1</sup> Gjatë viteve 1742-1800 shtatëdhjetë Kollokotronë kishin rënë me armë në dorë në luftën antiosmane dhe dymbëdhjetë prej tyre do të binin gjatë Revolucionit Grek (1821-1829).<sup>2</sup> Fakti që të dy këta luftëtarë ishin shqiptarë ka luajtur rol të rëndësishëm për vëllamërinë e tyre.

Si suliot Markoja do t'i qëndronte besnik ushtrisë franceze ku shërbente. Ai nuk ishte një rroghtar i rëndomtë, një mercenar mesjetar, që këmbente zotërinjtë sa herë që e kishte vështirë. Ai u qëndronte besnik ushtarëve francezë me idë të reja. Për Markon, por edhe për shumë revolucionarë të tjerë në atë kohë, Revolucion i Francez u hapte horizontë të reja popujve. Atij i dukej se gjithë popujt evropianë po ecnin me hapa të shpejtë drejt pavarësisë dhe lirisë. Kjo lëvizje vlente edhe për popujt e Ballkanit. Pukëvili flet tërthorazi për ndikimin që pati Revolucion i Francez te suliotët.<sup>3</sup> Më vonë u bë e qartë se «Duke filluar nga viti 1789, kufijtë e Revolucionit lëviznin pandërprerë gjithnjë e përpara».<sup>4</sup> Nuk është aspak e tepëruar të pohohet se revolucionarët e vërtetë, përfshirë

1) Eugène Yemèniz, *vep. e cit.*, f. 162.

2) D. Bikélas, *La Grèce byzantine et moderne*, Paris, 1893, f. 204, shënimi 1.

3) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit.*, f. 207:

4) K. Marks, F. Engels, *Vepra*, vëll. 9, 1957, f. 33.

Marko Boçarin, në atë kohë e kishin parandier këtë. Puls i zemrës së tyre rrihte fort për idetë e atij revolucioni që do të ndikonte në vendet e tyre të robëruara. Pra Markoja dhe Kollokotroni u bënë vëllamër në Korfuz, në vitin 1814. Në marrëveshjen e vëllamërisë që do të përtëritej midis tyre më 1822 në Poleponez dhe ku do të përfshiheshin dhe dy të tjerë, midis të tjerash, thuhej: «...Vendosëm të bëjmë një lidhje vëllazërore, e cila do të ketë për qëllim interesin e përbashkët të vendit. Prandaj, bëjmë benë e shenjtë të besës sonë të kulluar për të respektuar: a) Detyrimet tona të shenjta. b) Kur kemi ndër mend të fillojmë ndonjë çështje, detyrohemi ta paragesim këtë në mbledhje të përbashkët, ose kur nuk do të jemi në të njëjtin vend, të merremi vesh në një mënyrë tjetër që do të na lejojë rasti dhe, pasi ta diskutojmë mirë, ta vendosim e të përpiqemi që ta vëmë në zbatim. c) Në rast se do të jetë nevoja për të holla, për të bërë diçka në dobi të vendit, detyrohemi që të japim nga të ardhurat tona aq sa të kemi mundësinë dhe të gjejmë edhe nga burime të tjera që çështja të përfundojë si duhet, por gjithmonë me pëlqimin e përbashkët. d) Në rast se do të përndiqet ndonjë nga ne, premtojmë ta mbrojmë, dhe atë që përndjek vëllain tonë ta konsiderojmë armik të përbashkët. e) Që bashkimi ynë të bëhet më i dobishëm, detyrohemi që këtë lidhje ta mbajmë të fshehtë, madje edhe nga fisi ynë më i afërt dhe në vëllazërinë tonë të pranojmë vetëm atë që gjykohet i denjë nga të gjithë ne, që edhe sekretin ta ruaj, edhe me bashkimin e tij t'i sjellë dobi vendit. f) Në rast se ndonjë do të shkelë detyrimet e mësipërme, betohemi te trinia e shenjtë, që ta dënojmë me vdekje si tradhtar të vëllazërisë dhe të vendit».<sup>1</sup> Ishte një vëllazëri që kishte parasysh interesat e secilit, por mbi të gjitha ato të luftës për liri.

Më 1809 anglezët pushtuan gjashtë ishujt e tjerë të Heptanezit me përjashtim të Korfuzit. Me ishullin Shën-

1) Dh. A. Ikonomu, *vep. e cit.*, f. 79-80.

-Maura ata e patën të vështirë, sepse ai mbrohej nga suliotët. Ata nuk do të arrinin ta pushtonin në qoftë se gjenerali francez Kamus nuk do të kishte dhënë urdhër që mbrojtësit të tërhiqeshin nga pozicionet e tyre dhe të futeshin në kështjellë, urdhër që çoi në dështim. Suliotët për të shpëtuar nderin e tyre si luftëtarë besnikë, i dërguan këtë letër komandantit të korpusit francez, Mino:

«Të ngarkuarit e korpusit (batalionit — K.X.) shqiptar, komandantit të korpusit francez, kolonelit Mino:

«Me pikëllimin më të madh u bindëm për veprimin e shqiptarëve (suliotëve — K.X.) që ndodhen në Shën-Maura. Ne nuk jemi aspak përgjegjës për mangësitë e tyre, megjithatë është e nevojshme që të dëgjojmë zërat e drejtësisë dhe të nderit të kombit tonë, duke i bërë të njohura shkaqet që i detyruan ata t'i dorëzohen anglezëve.

Duhet vënë në dukje se të gjithë ne, të përndjekur nga turku, u strehuam në ishujt e detit Jon, pasi luftuam trimërisht në mbrojtje të atdheut tonë dhe të familjeve tona.

Katër ditë përpara se anglezët të mbërrinin në Shën-Maura, komandanti ishte vënë në dijeni. Megjithatë, nuk u mor asnjë masë për të siguruar familjet tona, për t'i dërguar ato në Korfuz ose në Pargë, e për t'i strehuar të paktën në kështjellë, çka komandant Boçari i kërkoi gjeneralit Kamus, pikërisht në çastin kur anglezët u dukën përpara Shën-Maurës. Por ai u përgjigj se edhe sikur i tërë garnizoni të detyrohej të tërhiqej në kështjellë, familjet e shqiptarëve do të mbeteshin përjashta, duke shtuar se njëkohësisht do t'i shkruante gjeneralit anglez që të mos u shkaktonte atyre asnjë bezdi.

Kjo përgjigje nuk u pëlqeu shqiptarëve, ndaj ata luftuan me dëshpërim, ku fitorja në të vërtetë po u buzëqeshte armëve të tyre.

Mënyra sesi ne luftuam nuk na lejoi që të merrnim me vete kapotat tona, sepse do të na bezdisnin shumë. Prandaj dhe shqiptarët i kishin lënë shtëpitë e tyre dhe

për 10 ditë rresht u qëndruan vështirësive të motit të keq. Gjeneral Kamus u kishte mohuar të drejtën të hynin në kështjellë për të marrë ndonjë mbulesë, të kërkonin të holla dhe një kirurg për shumë të plagosur, të cilët qëndronin të shtrirë pa ndihmë. Komandant Boçari atëherë kërkoi lejen për të dërguar adjutantit e vet në Korfuz e për të blerë ato që u duheshin, por gjenerali Kamus i kundërshtoi.

Midis gjithë këtyre hidhërimeve dhe mbi të gjitha, duke mos mundur të duronin ndarjen barbare prej familjeve të tyre, shqiptarët vendosën të braktisnin veten në mëshirën e anglezëve.

Ne nuk dëshirojmë t'i lëvdojmë për këtë, madje nuk miratojmë aspak vendimin e tyre dhe nuk na mbetet shpresë tjetër veçse të asgjësojmë me gjakun tonë një dyshim që pa të drejtë ose më mirë të themi, me keqardhje, përpiqet gjenerali Kamus të na i ngarkojë mbi vete. . .

Korfuz, 7 prill 1810».<sup>1</sup>

Me luftëtarët suliotë Kamusi nuk u soll ndershmërisht. Familjet e tyre kishin mbetur në duart e fatit, kërkesat dhe lutjet e Boçarit nuk qenë marrë parasysh. Ata e ndien veten të përbuzur, dorëzimi kishte qenë i detyruar. Kjo letër është shkruar me takt, por nderi i suliotit, si luftëtar besnik në këtë letër është mbrojtur më së miri duke lënë të kuptohet se të huajt që i kishin marrë në shërbim nuk ishin sjellë ndershmërisht me ta. Ndërkohë Napoleon Bonaparti kishte dështuar në Spanjë dhe po përgatitej për luftën kundër Rusisë. Kështu ka mundësi që letra mos t'i ketë rënë në dorë. Megjithatë suliotët kishin kuptuar se me shërbimin ndaj të huajt mosmirënjohës ishte e pamundur të përgatitnin çlirimin e Sulit. Ndaj duheshin shfrytëzuar ngjarje më të mëdha.

Lind pyetja: Meqenëse në letër flitet vetëm për mbiemrin Boçari, cili prej tyre duhet të ketë qenë, Kiçoja,

---

1) *Storia di Suli e di Parga...*, f. 38-40.



Noti apo Markoja? Po të kemi parasysh se dy të parët ia kishin lënë Markos komandën, atëherë duhet të ketë qenë ky i fundit. Për një 19-vjeçar si ai nuk ishte shumë të ishte komandant garnizoni. Megjithatë, asgjë e saktë nuk mund të thuhet. Mund të ishte edhe xhaxhai i tij Noti Boçari. Sidoqoftë kjo letër dëshmon se suliotët dhe Marko Boçari, apo Boçarët e tjerë, nuk pranojnë në asnjë mënyrë të përlyhet nderi dhe besnikëria e tyre tradicionale, veti që i konsiderojnë themelore për luftën e mëvonshme çlirimtare.



Jeta në dhe të huaj, në shërbim të huaj, nuk po durohej më nga Boçarët, atë e bir. Në vitin 1812 atyre iu mbush mendja të pajtoheshin me Ali Pashën dhe të ktheheshin nga Korfuzi në vendlindje. Pashai u gëzua dhe dha pëlqimin menjëherë. Përse duhej të qëndronin larg pashallëkut të tij këta dy personalitete të fuqishme? Ishte më mirë për të t'i kishte miq sesa armiq dhe, sipas një varianti, po të ishte e nevojshme, t'i vriste me dorën e të tjerëve. Me të marrë vesh këtë lajm dhe sidomos ardhjen e tyre, dy armatolët në shërbim të Ali Pashës, Dhimitër Karaisko dhe Gogo Bakolla, u dëshpëruan shumë, sidomos kur morën vesh se Kiço Boçarin Aliu kishte vendosur ta bënte martallos (armatol) ngjitur me krahinat ku ata komandonin. Dhimitër Karaisko shkoi në Janinë, u takua me Aliun dhe iu ankua për këtë veprim të tij, sepse prania e dy Boçarëve gjoja ishte rrezik i madh për të dhe martallozët e tjerë. Aliu iu përgjigj se ndaj Gjergj Boçarit, atit të Kiços dhe gjyshit të Markos, kishte detyrime morale ndaj martallozët e tjerë s'kishin arsye për t'u shqetësuar. Ata s'do të pësonin asgjë.

Me t'u kthyer në krahinën e vet, Karaiskoja me tendenciozitet ia paraqiti Gogo Bakollës bisedimet që pati

me Alinë duke nënvizuar rrezikshmërinë që u kanosej atyre nga dy Boçarët. Për këtë ai propozoi vrasjen me të pabesë të Kiços. Gogo Bakolla u bind. Me të marrë vesh se Kiço Boçari do të shkonte për drekë te një miku i tij, këpucëbërësi me emrin Rizo në Artë, arriti përpara tij në këtë qytet, zuri pritë fshehurazi dhe e vrau. Që këtej vrasësi shkoi në Janinë, ku u takua me pashain dhe i tregoi ngjarjen. Pashai ia priti se po të mos kishte vepruar kështu, asnjëri prej tyre s'do të kishte shpëtuar nga Boçari.<sup>1</sup>

Këtë variant të kohëve tona, Aravantinoi në kohën e vet kur ngjarjet ishin më të freskëta nuk e pranon. Ai shkruan: «Thuhet se armatoli Gogo Bakolla e kreu këtë vrasje me urdhër të Aliut, por kjo është e pabesueshme».<sup>2</sup> Dhe ka arsye për ta vënë në dyshim. Së pari, Ali Pasha nuk ishte njeri mosmirënjohës ndaj miqve të tij të dikurshëm. Kështu mund të qëndronte çështja edhe për dy Boçarët, me gjithë ngjarjet në Selcë. Së dyti, Kiço Boçari, si njeri besnik, nuk do të ishte më armik i rrezikshëm për Aliun. Së fundi, Aliu kishte zënë rob Nōti Boçarin, që kishte luftuar rreptë në Selcë. Noti ishte plagosur, burgosur, shëruar dhe s'e kishte vvarë. Përse duhej të vriste Kiçon dhe të kursente të birin e tij Markon? Sidoqoftë, vrasja ka qenë dora e dy martallozëve të mësipërm dhe veçanërisht Bakollës. Marko Boçari u betua që t'i merrte hakun të atit. Këtë betim ai nuk do ta harronte kurrë. Kënga popullore e këndoi vdekjen e Kiço Boçarit në këto vargje:

*Tre zogj të vegjël rrinin te ura e Artës,  
Njëri shikon Janinë dhe tjetri drejt Sulit,  
I treti, më i miri vajton dhe thotë:  
«Boçari u nis të shkonte në Janinë,*

---

1) Dhimitri Th. Karaxeni, Gogos K. Bakollas, *O Adhamastos opllarhigos tu 21, Janinë, 1978, f. 13-15.*

2) S. Aravantinu, *vep. e cit., f. 284.*

«Që të marrë një vendim për të shkuar në Burgarel,  
 «Për të mbledhur asprat që i kish dhënë hua,  
 «Dhe kaloj nga Artat për t'i bërë konak;  
 «Dhe i bënë konak tek shtëpia e këpucarit,  
 «Dhe atje shtruan darkë bukë për të ngrënë,  
 «Me tre të shtëna pushke i ranë njëra pas tjetrës,  
 «Njëra i bie në brinjë, tjetra mu në gjoks,  
 «E treta, më e hidhura, e zë brenda në grykë». <sup>1</sup>

Pa justifikuar aspak krimin e urryer të martallozit Gogo Bakolla, as, ndoshta, hakmarrjen e Ali Pashës, duhet pranuar se të birin, Marko Boçarin, ai nuk e trazoi. Kjo është një meritë e madhe e Ali Pashës. Si njohës i mirë i njerëzve, ai e mbajti pranë për ta bërë më vonë aleat kundër sulltanit. Megjithatë, kjo vrasje do të linte gjurmë të thella te Markoja. Ai u bë më i kujdesshëm, duke menduar për hakmarrjen e ardhshme. Aliu i dha Markos një pronë në Pogon (në Greqi), pastaj më 1815 e bëri dhe armatol. Familja e tij u vendos në fshatin Kakollako, në kullën e Kurt Pashës, ku qëndroi deri në vitin 1820, bashkë me Krisullën dhe tre fëmijët, me motrat Leni dhe Angjelika si dhe me njerkin, e cila kishte një djalë të saj. Vëllai i tij, Kostandini, kishte qëndruar pranë Aliut që nga viti 1804 e deri kur u zu rob, në Burgarel.

Kjo nuk do të thotë se Markoja nuk qëndronte në Janinë. Është fakt se shumë kapedanë arbëreshë, por edhe grekë, mësuan në shkollën ushtarake të Ali Pashës me mësues francezë. Nga kjo shkollë dolën luftëtarët më të mëdhenj të Greqisë, si: dy vëllezërit Boçari, Odhise Andruco, Drakot, Bejko, Karaiskaqi, Griva, Xhavella etj. «Mjaft nga këta, qoftë si pengje të familjeve të tyre, qoftë të detyruar, shërbyen në ushtrinë e Janinës si ofi-

---

1) Dhimitri Manu, *Ali Pashas o Tepelenlis, II* (pa datë botimi), f. 330.

cerë të Aliut. Janë Boçarët, Xhavellajt, Dangëllitë, Drakot, Fotomarët.<sup>1</sup>

Ali Pasha kishte disa oficerë francezë në shërbim të ushtrisë së tij. Këta lavdëronin Kosta Boçarin për shkathtësi, por Aliu u ishte përgjigjur: «E keni gabim, ai që nuk flet do të bëhet i madh, Markoja ka për t'i tronditur armiqët, mjerë Turqia».<sup>2</sup>

\*  
\*      \*

Në vitin 1809 Markoja u mor me hartimin e një fjalori greqisht-shqip, me qëllim që të ndihmonte fqinjët grekë që të mësonin shqipen. Ai vetë sapo kishte përvetësuar disi greqishten<sup>3</sup>. Ky fjalor përbëhet prej 1494 fjalësh, fjalor i vëllimshëm për kohën e vet me dialektin e Shqipërisë së Jugut. Në atë numër të vogël fjalësh shqipe gjejmë ndjenjat e tij që dëshmojnë për një dashuri të zjarrtë për gjuhën amtare. Fakti se ai shkruan fjalët shqipe qoftë edhe në një alfabet grek (alfabet shqip me gërma latine në atë periudhë s'kishte), tregon se ai ishte i bindur se gjuha shqipe, njëlloj si të tjerat mund të shprehte gjithçka fisnike, njerëzore. Në fletën e parë të fjalorit shkruhet: «Ky fjalor është shkruar me dorën e Marko Boçarit në Korfuz më 1809, përpara meje. Pukëvil».<sup>4</sup> Emil Lëgran dorëshkrimin e fjalorit ia dërgoi në vitin 1895 revistës «Albania». Fjalori nuk është shkruar në bazë të kriterit alfabetik. Ai ka 111 faqe.

Për rëndësinë gjuhësore të këtij fjalori, studiuesi grek Johallas shkruan: «Leksikografia greko-shqiptare në Greqi nis me Marko Boçarin... Kjo vepër, pavarësisht

---

1) Dionis A. Kokinos, *I eleniqi Epanastasis*, tomos protos, Athinë, 1931, f. 42.

2) Dhimitri Manu, *Ali Pashas o Tepelenlis*, II, f. 331.

3) Jani Benekos, *vep. e cit.*, f. 87.

4) Niku Zhagu, *Marko Boçari*, f. 23.

nga rëndësia e shumanshme që ka për një luftëtar me pak shkollë, i cili duke lënë mënjanë për një kohë të shkurtër pushkën, krijoi një vepër kulturore, na sjell një material shumë të çmuar për dialektologjinë shqiptare. I shkruar në fillim të shekullit XIX ky fjalor ndihmon të ndjekim mjaft fenomene gjuhësore të caktuara dhe interesante... Leksiku vlen njëkohësisht edhe për vërejtjet e ndryshme filologjike, shoqërore, madje dhe historike».<sup>1</sup> Kështu që nuk është e vërtetë, siç është pohuar në një revistë shqiptare para Çlirimit, që ky fjalor është vetëm çështje kureshtie dhe nuk ka asnjë rëndësi letrare ose filologjike shkencore. Për hartimin e këtij fjalori Markoja pati ndihmën e atit të tij, xhaxhait, Notit dhe vjehrrit, Kristaq Kallogjerit.<sup>2</sup> Studiuesi shqiptar Eqrem Çabej e ka vlerësuar punën dhe mendjen e Markos në këtë fjalor. Ai vëren se Marko Boçari në fillim të shekullit të kaluar përdor «leksema të sferës kuptimore-abstrakte, si: kërkim, madhësi, i papunë, i pamasë, ashtu si Gjon Buzuku në Veri».<sup>3</sup> Dhe çuditet se si një njeri jo i penës por i armës mund ta kryente një punë të tillë.

Me këtë fjalor me siguri që autorit të këtij fjalori nuk i shkonte ndër mend se po jepte një ndihmesë qoftë edhe modeste për studimet gjuhësore. Qëllimi i tij themelor ishte që nëpërmjet mësimit të gjuhës, të lehtësonte komunikimin midis popullsive greke dhe asaj shqiptare; të forconte miqësinë e të dy popullsive në ato kra-hina nëpërmjet marrëdhënieve tregtare, por sidomos nëpërmjet bashkimit në të ardhmen për të kundërshtuar së bashku shtypjen osmane. Bashkëpunimi midis dy popujve, në luftën çlirimtare të përbashkët, për Marko Boçarin ishte kushti themelor për fitoren përfundimtare. Në këtë çështje ai u ngrit gjatë Revolucionit Grek shumë më

---

1) Titos Jochallas, *vep. e cit.* f. 29-30.

2) *Po aty.*

3) Eqrem Çabej, *Për pastrimin e gjuhës*, «Gjuha jonë», 1, 1981, f. 39.

lart nga të gjithë ata që do të vepronin kundër këtij bashkimi: feudalët shqiptarë dhe fanariotët grekë. Ishte fjala për çlirimin e dy popujve nga zgjedhja osmane, secili në vendin e punën e vet, por në miqësi të ngushtë.

\*  
\*  
\*

Marko Boçari ka qenë martuar dy herë. Për martesën e parë dhe zgjidhjen e saj nuk kemi të dhëna të sakta. Në Korfuz ai martohet për së dyti me vajzën e armatolit të Prevezës, Kristaq Kallogjerit, me Krizeidën ose ndryshe Krisullën, me të cilën pati katër fëmijë: Dhimitrin (1814), Vasilikën (1818-1891), Anastasinë (1820-1838) dhe Ekaterinën-Roza (1822-1875).<sup>1</sup> Ka edhe mendime që ai pati pesë fëmijë, dy të parët i vdiqën, ndërsa tre të tjerët ishin Dhimitri, Vasilika dhe Ekaterina-Roza.<sup>2</sup> Krizeida nuk kishte arsim, por ishte grua e dëgjuar jo vetëm për bukurinë, por edhe për virtytet e saj. Të dy ata përbënin një çift të përshtatshëm dhe vetëm vitet në Korfuz i kaluan pak a shumë në qetësi, siç do të vërehet më poshtë.

Një ndikim të madh pati te Marko edhe veprimtaria revolucionare e dëshmorit të parë të Revolucionit Grek, Riga Fereos Velestinliu, të cilin e vranë njerëzit e qeverisë osmane më 1798. Vetë Riga kishte qenë nxënës i Revolucionit Francez. Idetë e këtij revolucion, e kishin bërë atë një jakobin të vërtetë revolucionar që luftonte për çlirimin e popujve të Ballkanit. Ai ishte njohur me veprat e iluministëve francezë, kishte përkthyer, midis të tjerash, edhe gjysmën e veprës së vëllimshme të Monteskjësë «Mbi frymën e ligjeve». Ai u bë ideologu i flaktë i luftës së përbashkët për çlirimin e Ballkanit. Nën ndi-

1) Elefteriás Nikollaidhu, *O Dhimitrios Marku Boçari (1814-1871) Kai i anekdhóti alillografia tu me ton kivenittin Kapodistriás, Janinë, 1973.*

2) Jani Benekos, *vep. e cit., f. 196.*

kimin e Marsejezës ai shkroi «Himnin e luftës». Në këtë himn ai u bënte thirrje popujve të Ballkanit që t'i shtrëngonin fort radhët e tyre sepse vetëm bashkimi bën fuqinë dhe sjell fitoren.

Rëndësia e këtij himni qëndronte edhe se ishte shkruar në gjuhën popullore greke në mënyrë që të lexohej sa më shumë, mbasi ajo gjuhë në Ballkan ishte, atëherë, mjaft e përhapur. Himni i Rigasit u përhap kudo. Këngët e tij këndoheshin prej suliotëve dhe Marko Boçarit përpara betejave. Suliotët nën komandën e Markos hidheshin në sulm duke kënduar këtë himn.<sup>1</sup>

Ky himn u bë edhe kënga e luftës së organizatës revolucionare greke «Shoqëria e miqve», që ndryshe quhej «Filiki Heteria». Kjo organizatë u themelua në Odesë në vitin 1814 nga tre revolucionarë: dy grekë dhe njëri prej tyre Nikolla Skufa, shqiptar. Qëllimi i «Heterisë» ishte të ngrinte të gjithë popujt e Ballkanit në kryengritje të armatosur për dëbimin e pushtesit prej gadishullit. Ajo kishte karakter të theksuar politik nën shembullin e heterive të botës së lashtë greke, por ndryshe nga ato ajo kishte një karakter borgjez demokratik sepse shumica e anëtarëve të saj ishin zejtarë e tregtarë. Vetëm më vonë ajo filloi ta humbasë këtë karakter nën ndikimin e udhëheqjes së saj fanariote dhe të primatëve kryesisht të Peloponezit, që shpresonin mbi të gjitha të ndihma e carit të Rusisë.

Anëtar i saj u bë edhe Marko Boçari në vitin 1818, i cili tanimë ishte pjekur dhe përgatitur ideologjikisht. Ai nuk ishte më vetëm suliot por edhe revolucionar ndërballkanik. Ka patur edhe mendime që ai të jetë bërë anëtar i Heterisë që në themelimin e saj (1814).<sup>2</sup> Kjo

---

1) A. Daskalakis, *Thourios. Le Channt de la Liberté de Riga Velestinilis*; «Balkans Studies», nr. IV, Number TWO, Thesaloniki, 1963, f. 323.

2) *The Enciclopedia Britannica*, vol. 3, 1929, f. 957; *Der Grosse Brochhaus*, Leipzig, 1926, f. 200 *Enciclopedia Hoepli volume primo*, AB, 1963, f. 200.

është e vështirë të pranohet për vetë faktin se Heteria u krijua në shtator të vitit 1814, kur Markoja ishte pranë Ali Pashë Tepelenës. Viti 1818 është më i pranueshëm, sepse në prag të kryengritjes së Aliut, veprimtaria e saj ishte më e përhapur në tërë pashallëkun e tij,<sup>1</sup> kryengritje të cilën Marko Boçari do ta mbështeste me të gjitha forcat dhe si luftëtar do të angazhohej në të me trup dhe me shpirt. Aliu ishte në dijeni të veprimtarisë së kësaj organizate dhe dëshironte ta shfrytëzonte atë për një kryengritje antiosmane të kombësive, nën pushtetin e tij, për më tepër që ajo nuk ishte një shoqëri me kërkesa radikale-shoqërore të organizuara.

---

1) Joanis Filimonos, *Dokimion, Istorikon peri tis Ellinikis Epanostos*, vëll. IV, 1961, f. 208, T. Kandiloros, *Heteria ton filikon*, Athinë, 1926, f. 336.



## MARKO BOÇARI DHE ALI PASHA

Dëshira e Sulltan Mahmutit II për të nënshtuar Ali pashë Tepelenën kishte disa shkaqe, po dy qenë më themeloret. Gjatë përpjekjeve për centralizimin e mëtejshëm të Perandorisë Osmane, sulltan Mehmeti duhej të vendoste autoritetin e vet në pjesën perëndimore të perandorisë që ishte tronditur dhe do të tronditej më keq, në qoftë se Aliu do të krijonte një principatë krejt të pavarur.<sup>1</sup> Nga ana tjetër, sulltani dëshironte t'i rrëmbente Aliut pasurinë, që konsiderohej përrallore dhe me të të mbushte përkohësisht arkën shtetërore që ishte e zbrazur. Ishte bërë traditë për sulltanët, që kur një vezir apo pasha pasurohej shumë, në një mënyrë ose në një tjetër, ai duhej të zhdukej me pretekste të ndryshme; i merrej pasuria, e cila bënte fuqinë e tij dhe mund të kthehej në rrezik për fronin.

Kur Aliu dërgoi agentët e vet për të vrarë Ismail Pasho Beun, armikun e tij të betuar, pikërisht para pallatit të sulltanit, ky i fundit e kuptoi se pashai i Janinës tanimë e kishte tepruar zullumin. Sovrani e konsideroi veprimin e tij një provokim të hapur, gjeti rastin dhe e shpalli Aliun armik që duhej zhdukur.

Ali Pasha, nëpërmjet vëllamit dhe mikut të tij të ngushtë, primatit të Zagorit, heteristit Aleks Nuco, arbë-

---

1) K. Papanigopullu, *Istoria tu eleniku Ethnus*, vol. V, pjesa II, Athinë, 1935, f. 513.

resh, që njihej mirë me armatolët e Greqisë dhe që ishte për formimin e një principate të pavarur shqiptarogreke<sup>1</sup>, thirri në mbledhje, më 23 maj 1820<sup>2</sup>, personalitetet kryesore shqiptare myslimane dhe ortodokse, si dhe ato greke. Në këtë mbledhje merрте pjesë edhe Marko Boçari. Aliu e filloi mbledhjen me këto fjalë: «Cmira e myslimanëve kundërshtarë të mi (bejlerëve të thyer prej tij — K.X.) dhe urrejtja që kanë për ne të pabesët e huaj (Porta e Lartë, K.X.), e kanë zemëruar sulltanin kundër nesh dhe ai sapo më ka dënuar. Nuk kam mundur t'i shkruaj drejtpërsëdrejti për t'ia hequr perden nga sytë dhe të shfaqësohem kundërshtarë akuzave të tij; ai ka bërë veshin e shurdhër dhe nuk i ka dëgjuar arsytet e mia; do të pendohet, por do të jetë shumë vonë. Kur ai do të gjejë mundësi të marshojë kundër nesh, në qoftë se unë nuk do të ndihmohem nga trimëria dhe zelli i juaj, në qoftë se ne nuk do ta mposhtim ushtrinë e tij dhe t'i tregojmë gabimin, unë do të jem i humbur dhe ju të gjithë bashkë me mua ose pas meje. Ju nuk do të jeni më ata shqiptarë të tmerrshëm që ju kam respektuar deri më sot. Unë nuk e mohoj se shumë prej jush e kanë ndër veten të fyer nga telashet që ju kam shkaktuar juve dhe prindërve tuaj. Megjithatë, nderi i shqiptarëve dhe interesi i atdheut qëndrojnë më lart nga armiqësitë personale dhe në një rrezik të përbashkët, kujtimi i fyerjëve të kaluara është një ndjenjë e padenjje për njerëzit zemërmëdhenj. Sot unë ju vështroj të gjithëve si fëmijët e mi, si Myftarin dhe Veliun. Thesaret e mia janë të celura për ju. Nuk ju kërkoj tjetër veçse të nderoni emrin që mbani».<sup>3</sup>

Pastaj Aliu u kthye nga kapedanët armatolë: «Ju, që unë ju kam respektuar kaq herë! Ja rasti kur unë pres

1) Notis Botzaris, *Visions Balkaniques dans la préparation de la Révolution Grecque (1789-1821)*, Genève, Paris, 1962, f. 172.

2) Rizos Néroulos, *Histoire de l'insurrection grecque précédée d'un précis d'histoire moderne des la Grèce*, Genève, 1834, f. 146.

3) J. Rizos Nirulos, *vep. e cit.*, f. 146.

nga ju nderin tim. Unë e di më shumë nga ç'duhet sa trima jeni, Dhe kjo është arsyeja që unë e le veten time në duart e zemërmadhësisë suaj». Ai iu drejtua vëllamit të tij Aleks Nucos, me këto fjalë: «Tani, ti do të jesh mbështetja ime kundër rreziqeve që më rrethojnë. Më shumë të besoj ty sesa bijve të mi që janë këtu të pranishëm. Dhe kam arsye të pres veprat e shkëlqyera prej zellit tënd». Më në fund, i nguli sytë nga Marko Boçari, i cili si gjithmonë atij i dukej fjalëpakë e serioz. Pashai dëshironte të mbështetej fort tek ai, me qëllim që suliotët, të lidhur ngushtë me Marko Boçarin në këtë luftë për jetë a vdekje me sulltanin, të bashkoheshin me të, të ktheheshin në forcë kryesore goditëse, kur një pjesë e ushtarëve rrogatari e kishin braktisur. Njeri më besnik se Markoja, për të arritur këtë qëllim, ai nuk gjente. Autoriteti i suliotit të ri ishte shumë i madh tek bashkëvendësit e tij. «Dhe ti, iu drejtua ai Markos, përse rri i menduar dhe i heshtur? Është koha për të vepruar dhe jo për të menduar, shpresoj shumë prej teje dhe prej shokëve të tu të armëve. Shkruaju atyre që të vijnë këtu nga Korfuzi dhe nga vende të tjera ku janë shpërndarë. Unë u kam bërë më shumë keq se çdo njeriu tjetër, megjithatë, nuk dyshoj aspak se duke dhënë fjalën tuaj prej trimash, ju do të veproni në favorin tim më mirë se miqtë e mi më të çiltër». Markoja i bindur se lufta mund të fitohej vetëm me forca të bashkuara dhe se ajo duhej të fillonte sa më parë, para se forcat e armikut të bashkoheshin dhe të rendnin kundër pashait, u përgjigj: «Vezir, heshtja ime është pasojë e parashikimit dhe jo e frikës apo e poshtërsisë. I rrethuar nga të tillë njerëz të urtë dhe nga bijtë e tu, ti nuk duhet t'i trembesh mërisë së sulltanit, vendos bashkë me Nuçon, çfarë dëshiron që ne të bëjmë dhe ne do të jemi të gatshëm për të zbatuar urdhrat e tua». <sup>1</sup> Markoja ishte i mendimit se duhej filluar menjëherë nga sulmi. Pritja e tepruar dhe ngathtësia do të sillnin rrezikun e mbrojtjes kun-

---

1) F. S. O. L. Pouqueville, *Histoire... Livre troisième*, vep. e dit., f. 121.

dër një ushtrie më të madhe. Nga ana tjetër, përgjigjja e Boçarit ishte në pajtim të plotë me planet që anëtarët e Heterisë i kishin marrë një natë më parë në shtëpinë e Nucos. Markoja që kishte marrë pjesë në atë mbledhje e këshilloi Aliun që të ndiqte këshillat e vëllamit të tij.

Së fundi, pashai u bëri thirrje peshkopëve, hoxhallarëve dhe primatëve që të bashkoheshin «për të udhëhequr me drejtësi kombin trim (grek — K.X.), që unë e bëj ortak me interesat e mia».<sup>1</sup>

Nga sa del nga bisedimet e kësaj mbledhjeje, Markoja, si edhe Aleks Nucoja, u shprehën për një aleancë midis kryengritësve grekë dhe atyre shqiptarë me në krye Ali Pashën.

Ushtria osmane e Ismail Pasho Beut që mundi të depërtojë shpejt në Janinë, filloi ta bastiste dhe ta grabiste vendin. Pukëvili shkruan: «Fshatrat e shkatërruara, bereqeti i rrëmbyer, dyqanet e bastisura, angaritë dhe taksat e përditshme, i bënin të krishterët që t'u vinte keq dhe të kujtonin qeverimin e Aliut. Shtrohej pyetja nga njerëzit: «Ç'kishin fituar ata dhe çdo të fitonin me këtë qeverim të ri (osman — K.X.) që nuk jepte shenjat e përmirësimit»».<sup>2</sup> Ky element i rëndësishëm politik nuk mund të mos shfrytëzohej nga Ali Pasha dhe Marko Boçari për një lidhje të përbashkët. Suliotët që sapo kishin mbërritur nga Korfuzi qenë bashkuar në fillim me osmanët kundër pashait të Janinës. Tani ata i kërkonin Pasho Beut rrogat, por ai nuk pranonte t'ua paguante dhe, përveç kësaj, i dëboi suliotët nga kampi i tij ushtarak, e u caktoi atyre një vend qëndrimi tjetër. Ata e kuptuan se sulltani nuk mund të hiqte dorë nga trajtimi i tyre si raja dhe Marko Boçarit nuk i erdhi mirë që ata kishin qenë bashkuar me osmanët. Megjithatë, «ashtu si Akili i rrethuar prej thesaliotëve të tij, Marko Boçari mbeti i veçuar me zemrën plot zemërim e hakmarrje».<sup>3</sup> Këtë luftëtar të dhënë pas

1) P. C. H. L. Pouqueville, *vep, e cit.*, f. 121.

2) *Po aty*, f. 133.

3) *Po aty*, f. 130.

luftës vetëm mërzia e lodhte. Suliotët vendosën të bashkoheshin shpejt me Aliun. Nën nxitjen e këtij të fundit ata i dërguan këtë letër komandantit të ushtrisë osmane Ismail Pasho Beut, i cili ndërkohë, i gjendur ngushtë, ishte përpjekur për t'i rikthyer në ushtrinë e tij. «Kur mësuam se u kishit dhënë urdhër autoriteteve të bregdetit që të na zhduknin barbarisht, ç'duhej vallë të bënim? Të largoheshim natyrisht jo vetëm nga Lartësia juaj por edhe nga perëndia vetë».<sup>1</sup>

Nën komandën e Markos repartet e armatosura sulioete filluan veprimet kundër ushtrisë osmane. Leonitiu shkruan: «Shqiptarët më të zgjedhur, suliotët, qenë të parët që ngritën flamurin e kryengritjes... Lavdia më e madhe e Greqisë së re, Marko Boçari... ngriti flamurin e lirisë në fushën e Janinës para syve të serasqerit Ismail Pasho Beut».<sup>2</sup> Pra ata ishin në krye të luftëtarëve për pavarësinë e Greqisë.<sup>3</sup> Historiani Belvilieri shkruan për rëndësinë e fillimit të luftës së suliotëve kundër osmanëve: «Atëherë e gjithë Greqia e etur për liri e drejtoi vështrimin nga suliotët dhe e ndjeu veten më të gatshme se kurrë për të marrë armët».<sup>4</sup> Po këtë mendim ka edhe Kordhatoja.<sup>5</sup> Ndërsa për Sami Frashërin Marko Boçari ishte një nga nismëtarët e kryengritjes greke.<sup>6</sup>

Aliu filloi t'i shfrytëzonte pakënaqësitë e krijuara për t'i lidhur suliotët njëherë e mirë pas vetes. Këta u treguan të gatshëm të pajtoheshin me të, por në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar. Ata i dërguan pashait përfaqësuesin e tyre Kallogjerin, i cili u takua me Aliun

1) Kujtime lufte prej Kristo Perovoit, Arkivi i Institutit të Historisë (më tej AIH), dosja A.III.146.

2) Leontios Leontiu, *To Albanika Zetema*, Athinë, 1893, z. 77.

3) Jani Llambridhu, *Ipirotika istorika Meletimata*, Athinë, 1904, f. 20.

4) G. Belviglieri, *La Grecia nel 1812*, Estrato della Cronaca del R. Liceo E. Q. Visconti 1877-1878, Roma, 1879, f. 17.

5) Jani Kordhatos, *Istoria tu heleniku ethnus*, vëll. V, pjesa III, f. 219.

6) Sami Frashëri, *Kamus ul'Alam*, I, f. 143.

dhe ky e pyeti: «Shqiponja e Samonivës, Marko Boçari... dhe kapedanë të tjerë trima, ku janë?... E shoh se njerëzit që janë nga më të shtypurit, e kanë edhe të drejtën me vete».<sup>1</sup>

Aliu i propozoi Kallogjerit këtë projekt marrëveshje: 1) Suliotët do të marrin Sulin; 2) Atyre do t'u jepet një parapagim të hollash i barabartë me një vit rroge; 3) Do të largohen njëherë e mirë prej ushtrisë osmane; 4) Pasi të arrijnë në fshatrat e tyre, do të fillojnë menjëherë nga veprimtaria luftarake kundër osmanëve; 5) Si garanci për zbatimin e marrëveshjes do të shkëmbehen pengjet; 6) Suliotët do të marrin të gjitha fshatrat e Sulit me përjashtim të Kako Sulit.<sup>2</sup> Pastaj Aliu i vuri në dukje Kallogjerit se kjo marrëveshje, po të kurorëzohej me sukses, do t'i sillte Greqisë pavarësinë politike dhe theksoi një të vërtetë të pamohueshme: «Rusët, anglezët, austriakët, të gjithë do të jenë armiq të tuaj sapo të mësojnë që ju dëshironi të bëheni popull i pavarur. Mos e harroni kurrë këtë të vërtetë të rëndësishme».<sup>3</sup> Këtë mendim kishte dhe Marko Boçari me suliotët e tij. Duke parë se qeveria greke e dalë nga revolucioni kishte besim të madh të ndihma e Rosisë cariste, më 16 shkurt 1822, ata do t'i përgjigjeshin një letre të kryetarit të qeverisë greke, Mavrokordatos: «Mos krijoni iluzione për ndihmën e mbrojtësit (të Rosisë cariste — K.X.), sepse ne e kuptojmë shumë mirë se do të kemi vdekur derisa ajo të mbërrijë nga veriu. Pse duhet humbur kohë duke pritur ndihmën e Veriut apo të Perëndimit, kur ne vetë, po të dëshirojmë, mund ta mbrojmë luftën e sotme të shenjtë?».<sup>4</sup> Suliotët dhe prijësi i tyre Marko Boçari, ishin treguar shumë më të mençur në çështjen e pavarësisë së Greqisë se disa nga udhëheqësit e kulturuar të revolucionit. Përvoja historike i kishte mësuar se liria duhej të ishte pasojë e gjakut dhe jo dhuratë e të mëdhenjve, të cilët me ve-

1) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit.*: f. 198.

2) Po aty, f. 199.

3) Po aty, f. 200.

4) Notis Botzaris, *Visions Balkaniques*, *vep. e cit.*, f. 122.

primtarinë e tyre politike nuk i kishin dhënë deri atëherë asnjë ndihmë të vërtetë luftës së popujve të Ballkanit, përfshirë edhe popullin grek.<sup>1</sup>

Marrëveshja e përfunduar midis Aliut dhe suliotëve qe një kthesë për fillimin e Revolucionit Grek.<sup>2</sup> «Që nga ky çast, thekson Pukëvili, primarët dhe kapedanët e Etolisë ndërprejnë çdo marrëdhënie me autoritetet turke».<sup>3</sup> Marrëveshja u nënshkrua më 15.1.1821 në Suli në mbledhjen e kryesuar prej Marko Boçarit. Në emër të suliotëve ajo u nënshkrua prej Marko Boçarit, Kiço Xhavellës, Nasho Karabinit, ndërsa në emër të Ali Pashës prej Tahir Abazit, Ago Myhyrdarit etj. Në të thuhej: «Ne të nënshkruarit, agallarë shqiptarë dhe kapedanë suliotë, betohemi secili në besën e vet, ta mbajmë këtë dokument të fortë të pandryshuar. Meqenëse zotëria ynë, Ali Pasha, është rrethuar keq nga Ismaili (Pasho Beu — K.X.) dhe nga pashallarë të tjerë, betohemi të jemi vëllezër, një trup dhe një shpirt, të derdhim gjakun tonë për shpëtimin e këtij zotërie dhe në rast se ndonjëri nga ne turqit (myslimanët shqiptarë — K.X.) do të tregohet i pabesë dhe do të mohojë betimin. të dëbohet nga feja islame dhe të vdesë si cift, po kështu edhe i krishteri të mallkohet nga Krishti. Të gjitha këto ne i pranojmë dhe për sa më sipër në betimin tonë nënshkruajmë: Agallarët, (përfaqësuesit e Aliut — K.X.), Zylyftar Poda, Ago Myhyrdari, Tahir Abazi, Cego Beu. Myrto Cali, Elmas Meco. Suleiman Meto, Iliaz Lulehu, Koxhar Miçani, Hasan Belushi etj.

Kapedanët suliotë: Marko Bocari, Noti Boçari, Jorgji Dhrako. Kico Xhavela. Kiço Lapi».<sup>4</sup>

Midis dy palëve nënshkrues të aleancës, sic ishte zakoni i kohës. u shkëmbyen pengje. Nga pala sulioete Markoja propozoi të shkonte vetë peng, por meqenëse të dyja palët kishin nevojë për të, në vend të tij vajtën i

1) Leander I. Vranusi, *Athanasis Psalidhas o dhidhaskollos tu jenus (1767-1829)*, Janinë 1952, f. 36.

2) Dhimitër Karaxeni, *vep. e cit.*, f. 19.

3) Dhimitër Manu, *vep. e cit.*, f. 393.

4) *Po aty.*

vëllai Kostandini, njerka e Markos me djalin e saj Stratin, e shoqja e Markos me fëmijët, të dy motrat e Markos Angjeliqi dhe Helena.<sup>1</sup>

Pasi mori vesh këtë marrëveshje pushteti osman shpalli se koka e Markos dhe e Noti Boçarit do t'i paguheshin shtrenjtë atyre që do t'i sillnin të prera dhe se të gjithë të krishterët do të masakroheshin.

Kjo marrëveshje gjeti jehonë të menjëhershme në krijimin popullor:

*Ahu, ç'gjet Ali Pashanë,  
Që ra në mëri me mbret,  
E trashëgoi Kauristanë,  
Fund e krei në sherr'këllet.  
Dërgoi fjalë poshtë e lart,  
E ngriti Kauristanë,  
Tahir Abazi një plak  
Në Sul e ngriti rajanë.<sup>2</sup>*

Suliotët zgjodhën si komandant të tyre të përgjithshëm Noti Boçarin, i cili nga 900 veta që kishte më parë mbledhi 3500 luftëtarë. Marko Boçari u caktua në krye të një reparti të përbërë prej 240 vetash. Në prill të vitit 1821 suliotët, të udhëhequr nga Marko Boçari dhe Gjergj Drakoja, filluan goditjet kundër forcave osmane në Bogorica. Qyteti mbrohej nga 1500 ushtarë osmanë, ndërsa Markoja kishte 840. Beteja zgjati dy orë e gjysmë dhe armiqtë u detyruan të largohen duke lënë mbi 32 të vdekur e të plagosur. Më 25 prill 1821, suliotët me aleatët e tyre, rreth 2500 veta, me kapedanët Marko Boçari, Noti Boçari, Drako, Fotomara, heteristin grek Perevosi (në dhjetor të vitit 1820 ai kishte qenë në Suli dhe ishte marrë vesh me suliotët për aleancën e ardhshme), Ago Myhyrdari etj. iu drejtuan Prevezës. Meqenëse Ago Myhyrdari nuk ishte

1) Dh. A. Ikonomu, *To Suli i suliote qe ikojenia Boçari*, Athinë, 1951, f. 193.

2) Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1922), III, Tiranë, 1961, f. 15.



vënë në dijeni për goditjen e forcave osmane në këtë qytet, ai nuk e miratoi sulmin. Atëherë ndërhyri Noti Boçari e tha se duhej të ishte vënë në dijeni medemos, përndryshe marrëveshja do të shkelej. «Unë s'jam dakord me këtë dhe do të hiqem mënjanë»,<sup>1</sup> — deklaroi ai. Para rrezikut të përçarjes, u detyruan të merrnin edhe mendimin e Ago Myhyrdarit. Ky i fundit e kundërshtoi sulmin.

Në dhjetëditëshin e parë të muajit maj suliotët i ranë Variadhës, që mbrohej nga rreth 1600 ushtarë osmanë. Pas një bllokade prej një muaji ushtarët osmanë e lanë fshatin. Ata nuk u lejuan të shkonin në Janinë, por në Artë. Gjatë periudhës që vazhdonte bllokada, Marko Boçari dhe Llambro Zarba me 350 suliotë i ranë fshatit Dervizan, që mbrohej nga 1500 osmanë, të cilët u detyruan të tërhiqen nga Paramithia.<sup>2</sup>

Më 8 qershor 1821 u nënshkrua një traktat tjetër midis suliotëve dhe agallarëve shqiptarë myslimanë të Margëlliçit. Sipas këtij traktati asnjëra palë nuk do të sulmonte tjetrën. Suliotët mund të bashkoheshin me Revolucionin Grek, por nuk do t'i trazonin pronat e agallarëve dhe familjet e tyre, dhe anasjelltas, agallarët mund të bashkoheshin me Hurshid Pashën (i cili kishte zëvendësuar Ismail Pasho Beun, — K.X.) por nuk do të luftonin kundër suliotëve.<sup>3</sup>

Ky traktat ishte i pamjaftueshëm për kryengritësit grekë. Aleksandër Ipsilanti, kryetar i Heterisë së Miqve, më 21 janar 1821, para se të shpërthente revolucionin, duke mos qenë në dijeni të traktatit të 15 janarit, i kishte shkruar Teodor Kollokotronit se suliotët i konsideronte një bërthamë të re të revolucionit, prandaj ai duhej t'i nxishte këta për aleancë me Aliun. I vëllai i Aleksandër Ipsilantit, Dhimitri, që posa kishte mbërritur në Greqi, u shkroi krerëve shqiptarë të Çamërisë, «Komandantëve trimë Pronjo dhe Çapari dhe gjithë çamëve», ku i ftonte

---

1) Dhimitër Manu, *vep. e cit.*, II, f. 408-414.

2) *Po aty*, f. 417-419.

3) Notis Botzaris, *vep. e cit.*, f. 422,

të ngriheshin në luftën e përbashkët.<sup>1</sup> Midis të tjerash në të thuhej: «Jam i informuar se po qëndroni neutral midis luftës sonë dhe tiranisë. Unë dhe atdheu im ju falenderojmë por fama e trimërisë dhe e arritjeve tuaja më shtyjnë t'ju shkruaj, me qëllim që të gjithë, të vegjël e të mëdhenj, të rrokni armët, të lidheni me ne dhe të luftoni padrejtësinë e tiranit tonë, rënia e të cilit, meqenëse është e afërt, nuk kërkon veçse pak mundim, që të gëzojmë me qetësi dhe drejtësisht frytet e fitoreve tona. Atdheu do të kurorëzojë kokat e të gjithë atletëve (luftëtarëve) të kësaj lufte të shenjtë, këta dhe pasardhësit e tyre do të jenë të lumtur».<sup>2</sup> Traktati i nënshkruar më 8 qershor u përtërit me një përmbajtje më të gjerë më 1 shtator 1821 në Peta të Artës, në të cilin hyjnë dhe kryengritësit grekë të Akarnanisë.

Më 12 korrik 1821, Dhimitër Ipsilanti u bëri një thirrje me të njëjtën përmbajtje edhe himariotëve<sup>3</sup>, por as me të parët, as me të dytët nuk ia arriti qëllimit përfundimtar. Duhet vënë në dukje se ndryshe nga Ipsilantët, Aleksandër Mavrokordatoja nuk e dëshironte një aleancë të fuqishme midis kryengritësve grekë dhe shqiptarëve myslimanë të Ali Pashës, nga frika se mos këta të fundit fitonin epërsi në luftën për pavarësi dhe bëheshin të rrezikshëm për udhëheqësin grek. Këtë vijë të prishjes së aleancës ai do ta ndiqte hap pas hapi. Në qershor 1821, Hurshid Pasha dërgoi në fshatrat Sirak e Kalarit (fshatra malore në Pind) një ushtri osmane prej 7000 vetash për të mbikqyrur komunikacionin midis Epirit dhe Tesalisë. Dy katundet e mësipërme bashkë me ato të Gotishtit, Krapsit, Prosgalës, Kacanohorët, më 6 korrik 1821, shpallën kryengritjen, rrëmbyen armët dhe i dëbuan që andej repartet osmane. Ky veprim u kurorëzua me sukses vetëm në saje të ndihmës së shpejtë të Marko Boçarit dhe kërdisë që ai bëri mbi armiqtë. Por pasi ky u kthye

1) Notis Botzaris, *vep. e cit.*, f. 47.

2) J. Joan Filimonos, *Dokimion istorikon*, ... f. 145.

3) Joan Filimonos, *vep. e cit.*, f. 146.

në Suli, Hurshid Pasha mundi t'i thyente kryengritësit<sup>1</sup> dhe të rivendoste atje sundimin e tij.

Aleanca midis Ali Pashës, shqiptarëve të Sulit dhe etolo-akarnanëve nisi me fitore. Gjatë muajve maj-qershor 1821 u bënë betejat në Makrinoros dhe në Peta, më 15 korrik ajo e Xhumerkës ku morën pjesë kryesisht suliotët nën komandën e Kiço Xhavellës dhe të Drakos. U çliruan mjaft fshatra. Më 11 shtator 1821 u bë beteja e dytë në Peta dhe forcat osmane u detyruan të tërhiqen. Më 26-27 korrik 1821 u bë përleshja në Plaka midis aleatëve nga njëra anë dhe reparteve osmane nga ana tjetër. Në këtë betejë forcat osmane u dërrmuan, por nga ana e aleatëve u plagos komandanti kryesor Marko Boçari. Në këtë luftë kundër ushtrisë osmane mori pjesë edhe shqiptari Sulejman Meto me një repart të tij,<sup>2</sup> dhe miku i ngushtë i Marko Boçarit, Gjergj Athanas Gjirokastriti nga Gjirokastra. Gjergji ishte pesë vjet më i ri nga Markoja. Ai kishte qenë në shërbim të Ali Pashës dhe kur shpërtheu Revolucioni Grek u bashkua me repartet e Markos. Markoja e çmonte shumë Athanas Gjirokastritin për shpejtësinë me të cilën ai zbatonte urdhrat e tij. Të dy bashkë ata luftuan derisa Markoja u vra. Pastaj Athanasi e vazhdoi luftën me reparte të tjera të kryengritësve grekë.

Beteja në Plaka që e pabarabartë. Sipas Filimonit ushtria osmane përbëhej prej 4000 vetash, ndërsa kundërshtarët ishin vetëm 400. Filimoni shkruan: «Markoja, duke pëlqyer sipas sistemit të tij, betejat e shkurtra, me anë të mësymjeve vendimtare, bënte plane që të sulmohej armiku në qendër me të gjitha forcat. Kështu, ky u hodh i pari gjatë natës së 29 korrikut me 125 luftëtarë, i shpërndau armiqtë, duke dëmtuar mbi 200.<sup>3</sup> Markoja ishte

---

1) Joanu Llambridhu, *vep. e cit.*, vëll. V, (B), f. 60; Dhimitru Karaxeni, *vep. e cit.*, f. 33, 34.

2) Dhimitër Karaxeni, *vep. e cit.*, f. 34.

3) Joan Filimonos, *vep. e cit.*, f. 165-166.

rrethuar nga një armik me forca dhjetëfish më të mëdha.<sup>1</sup> Mësymja që e përgjakshme, Markoja u plagos dhe u kthye në Suli për t'u shëruar. Disfata e ushtrisë osmane do të ishte edhe më e rëndë po të mos kishte ndodhur plagosja e Markos.<sup>2</sup> Në këtë betejë Markoja sulmoi natën me pak suliotë të zgjedhur, duke shkatërruar gjithçka «si luan i egërsuar».<sup>3</sup> Kryengritësit nuk qëndruan në Plaka dhe më vonë osmanët e ripushtuan. Marko Boçari i porositi suliotët që ta forconin më tej aleancën me forcat e Aliut dhe të mos lejonin asnjë të çarë midis tyre. Por kjo lidhje nuk do të varej vetëm prej tij edhe as prej suliotëve.

Në gusht 1821 rrethimi i Aliut nga Hurshid Pasha u ngushtua edhe më shumë. Aliu kërkoi nga aleatët që t'i binin Hurshidit nga krahët, duke u premtuar shpërblime të mëdha. Ai i shpalli të lira të gjitha fshatrat çifligje të tij. Aleatët vendosën që ta sulmonin Artën me qëllim që forcat armike të tërhiqeshin nga rrethimi. Më 11 shtator bëhet një tjetër betejë në Peta dhe forcat osmane tërhiqen në Artë. Më datën 1.9.1821 aleatët nënshkruan në Petë një traktat tjetër që ishte përsëritja e atij të datës 15.1.1821.<sup>4</sup>

Në fshatin Mospina aleatët e thyen ushtrinë osmane. Afër Janinës, në malin pranë Dervizanës, 350 suliotë së bashku me aleatët e tyre u ndeshën me një ushtri osmane të përbërë prej feudalëve shqiptarë dhe me repartet e tyre të mobilizuara andej-këndej. Në këtë betejë aleatët korrën fitore dhe pala kundërshtarë kërkoi paqe. Suliotët u sollën bujarisht me shqiptarët myslimanë, duke i lejuar të merrnin me vete jo vetëm armët, por edhe plaçkat, kafshët e gjithçka që kishin. «Jemi, u thanë, miqtë tuaj besnikë dhe po të rastisë që të biem përsëri në luftë me

---

1) Camillo Paganel, *La tomba di Marco Botzari*, Messina, 1837, f. 127.

2) Gjeorgjiu Ep. Papajani, *vep. e cit.*, f. 47.

3) J. Gazis, *Leksikon tis Epanastaseos qe alla erga*, Janinë 1971, f. 46.

4) Dhimitër Karaxeni, *vep. e cit.*, f. 46.

ju, prapë këtë miqësi do ta ruajmë ndaj jush dhe pastaj hëngrën së bashku, u përqaftuan dhe vallëzuan».<sup>1</sup>

Ndonëse këta shqiptarë u ndodhën në dy kampe të ndryshme dhe me fe të ndryshme, nuk e harronin kombësinë e tyre të përbashkët. Njëra palë u nis për në Paramithi, ndërsa suliotët për në Pesë Puset (ose Pesë Buri-met), ku e thyen edhe një herë ushtrinë osmane që gjetën atje. Turqit e mundur te Pesë Puset u pritën prej shqiptarëve me tallje.<sup>2</sup> Atëhere sulltani urdhëroi që ushtritë osmane të përdornin terrorin.<sup>3</sup>

Në ngushticën e Komicadës suliotët i sulmuan përsëri repartet osmane. Këta u shpërndanë duke lënë thesarin, municionet, mjaft të vdekur e të plagosur dhe disa robër në duar të Marko Boçarit. Osmanët hodhën armët, vëren Pukëvili, për të shpëtuar sa më parë nga frika, «nga kjo perëndëshë energjike e të poshtërve».<sup>4</sup> Reparti i Markos me këngë në gojë u nis menjëherë për te Pesë Puset, por osmanët ua kishin mbathur këmbëve dhe Markoja mboldhi armët e tyre të braktisura. Jehona e sukseseve të suliotëve me Marko Boçarin në krye arriti deri në Prevezë, në Akarnani dhe në Termopilet.<sup>5</sup> Gjatë luftimeve Markoja çliroi edhe Rënjasën, Variadhën, Dhramason, Kasmicanin, Rapshtejin.<sup>6</sup>

Suliotët dhe vetë Markoja e kishin treguar veten edhe një herë ashtu siç e kishin përcaktuar dy udhëtarë evropianë në Greqi: «me trup të lidhur, ata janë të fortë si luanët dhe të shkathët si cjeptë. Unë i kam parë granatierët krenarë të Napoleonit, i njoh edhe rojet krye-

---

1) Joan Filimonos, *vep. e cit.*, f. 291.

2) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit.*, f. 227.

3) Brûnet de Presle, Al Blanchet, *La Grèce depuis la conquête romaine jusqu'à nos jours*, Paris, 1860, f. 434.

4) F. C. H. L. Pouqueville, *Histoire... Livre quatrième*, f. 218-220.

5) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit.*, f. 221.

6) Elefterudhaqi, *Engjilopedhikon Leksikon*, 1930, vëll. 9, f. 590.

lartë anglezë, por, me sa duket, suliotët ua kalojnë të dyja paleve.»<sup>1</sup>

Lufta ishte e vështirë për aleatët sepse atyre u mungonin municionet ushtarake si plumbi e baruti. Për këtë arsye ata u mblohdën në Peta dhe më 29 tetor 1821 i dërguan një letër Mavrokordatos, në të cilën i luteshin që t'i përgjigjej sa më parë nevojave të mësipërme, përndryshe do të rrezikohej marrja e Artës.<sup>2</sup> Ata i shkruan edhe peshkopit të Vonicës që të mblidhte të dhjetat e drithit për ushqimin e ushtrisë.<sup>3</sup> Me këtë rast të dyja palët nënshkruan edhe një marrëveshje të re. Në këtë marrëveshje, midis të tjerash, shihet dëshira e të dyja palëve për ta përmbytur Ali Pashën, në rast fitoreje gjatë ushtrimit të pushtetit të tij dhe në përgjithësi ta forconin luftën kundër osmanëve duke i dhënë karakter më masiv. Sidoqoftë, aleatët u treguan të vendosur që ta çlironin Aliun nga rrethimi.

Në mes të nëntorit 1821 komandantët suliotë Marko dhe Noti Boçari, Zerva, Athanas Fotomara dhe Nikolla Xhavella, bashkë me komandantët shqiptarë muhamedanë Tahir Abazi, Ago Myhyrdari e të tjerë, pasi morën edhe miratimin e Mavrokordatos,<sup>4</sup> i ranë ushtrisë osmane të Hurshid Pashës. Në brigjet e lumit Arah ata u bashkuan me kryengritësit grekë, etolianë dhe akarnanë e rrethuan forcat osmane në Artë. Forcat aleate ishin rreth tre mijë burra, prej të cilëve rreth dy mijë shqiptarë myslimanë, midis të cilëve një mijë suliotë dhe pak grekë të Etolisë dhe Akarnanisë.<sup>5</sup> Ushtria armike përbëhej prej 5000 këmbësorësh dhe 1000 kalorësish. Aleatët e rrethuan Artën jo vetëm që të lehtësonin pozitën e Ali Pashës në Janinë, por edhe të bënin një diversion në favor të kryengritësve të Moresë, kundër të cilëve

---

1) J. Emerson et C-te Pechio, *Tableau de la Grèce en 1825*; Paris, 1826, f. 328.

2) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit., livre sixième*, f. 76.

3) *Parnasos*, Athinë, 1888, f. 34.

4) Dhimitër Karaxeni, *vep. e cit., f. 54*.

5) *Po aty*, f. 55.

drejtoheshin forcat kryesore osmane. Marko Boçari kishte mbërritur me repartet e tij para mësymjes. Më 13 nëntor armiku sulmoi me forcë pozicionet e Marko Boçarit dhe të Xhavellës, por pa rezultat. Të nesërmen, më 14 nëntor 1821 Marko Boçari shkoi në Peta dhe u kthye prej andej me 1000 kryengritës të tjerë. Beteja që u bë aty u fitua nga aleatët. Ata hynë në qytet dhe çliruan pjesën më të madhe të tij. Qyteti do të ishte çliruar i tëri në qoftë se luftëtarët aleatë, me gjithë përpjekjet e Marko Boçarit për t'i ndalur, nuk do të kishin rënë mbas plaçkës. Sidoqoftë, pozitat e armikut u dëmtuan rëndë.<sup>1</sup> Një rol vendimtar në këtë ndeshje luajti Marko Boçari bashkë me një arbëresh tjetër, Gjergj Karaiskaqin. Kurajua e tij e madhe që në fillim të betejës bëri që në luftë të futeshin edhe disa grupe kryengritësish grekë që në fillim ishin tërhequr.<sup>2</sup> Makrijani, gjenerali i mëvonshëm i Revolucionit Grek, që mori pjesë në këtë betejë vë në dukje se pas sulmit të parë u formua një grup luftëtarësh prej 300 vetash nën komandën e Marko Boçarit, Karaiskaqit e disa të tjerëve, midis të cilëve edhe të birit Myrto Calit. Këta të 300 «nuk ishin njerëz, por luanë dhe shqiponja».<sup>3</sup> Ata marshuan kundër osmanëve, i nxorën ata jashtë qytetit, me përjashtim të forcave ushtarake që ishin mbyllur në kështjellë. Sipas Birit, shqiptarët myslimanë që morën pjesë në këtë betejë ishin 1200 veta, por rolin kryesor e luajti Marko Boçari.<sup>4</sup> Izamberti shkruan: «Trimi dhe i papërlyeri suliot, Marko Boçari, që udhëhiqte veprimtarinë ushtarake në këtë krahinë, shtiu në dorë Artën».<sup>5</sup> Marko Boçari që njëri nga

1) Dhimitër Karaxeni, *vep. e cit.*, f. 42-43.

2) Gjergjiu Ep. Papajani, *E tris megalitere Simfore ton elinon kataton ieron agona*, Athinë, 1978, f. 100.

3) Gjergjiu Ep. Papajani, *vep. cit.*, f. 101.

4) *Po aty*.

5) Gaston Isambert, *L'indépendance grecque et l'Europe*, Paris, 1900. f. 86.

kryesorët që ngriti flamurin e pavarësisë në Artë,<sup>1</sup> e cila në atë kohë kishte mbi 6000 banorë.<sup>2</sup>

Meqenëse aleanca ende nuk ishte miratuar dhe nënshkruar zyrtarisht nga qeveria greke, krerët muhamedanë shqiptarë dhe ata suliotë vendosën të vinin në kontakt të drejtpërdrejtë me autoritetet qeveritare greke. Ata caktuan përfaqësues të tyre Tahir Abazin dhe Aleks Nucun, vëllamin e Ali Pashës, të cilët u nisën për në Peloponez. Gjatë udhëtimit, Tahir Abazi vuri re se nëpër fshatrat ku kalonte kryengritësit grekë kishin prishur xhamitë dhe kishin keqtrajtuar familjet myslimane. I fyer nga kjo gjë ai hoqi dorë nga udhëtimi dhe u kthye në Artë. Atje u mor vesh me shokët e tij dhe së bashku me ta vendosën ta prishnin aleancën e të bashkoheshin me Hurshid Pashën kundër Aliut. Vetëm Myrto Cali dhe Hysen Pasha i qëndruan besnikë Aliut dhe e mbrojtën aleancën.<sup>3</sup>

Gjatë këtyre veprimeve, kryengritësit grekë me urdhrin e të tjerëve bastisën shtëpitë e feudalëve turq dhe të shqiptarëve myslimanë. Kështu ata sillëshin njëlloj si me shqiptarët myslimanë ashtu edhe me turqit, duke njësuar fenë me kombësinë. Dashur pa dashur ata bënë punën e pushtuesit, i cili kërkonte që t'i përçante dhe t'i sundonte të dyja palët. Ishte e qartë se në kushtet e krijuara, aleanca do të dështonte.

K. Rizos Nerulos vë në dukje se qeveria greke gaboi kur caktoi Mesolongjin e largët si vend bisedimesh midis kryengritësve dhe të deleguarve të Ali Pashës, gjë që lejoi Tahir Abazin dhe Ago Vasjarin të vështronin se si bastiseshin shtëpitë e myslimanëve shqiptarë dhe se si

---

1) Mm. e Dufrenay, *Beautés de l'Histoire de la Grèce moderne ou récits des faits memoriaux des Héllènes depuis 1770 jusqu'à ces jours* f. 266.

2) Broughton G. C. B, *Travels in Albania and other provinces of Turkey in 1809 a 1810*, vëll. I, f. 34.

3) Kosta Biri, *Arvanites, oi dories to neoteru eliniz mu*, Athinë 1961, f. 346.



shkelej feja e tyre.<sup>1</sup> Këtë mendim ka shprehur edhe Rei-boja.<sup>2</sup> Megjithatë, caktimi i vendit për bisedime nuk kishte asnjë rëndësi për çështjen, sepse ky qëndrim do të zbulohet më vonë dhe pasojat do të ishin të njëjta.

Rafëneli e paraqet kështu problemin: «Shqiptarët myslimanë i vështrojnë bashkëfetarët e tyre aziatikë si armiq të tyre të vërtetë. Këtu e kishte zanafillën marrëveshja që ata dëshiruan të bënin me grekët. Këta (grekët — K.X.) do të kishin fituar me ata miq të devotshëm sikur të kishin ditur t'i bënin për vete».<sup>3</sup> Kjo aleancë, shton ai, do të ishte e leverdishme për kryengritësit grekë, sepse shqiptarët ishin luftëtarë të shkëlqyer, por udhëheqësit e qeverisë greke nuk treguan mirënjohje dhe tolerancë fetare ndaj shqiptarëve myslimanë, ndaj këta të fundit hoqën dorë nga aleanca. Më tutje, ai vëren se Tahir Abazi, pasi e pa persekutimin e kultit fetar muhamedan shkoi te Aliu dhe i propozoi atij t'u dorëzohej osmanëve. Meqenëse pashai nuk dëgjoi, Tahir Abazi bëri për vete një pjesë të garnizonit të kështjellës që kishte shërbyer më parë nën urdhrat e tij, u hapi dyert e kështjellës ushtarëve të Hurshid Pashës, prej nga ata depërtuan pa mundim.<sup>4</sup>

Komandanti turk filloi nga intrigat. Ai u tha bejlerëve të Çamërisë se kryengritja greke ishte vepër e Rusisë cariste, se ajo ishte drejtuar kundër gjithçkaje myslimane dhe se do të ishte një dënim qiellor po që se ata lidheshin me të krishterët që shpallnin pavarësinë e tyre nën shenjën e kryqit. Nga kjo propagandë e Hurshid Pashës bejlerët e Çamërisë u tërhoqën. Ata lajmëruan Tahir Abazin e Ago Vasjarin që ndodheshin në luftën e Artës dhe këta i braktisën aleatët e tyre.<sup>5</sup> Pra kjo aleancë

1) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.* f. 389.

2) Maxime Raybaud, *Mémoires sur la Grèce pour servir a l'histoire de la guerre de l'indépendance, tome second*, f. 37-38.

3) C. D. Raffanel, *Histoire complète des événements de la Grèce depuis les premiers troubles jusqu'à ce jour*, tome 1, f. 421.

4) C. D. Raffanel, *vep. e cit.*, f. 421-423.

5) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit.*, f. 199-200.

nuk pati të ardhmen që dëshironin udhëheqësit kryesorë të saj — Marko Boçari dhe udhëheqësit largpamës të kryengritjes greke si Dhimitër Ipsilanti, Theodor Kollokotroni etj. Objektivisht asaj ia vuri minat Aleksandër Mavrokordato, i cili e kishte lajmëruar Tahir Abazin se Greqia luftonte për një shtet të pavarur, ndërsa, sipas thirrjes së Riga Fereos dhe qëllimit të Heterisë, do të luftohej bashkë me shqiptarët dhe me popujt e tjerë të Ballkanit për çlirimin e këtij gadishulli dhe në bazë të aleancës për lirinë e dy popujve shqiptar e grek. Mavrokordatoja nuk lejoi Tahir Abazin që të shkonte në Peloponez për të takuar Kollokotronin, i cili ishte i vendosur për aleancën midis shqiptarëve të Ali Pashë Tepelenës dhe kryengritësve grekë. Ai veptoi kështu sepse vetë e kishte parë se rënia e Tripolicasë, pas largimit të shqiptarëve myslimanë, kishte qenë pasojë e drejtpërdrejtë e asaj aleance. Një nga kapedanët arbëreshë të kryengritjes greke, përkrahës i aleancës, Gjergj Karaiskaçi, iu drejtua me këto fjalë Mavrokordatos: «Këtë tradhti do t'ua shkruaj në ballë».<sup>1</sup> Për veprimin e mësipërm Kollokotroni u sulmua nga primatët, këta madje u përpoqën ta ngrinin popullin kundër tij, por ai nuk u shqetësua aspak dhe i deklaroi sekretarit të tij: «Tani që Perëndia e shenjtë na dha fuqi dhe morëm Tripolicanë, le të thonë ç'të duan...»<sup>2</sup>

Një rol negativ luajti edhe Tahir Abazi, i cili kishte marrë ryshfet nga Omer Vrioni. Kur ai u kthye në Artë u deklaroi agallarëve të tjerë që të merrnin masa për të mos humbur Turqia për një palo plak (Ali Pashën — K.X.)<sup>3</sup>. Që më 20 korrik 1821, Aliu i kishte dërguar një letër Marko Boçarit në Suli, në të cilën e udhëzonte fshehurazi që të vriteshin Tahir Abazi dhe Ago Myhyrdari në rast se këta do të dyshoheshin për dezertim. Markoja kishte pranuar por Noti Boçari e kundërshtoi duke përmendur betimin midis tyre.<sup>4</sup> Pavarësisht nga tërë këto,

1) K. Paparigopulli, *vep. e cit.*, vëll. 5, pjesa II, f. 547.

2) Gjeorgjiu Ep. Papajani, *vep. e cit.*, f. 50.

3) *Po aty*, f. 2.

4) *Po aty*, f. 107.

lufta e përbashkët e shqiptarëve, myslimanë e të krishterë, që nuk kishte qenë përkrahur nga qeveria e Mavrokordatos<sup>1</sup>, kishte çuar në një besnikëri më të madhe midis tyre. Pas prishjes së aleancës, suliotët u nisën për në Lamarë dhe njëri nga komandantët muhamedanë shqiptarë u bëri thirrje për t'u rënë atyre, të kapnin sa të mundnin dhe t'ia dorëzonin Hurshid Pashës, por asnjë nga shqiptarët muhamedanë nuk lëvizi.<sup>2</sup>

Megjithatë, disa elementë udhëheqës të Revolucionit Grek që e kuptonin rëndësinë e aleancës me shqiptarët muhamedanë të Shqipërisë së Jugut, nuk i ndërprejnë përpjekjet sidomos nëpërmjet Marko Boçarit dhe suliotëve.

Duke patur parasysh rrezikun e një sulmi osman, suliotët dërguan Marko Boçarin të kërkonte ndihmë nga qeveria e revolucionit dhe njëkohësisht të shprehte dëshirën që të vazhdonte punën për aleancën me shqiptarët muhamedanë. Parlamenti grek me nxitjen e Marko Boçarit autorizoi qeverinë që t'u dërgojë ndihmë ushtarake të shpejtë suliotëve dhe këta të përfundonin aleancën me shqiptarët muhamedanë dhe të krishterë. Në vendimin e 12 majit të vitit 1822, thuhej: «Për bashkësinë e Sulit, për arsye se është afër, por edhe për marrëdhëniet që ka me shqiptarët, mjeti më i përshtatshëm është që të lidhë marrëveshje me këta.

Në bazë të autorizimit me shkrim, datë 12 maj, nr. 107, të trupit parlamentar, urdhëroj sa më poshtë:

a) Bashkësia e Sulit lejohet të lidhë marrëveshje sa të jetë e mundur më të dobishme me shqiptarët e krishterë e muhamedanë;

b) këto marrëveshje nuk duhet të parashikojnë më shumë privilegje nga sa kanë suliotët;

c) Hiliarku (komandanti i 1000 vetave — K.X.) Jorgji Prishovica, me miratimin e bashkësisë së Sulit, lejohet të marrë pjesë me çamët e krishterë e muhamedanë në ato marrëveshje;

1) Leondër i Vranusi, *vep. e cit.*, f. 67.

2) Dhimitër Karaxeni, *vep. e cit.*, f. 57.

d) Shkëlqesia e tyre Hysen Pasha dhe Myrto Cali, meqë janë treguar të pandarë dhe besnikërisht të bashkuar me suliotët dhe meqë kanë mundësinë të ndikojnë në marrëveshjet që do të bëjnë me muhamedanët, kanë lejen të marrin pjesë gjithashtu, me mendimin dhe miratimin e bashkësisë së Sulit;

e) Të gjitha marrëveshjet që do të përfundohen me të mësipërmët do të miratohen nga administrata (nga qeveria — K.X.)».<sup>1</sup>

Marrëveshja përfundimtare nuk u arrit kurrë, megjithatë është fakt se herë pas here rreth 2000 shqiptarë muhamedanë morën pjesë në Revolucionin Grek bashkë me krerët e tyre.<sup>2</sup>

Marko Boçari vendosi t'i shfrytëzonte mosmarrëveshjet në shtabin e ushtrisë osmane midis feudalëve shqiptarë dhe atyre turq, gjithmonë në favor të aleancës. Pukëvili na informon se në shtabin e Hurshid Pashës ishte dhe një pasha që luante rolin e haznedarit të Hurshidit, kurdi Kars Ali Hani. Ai shkonte keq me një nga komandantët shqiptarë, Mehmet Këlcyrën, të cilin donte ta likuidonte fizikisht. Më 6 dhjetor 1821 Ali Hani e thirri Mehmet Këlcyrën në kështjellën e tij për t'i dhënë gjoja disa lajme, por në fakt për ta vrarë. Mehmet Këlcyra mori me vete 300 veta të armatosur dhe hyri me forcë në sallën e pritjes. I habitur kurdi kërkon të dijë arsyet e një sielljeje të tillë. Kurdi e qëllon me koburë, por nuk e kap. Mehmet Këlcyra e vret atë dhe largohet së bashku me njerëzit e tij. Ushtarët kurdë jashtë pallatit i rrethuan shqiptarët dhe beteja përfundoi keq për ta. Mehmet Këlcyra u vra, disave u prenë kokat dhe «trupat e hedhur nga pullazi lart në lumin e Inakos, vunë në dijeni shqiptarët e tierë për fatin e krveitarit të tyre».<sup>3</sup> Shqiptarët ngritën krye, vranë osmanët që takuan rrugës e u drejtuan në kampin e suliotëve. Ata i quajtën suliotët vëllezër, u kërkuan t'i pranonin në radhët e tyre dhe t'i

1) M. I. Llambrinidhu, *I. Arvanites tis Elladhos*, f. 88.

2) Kosta I. Biri, *vep. cit.*, f. 347.

3) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit.*, f. 200-201.

ndihmonin për të marrë gjakun e shokëve. Marko Boçari i priti me krahë hapur dhe bashkë me ta u drejtua kundër reparteve osmane. Asgjë nuk i qëndroi atij sulmi. Armiku u tërhoq dhe shqiptarët muhamedanë dhe të krishterë mbetën zot të fushës së betejës. Por duke u gdhirë, ata u sulmuan në befasi e në gjumë prej trupave të Hurshid Pashës dhe u shpërndanë. Në shkurt të vitit 1822, siç dihet, sundimi i Ali Pashë Tepelenës, i cili kishte për-krahur vazhdimisht zhvillimin ekonomik, tregtar dhe arsimor të elementit grek kishte marrë fund. Lufta dhe trashëgimi i tij ngjallën shpresa të mëdha për të ardhmen të populli shqiptar.

Megjithatë, kryengritja e Ali Pashës e kishte kryer detyrën e vet për Greqinë. Revolucioni Grek që kishte filluar nuk do të ndërpritej. Sami Frashëri vë në dukje se armët që Aliu u dha kapedanëve të krishterë shqiptarë dhe grekë, këta «i përdorën për pavarësinë e Greqisë».<sup>1</sup> Qe Ali Pasha ai që me qëndresën e tij u hodhi popujve që e rrethonin «britmat madhështore të kushtetutës dhe të lirisë».<sup>2</sup> Kryengritja e Aliut dhe kryengritja greke ndihmuan njëra-tjetrën.<sup>3</sup> Ali Pasha u vra nga sulltani dhe në qoftë se ai nuk arriti të çlirohej nga pushtuesi osman, ndihmoi në mënyrë mjaft aktive për shpëtimin e Revolucionit Grek dhe vdiq duke u lënë vrasësve të tij një numër të madh armiqsh.<sup>4</sup> Kryengritja greke përfitoi shumë nga «kryengritja e Ali Pashë Janinës».<sup>5</sup> Në qoftë se Marko Boçari kishte qenë një nga farkëtuesit kryesorë të aleancës së Ali Pashës me kryengritësit grekë, ai nuk

---

1) Sami Frashëri, *Kamus-ul'Alam*, vëll. 4, f. 315.

2) Francisque Bouvet, *La Turquie et les cabinets de l'Europe depuis le XV-e siècle ou la Question d'Orient*; 1853, f. 69.

3) Eugène Poujade, *vep. e cit.*, f. 14.

4) Dora d'Istria, *Gli Albanesi in Romania, storia dei principi Ghika, nei secoli XVII-XVIII e XIX*; Firenze, 1873, f. 376,

5) Alexandre J. Despotopulos, *La Révolution grecque; Alexandre Ipsilantis et la politique de la Russie*; *Balkans Studies*; vol. 7, number, f. 202.

kishte pasur asnjë mundësi për të parandaluar rënien e tij.

Tani Omer Vrioni i drejtoi të gjitha forcat kundër suliotëve. Më 29 maj 1822 ushtria e tij i sulmoi ata në Suli, por u detyrua të tërhiqet. Gratë sulioete ndoqën burrat e tyre me dyfekun në supe, shpatën ngjeshur, me koburet dhe gjerdanët veshur. Ato inkurajuan trimat dhe i shoqëruan ata në luftime. Ushtria osmane la me qindra të vrarë e të plagosur. Më 31 maj Omer Vrioni i përforcuar vendosi t'i risulmojë suliotët. Këta zhveshën shpatat dhe të mbështetur prej grave të tyre luftuan me thika, çomanga dhe gurë, e humbën dhe e rifituan katër herë rresht Sulin. Në këtë aksion që vazhdoi 11 orë ushtria osmane humbi një numër të madh ushtarësh.

Me gjithë fitoren, forcat e armikut ishin shumë të mëdha. Më datën 9 qershor 1822, Hurshid Pasha, arriti në kampin e Omer Vrionit me trupat e tij të freskëta. Më 10 qershor 1822 filluan luftimet e rrepta në çdo fshat. Suliotët u vunë zjarrin depove, shtinë në dorë artilerinë, flamujt e municionet. Omer Vrioni u detyrua t'ua mbathte këmbëve. Ai hipi mbi një mushkë (suliotët ia kishin zënë kalin rob) dhe Pukëvili vëren me ironi se Omer Vrioni u largua, duke i ardhur më shumë keq për kalin sesa për aziatikët, trupat e të cilëve shtriheshin rrugës.<sup>1</sup> Suliotët kapën shtabin e Omer Vrionit me gjithë placka, ndërsa 600 ushtarë u dorëzuan dhe hodhën armët. Pukëvili tregon se një shqiptar muhamedan plak me emrin Saliko, tosk nga fisi i Tomoritëve (sic duket nga Tomorica e Skraparit — K.X.), u qëndroi besnik suliotëve dhe luftoi me trimëri nën flamurin e tyre. «Ai ishte modeli i burrërisë, i palëkundshëm dhe në ndeshiet më të rënda... Cdo njeriu i vinte keq për këtë plak, çdo njeri e admironte këtë qenie të ngarkuar me vite dhe me dhimbje».<sup>2</sup>

Suliotët u sulën drejt fshatit Komboti, ish-çiflik i Mvftarit, hirit të Ali Pashës dhe atje i thven ushtritë osmane. Në këtë betejë «suliotët treguan një kurajë të

1) F. C. H. L. Pouqueville, *vep. e cit.* 5, f. 156-158.

2) *Po aty*, f. 151.

jashtëzakonshme. Ata kapën kuaj me vlerë, që kalorësit e tyre i kishin braktisur».<sup>1</sup>

Suliotët duke parë rrezikun që u kanosej nga ushtria osmane e Hurshid Pashës vendosën të dërgonin në Peloponez Marko Boçarin, Thanas Drakon dhe Jani Zarbën për të kërkuar ndihmë nga qeveria greke. Ky delegacion sillte edhe letrën e luftëtarëve suliotë të nënshkruar prej Noti Boçarit, Zigur Xhavelës, Gjergj Drakos, Tushi Zervës, Joti Danglliut dhe Llambro Kazmës për kapedanët e Moresë. Pasi vihej në dukje se kishin dërguar letra të tjera lidhur me ngjarjet në Suli dhe qëllimet e Hurshid Pashës pas vdekjes së Aliut, të cilat qenë pritur «pa pikë interesimi» (nga qeveria — K.X.), theksohej se ata «u shtrënguan të dërgojnë aty bashkatdhetarët e tyre Marko Boçarin, Thanas Drakon dhe Llambi Zarbën që t'ua shpjegonin ngjarjet edhe gojarisht, sepse detyrohen të besojnë se ju, ose nuk e çani kokën fare, ose s'kini besim, ose nuk i çmoni si duhet forcat e armikut». Midis të tjerash ata kërkonin që t'u vinin në ndihmë dhe t'u dërgonin në bregdet 3-4 anije për të transportuar në Peloponez gratë dhe fëmijët e tyre «duke marrë përsipër edhe ushqimet e tyre», sepse po të mbeten këtu, jo vetëm që do të jenë në rrezik, por edhe ushqimin do të na e hanë, kurse ky këtu duhet të përdoret vetëm për ata që luftojnë».<sup>2</sup> Në radhë të parë ata kërkonin armë sa më shpejt, përndryshe jo vetëm suliotët do të ishin në rrezik por edhe vetë revolucioni.

Marko Boçari kishte dhe arsye familjare për të shkuar në Peloponez. Ai ishte i interesuar që qeveria greke të binte në marrëveshje me Hurshid Pashën, në bazë të së cilës familja e Hurshidit e zënë rob në Tripolica nga Kollotroni, dhe familja e Markos që ishte kapur nga Hurshid Pasha në kohën e rrethimit të Aliut, të liroheshin çka edhe u arrit dhe tërë pengjet arritën në Korinth. Këtu,

1) Maxime Rayband: *Mémoires sur la Grèce pour servir à l'Histoire de la guerre de l'indépendance*, tome second, Paris MD VI, f. 271, shënimi 1.

2) Kujtime lufte prej Perevosit, *vep. e cit.*, f. 133-136.

kalimthi duhet vënë në dukje se pasi ra në duart e ushtrisë osmane Hurshid Pasha e dërgoi gruan e Markos, Krisullën, së bashku me fëmijët në Larisa te Dramaliu, nga frika se mos Marko e rrëmbente po të qëndronte në Janinë.

Gjatë udhëtimit për në More, Markoja qëndroi në Mesolongji. Atje u takua me kapedanët kryengritës dhe u foli atyre për rëndësinë e luftës së suliotëve. Ai u prit me nderime të mëdha edhe nga Kuvendi i Epidaurit. Kryetarit të qeverisë greke, Aleksandër Mavrokordatos, i bëri përshtypje të madhe plani i Markos, për të goditur armikun në Epir para se ai të zbriste poshtë. Në qoftë se suliotët do të bënin paqe me osmanët, këta do të vërshonin më me forcë kundër revolucionit.<sup>1</sup>

Mavrokordatoja e bëri Markon këshilltar për çështjet e mbrojtjes. Merita e madhe e suliotëve dhe e Marko Boçarit deri tani ishte se ata me gjithë vrasjen e Ali Pashës, e kishin penguar ushtrinë e Hurshid Pashës të hidhej në More.<sup>2</sup>

Në Peloponez, në korrik 1822, Marko Boçari u takua me Kollokotronin. Tripolicaja kishte kohë që kishte rënë në duart e kryengritësve grekë. Shtëpitë e turqve qenë bastisur dhe qenë vrarë rreth dhjetë mijë veta, përfshirë fëmijë, gra dhe pleq pa asnjë faj. Kollokotroni nuk kishte qenë në gjendje të përmbante luftëtarët e vet të zhveshur e të zbathur. Ata kishin shpallur se do të visheshin dhe do të m'atheshin në kurriz të turqve të pasur të Tripolicasë, të cilët në fund të fundit të gjitha ato pasuri i kishin grumbulluar duke grabitur popullsinë e vendit. Ky sulm, siç është vënë re edhe më sipër, ishte bërë pasi shqiptarët myslimanë në shërbim të ushtrisë osmane qenë larguar nga Tripolica, për të mos lënduar aleancën tanimë të njohur.

Qëndrimi i Kollokotronit nuk ishte i rastit. Ai së bashku me Dhimitër Ipsilantin kishin marrë një letër nga Ali Pasha në të cilën ai u thoshte që të ndihmonin

1) Dh. A. Ikonomu, *vep. e cit.*, f. 493.

2) Christian Müller, *Voyage en Grèce et dans les îles ioniennes pendant les six derniers mois de 1821*, Paris, 1822, f. 380-381.



shqiptarët në Tripolica (nja tre mijë veta), që ata të dilnin nga rrethimi. Kollokotroni duke parë se kishte kundërshtarë për këtë zgjidhje, iu drejtua atyre me këto fjalë: «Po të mos pranojmë si do të na quajnë kapedanët arvanitë (myslimanë — K. X.) të Rumelisë, të cilëve u kemi dhënë besën dhe si vëllezër që jemi duhet t'i nderojmë?»<sup>1</sup> Mirëpo masakra e lartpërmendur kishte rrezik të përlyente të gjithë çështjen e Revolucionit Grek në sytë e opinionit përparimtar të Evropës Perëndimore. «Lidhja e shenjtë» e kishte pritur me këmbët e para revolucionin në Greqi dhe vazhdonte ta konsideronte me djallëzi atë si një lëvizje komitësh. Ajo kërkonte ta shfrytëzonte bastisjen që kishte ndodhur për interesat e veta. Ndaj qeveria greke që sapo kishte shpallur qëllimin e lartë, çlirimtar të atij revolucioni ishte shqetësuar. I shqetësuar ishte për këtë edhe Marko Boçari.

Kollokotroni ishte lajmëruar për mbërritjen e Markos. Ai doli ta priste veshur me një uniformë ushtarake tepër luksoze. Nga ana e tij Markoja ishte veshur me rrobat e një luftëtari të thjeshtë. Kur Kollokotroni e pa Markon me këtë veshje, ai u largua menjëherë. Të nesërmen u kthye i veshur si dhe ai. «Tani je veshur si trim,» ia priti Markoja. Pasi Kollokotroni i tregoi betejat e tij fitimtare kundër armicve, Marko Boçari bëri këtë vërejtje për kasaphanën e Tripolicasë: ««Vëlla! Pse lejoje që në Tripolica të bëheshin ato të liga, që e diskreditoinë luftën tonë dhe e leiojnë Evropën të na bëjë kaq akuza?»<sup>2</sup> Sipas De la Zhonkierit, Markoja iu drejtua Kollokotronit me këto fjalë: «Shok unë e admiroj kurajën e ushtarëve të tu, por ata duhej të ndaloheshin që të kryenin veprimet që kanë njiolosur çështien tonë të shenjtë; në vend që të mbyteshin gratë dhe fëmijët do të vlen të më shumë që të pajtohej interesi kombëtar me detyrat e njerëzimit dhe popullsia turke e Tripolicasë të dërgohej në Patras. Korone dhe në Modonë. Duke qenë të detyruar të ushqenin njëzet mijë të uritur më shumë,

1) Gjeorgjiu Ep. Papajani, *vep. e cit.*, f. 49.

2) Jani Benekos, *vep. e cit.*, f. 360.

këto kështjella nuk do të mund të qëndronin dhe ne do të ishim zotër të tyre para shumë kohe».<sup>1</sup>

Kollokotroni e ndjeu veten në pozitë të vështirë dhe heshti. Ai e njihte madhësinë e njeriut me të cilin bisedonte dhe qortimin nuk mund ta merrte ndryshe veçse si një këshillë që do t'i shërbente për kryerjen e detyrave të mëdha. Për këtë flet edhe Dora d'Istria, ajo thotë: «Ai (Kollokotroni — K. X.) kishte mbuluar kokën me një pëlhurë të çmuar, ishte i armatosur me një shpatë të ndritshme, ndërsa heroi i Shqipërisë (Marko Boçari — K. X.) kishte një xhakëtë prej pëlhure të kaltër, një rrip prej liri dhe një kapotë të bardhë me qime të gjata dhie. Kollokotroni ishte aq i zgjuar për ta kuptuar mësimin që mori. Të nesërmen ai u vesh me rrobat plot lavdi të klefrit, të shpuara nga plumbat e turqve, kishte shpatën e tij të vjetër dhe pa asnjë zbukurim. Boçari u ngrit me respekt dhe duke i dhënë dorën me përzemërsinë e zakonshme i tha: «Vëlla, tani qenke veshur me kostumin e një trimi» dhe, pasi i foli për trimërinë e ushtarëve të tij dhe për arritjet e tyre, ai nuk pati frikë t'i qortonte grekët (kryengritësit grekë — K. X.), veprimet e të cilëve në Tripolicia, në Neokastron e në Monoemvasia kishin njollosur çështjen e shenjtë».<sup>2</sup> Marko Boçari ishte një luftëtar largpamës e diplomat. Të tillë burra Greqisë do t'i vlenin shumë për fitoren e pavarësisë së vet, në kushtet kur ajo kishte të bënte me armiq të egër e me një reaksion botëror të tërbuar. Me t'u kthyer në Mesolongj Marko Boçari u njoh me të birin e vëllamit të tij, Gjeneo Kollokotronin, i cili e ka përshkruar suliotin trim si një njeri të urtë, të thjeshtë e që të bënte për vete.<sup>3</sup> Ai kthehet menjëherë te suliotët e tij. Marko Boçari nuk i duronte abuzimet e revolucionit; megjithatë, disa syresh nuk mund të mënjanohehin.

1) Le v-te A. de la, Jonquières *Histoire de l'Empire Ottoman depuis les origines jusqu'au Traite de Berlin*, Paris, 1881, f. 440.

2) Dora d'Istria, *Excursion en Roumélie et en Morée*, Zurich, Paris, 1863, vëll. 21, f. 355.

3) Apostolu E. Vakallopullu, *Istoria tu neu elenizmu*, T. St. Thessaloniki, 1982, f. 152.

Flota osmane e kishte bllokuar bregdetin prej nga suliotët furnizoheshin me ushqime. Kjo gjë i kishte futur Marko Boçarit dhimbje në shpirt. Me disa trima ai vendosi që të bashkohej me bashkëvendësit e tij, megjithëse krahinat nga do të kalonte qenë mbushur me armiq. Më 3 korrik 1822 në mbrëmje Markoja u nis për në fshatin Qafa të Sulit. Rruga ishte e gjatë. Ai udhëtoi shumë gjatë me qëllim që t'u jepte armiqve «një goditje të tillë që e ka bërë emrin e Boçarit kaq të llahtarshëm për turqit e asaj krahine, tmerrin dhe vdekjen në kampin e armiqve».<sup>1</sup> Ai nuk mundi të arrinte në kohën e duhur sepse u thye nga osmanët në Plaka. Jemi në prag të betejës së fundit në Peta.

Markoja u tërhoq në këtë qytet pranë bregut të majtë të lumit Arta. Me të marrë vesh dështimin në Plaka, Mavrokordatoja arriti aty së bashku me vullnetarët evropianë që kishin ardhur në Greqi për të marrë pjesë me armë në luftën për pavarësinë e saj. Pas tij arriti edhe Gogo Bakolla, kapedani i krahinës së Xhumerkës, vrasësi i Kiço Boçarit. Bakolla ishte lidhur fshehurazi me Hurshid Pashën. Ai tha se kishte ardhur gjoja për t'u pajtur me Markon, kurse qëllimi i tij ishte për të ndjekur lëvizjet e kryengritësve dhe për t'u raportuar osmanëve për këtë. «Heroi suliot, tregon Sucoja, i besoi pendesës së tij dhe deshi të sakrifikonte meritë personale për të mirën e lirisë; ai e thirri Gogo Bakollën në çadrën e vet dhe duke i shtrirë dorën i tha: «O hije e babait tim, mos u zemëro në qoftë se unë do të përqafoj armikun tënd»».<sup>2</sup> Bakolla bëri sikur u prek nga kjo sjellje bujare, por mendonte të gjente rastin për ta tradhtuar Markon dhe suliotët e tij. Në të vërtetë, ishte një njeri i egër dhe hakmarrës.<sup>3</sup>

1) Maxime Raybaud; *vep. e cit.*, f. 276, 277.

2) Alexandre Soutzo, *Histoire de la révolution grecque*, Paris MDCCCXIX, f. 406.

3) Lucien Davesiès de Pontés, *Notes sur la Grèce*, Paris, 1864, f. 363.

Më 26 qershor 1822 Markoja i kishte shkruar një le-  
tër për ndihmë me këtë përmbajtje kapedanit grek Var-  
nakiotit: «Gjeneral fort trim! Po të shkruaj përsëri. Kam  
nevojë që sonte të marrësh edhe kapedanët e tjerë dhe  
të urdhërosh, do të shkruaj letra për në Suli dhe duhet  
të di se ç'të shkruaj. Ushtria të mbetet aty. Dhe zotëria  
jote me kapedanët të urdhërosh patjetër.»<sup>1</sup> Mjerisht kjo  
ndihmë s'erdhi kurrë. Duke parë se municionet ishin të  
pamjaftueshme, ai më 2 korrik nga Peta i dërgoi një le-  
tër Jorgji Turturit në Zantë: «E di që kam shumë njerëz  
prandaj të më dërgosh çdo ditë katër shishe me verë dhe  
gjysmë oke oriz». Fjalët e letrës ishin të koduara. Vera  
tregonte bucelat me barut dhe orizi një kandar me plu-  
mba.<sup>2</sup>

Pjesa më e madhe e ditës së 3 korrikut 1822 kaloi  
me diskutimet e këshillit të luftës se si të thyhej më  
mirë dhe më shpejt armiku. Këshilli përbëhej nga gje-  
nerali gjerman Norman, koloneli italian Tarela, kolo-  
neli francez Dania, Spiro Pano, Marko Boçari dhe Gogo  
Bakolla. Tarela ishte i mendimit që regjimenti i vull-  
netarëve evropianë të qëndronte në rezervë në lartësitë  
e Petës, ndërsa kryengritësit që përbënin ushtrinë e pa-  
rregullt të shpërndaheshin në gërmadhat e fshatit, afër  
pllajës përpara tij dhe në fillim të rrugës për në Komboti.  
Marko Boçari e miratoi këtë mendim, sepse kjo mënyrë  
veprimi kontrollonte njëkohësisht të dyshimtët. Por ko-  
loneli francez Dania u shpreh kundër. Ai nuk dëshironte  
të lëshonte pozitat e zëna prej vullnetarëve evropianë me  
të arritur në Peta. Gjenerali gjerman, Norman, e pranoi  
mendimin e Danias sepse lëshimi i pozitave nga ana e  
trupave të rregullta do të ndikonte keq te kryengritësit  
e Greqisë, të cilët do ta ndienin se ishin vënë në pozita  
më të vështira. Shumica e oficerëve që me këtë mendim.<sup>3</sup>

1) Dhionis Kokinu, *vep. e cit.*, vëll. 2, f. 97.

2) Niku Zhagu, *Marko Boçari*, f. 147.

3) Maxime Raybaud, *vep. e cit.*, f. 320-321; Dhimitër Karaxeni,  
*vep. e cit.*, f. 80-82.

Disa kapedanë kryengritës si i biri i Teodor Kollokotronit, Gjeneo, e të tjerë u zemëruan dhe deshën të largoheshin. Ata mendonin se evropianët i përçmonin, por largimi nuk ishte i hijshëm dhe vetëm «me këmbënguljen e Marko Boçarit... mezi qëndruan.»<sup>1</sup>

Në ndeshjen që u bë, Bakolla e braktisi fushën e betejës dhe i hapi rrugën ushtrisë osmane për të sulmuar lirisht prapa krahëve. Kur Marko Boçari vuri re këtë akt të shëmtuar, u bëri thirrje suliotëve që të luftonin me ngulm në mbrojtje të vullnetarëve, por u plagos dhe u hoq mënjanë prej shokëve. Një pjesë e mirë e vullnetarëve evropianë u vranë në betejë e sipër. Ata që mbetën të gjallë e akuzuan Bakollën për tradhti të ulët,<sup>2</sup> sepse u thoshte kryengritësve që do t'i gënjentë osmanët dhe këtyre se do t'i shtinte në dorë kryengritësit. Ai ishte një tregtar dhe tradhtar i lig.<sup>3</sup> Pas dështimit në Peta luftëtarët e mbetur u mblodhën në Langadhë, bashkë me ta edhe Mavrokordatoja. Aty erdhi edhe Gogo Bakolla, të cilin e akuzuan hapur si shkaktar të dështimit. Markoja tha vetëm kaq: «Po të jetë fajtor ka për ta gjetur».<sup>4</sup> Boçari dhe Mavrokordatoja vendosën të bëjnë mobilizimin e përgjithshëm të popullsisë.<sup>5</sup>

Ky dështim që një goditje e rëndë për të gjithë Greqinë Perëndimore. Suliotët e kishin shumë vështirë. Baza e kryengritësve në Epirin e Jugut ishte shuar, rruga për në Akarnani dhe Etoli për armikun që hapur, lidhjet e detit për suliotët ishin prerë njëherë e mirë. Përveç kësaj disfate të rëndë, në Spleanca u thyen dhe kryengritësit grekë që kishin ardhur në ndihmë të suliotëve, ndërsa të tjerët u tërhoqën në malet e tyre «duke lënë Sulin dhe Epirin në mëshirën e turqve».<sup>6</sup> Tradhtia në Peta

1) Dhimitër Karaxeni, *po aty*, f. 82.

2) G. G. Gervinus, *Résurrection et régénération de la Grèce*, Paris 1863, Tome premier, f. 426.

3) Maxime Raybaud, *vep. e cit.*, tome second, f. 210-211.

4) Jani Benekos, *vep. e cit.*, f. 32.

5) Apostolu E. Vakallopullu, *vep. e cit.*, f. 170.

6) Alexandre Soutzo, *vep. e cit.*, f. 210-211.

sipas pohimit të vetë Mavrokordatos «armikun e çoi deri te muret e Mesolongjit».<sup>1</sup>

Në këto kushte të rënda, më 28 korrik 1822, në Prevezë, suliotët u detyruan të nënshkruanin marrëveshjen me Omer Vrionin, në bazë të së cilës ata, të armatosur dhe me të gjitha plaçkat, do të linin Sulin dhe, nëpërmjet anijeve angleze të përqendruara në të Shtatë Ishujt, nën garancinë e qeverisë angleze, do të kalonin gjetikë. Shpenzimet e transportit do të paguheshin prej osmanëve. Dy Boçarët e mëdhenj, Markoja dhe Noti, në këtë luftë të suliotëve kundër osmanëve kishin luftuar me kaq trimëri saqë sarasqeri i inatosur kishte thirrur me zemërim: «Zoti ua hoqi trimërinë osmanëve për t'ua dhënë të krishterëve (kryengritësve — K. X.)».<sup>2</sup> Marko Boçari u tregua një nga heronjtë më të pastër të Revolucionit Grek.<sup>3</sup> Suliotët e larguar në Shtatë Ishujt pas pak ditësh u grumbulluan në Mesolongj: kishin dalë nga dera dhe kishin hyrë nga dritarja.

Revolucioni Grek që ndryshe quhet edhe Kryengritja Greke për pavarësi kishte karakter nacionalçlirimtar, sepse qëllimi i tij ishte çlirimi i Greqisë nga zgjedha osmane dhe shpallja e shtetit të pavarur kombëtar. Ai ishte përgatitur nga lufta e armatosur kleftike, e pandërprerë kurrë në Greqi, nga përhapja e iluminizmit dhe nga ndikimi i ideve të Revolucionit Francez<sup>4</sup>, nga kryengritja e Ali Pashë Tepelenës. Fara e lirisë që nuk kishte vdekur kurrë, ishte hedhur në një tokë pjellore e ajo do të lulëzonte. Në të do të merrnin pjesë në masë arbëreshët e

---

1) Leandër I. Vranusi, *vep. e cit.*, f. 67.

2) G. G. Gervinus, *vep. e cit.*, f. 14.

3) Gaston Caminade, *Les Chants des Grecs et le Philhélénisme de Wilhelm Müller*, Paris, 1913, f. 88.

4) M. N. A. Stratos, *En Mémoire des Philhellènes qui aidèrent à la cause hellénique (1821) et en mémoire de l'anniversaire de la mort de Lord Byron, à l'occasion du première centenaire de la révolution hellénique*, Athinen, 1922, f. 41.

Grequisë, por edhe shumë shqiptarë të Shqipërisë.<sup>1</sup> Në të do të futej me mish e me shpirt edhe Marko Boçari. Prandaj për Marko Boçarin bashkimi me Ali Pashën, me kundërshtarë të tjerë të Suliotëve dhe miqtë e tyre ishte kusht i domosdoshëm për fitoren kundër osmanëve. Urrej-tja ndaj shtypjes shumëshekullore osmane, pasioni për liri, solidariteti i fuqishëm me luftën e popujve të Ballkanit përfshirë edhe atë grek për pavarësi, e shtynin me vrull në këtë drejtim. Ky luftëtar i lirisë nuk mund të qëndronte i strukur, as të strehohej në Evropën reaktionare Perëndimore, as në Rusinë e Carit, që e kishte tradhtuar revolucionin dhe «Shoqërinë e Miqve» në principatat e Danubit; midis Markos dhe shtetit osman nuk mund të kishte asnjë pajtim. Ai hodhi sytë drejt njëres prej qendrave më të rëndësishme të Revolucionit Grek, për të cilin do të bëhej theror. Duke rënë për Greqinë, ai ishte i bindur se i shërbente edhe vendit të vet; ai kishte të drejtë të jetonte i lirë. Muza popullore shqiptare kështu ka kënduar:

.....

#### IV

*Në Mesolongjinë e shkretë  
Mbërthyer me kënetë,  
Seç filloi luftën me mbret,  
Po lufton Boçari vetë,  
Me shokët nja shtatëdhjetë,  
Të gjithë trima me fletë,  
Luftojnë me të vërtetë,  
Për liri e për të drejtë.<sup>1</sup>*

Në qoftë se deri tani Suli kishte qenë vija e parë e mbrojtjes dhe Markoja udhëheqësi i patrembur i tij, po

1) Christian Müller, *vep. e cit.*, f. 91.

2) Al. Mamopulu, *I. Ipiros*, Athina, 1961, vëll. I, f. 112.

kështu do të ndodhte në vijën e dytë, në Mesolongj. Edhe këtu ai do të ishte në krye, i veshur me të gjitha vetitë morale dhe i zhveshur nga çdo frikë. Revolucioni Grek kërkonte guxim dhe sakrifica. Këto gjendeshin te Marko Boçari, i cili u bë një nga heronjtë më fisnikë në luftën për pavarësinë e Greqisë.<sup>1</sup> Markoja arriti në Mesolongj me kapedanë të tjerë, më 24 mars 1822. Disa kapedanë si Thanas Drako dhe Llambro Zarba i propozuan të ktheheshin bashkarisht në Suli për të vazhduar luftën kundër Hurshid Pashës, por ai u përgjigj: «Shkoni vetë se unë do ta ndihmoj më mirë Sulin këtu».<sup>2</sup> Dhe kishte të drejtë. Revolucioni grek, në rast fitoreje, do të shërbente si pikë nisjeje për çlirimin e Sulit, të Shqipërisë e të tërë Ballkanit. Ai ishte një luftëtar shqiptar e ndërballkanik.

---

1) K. Paparigopullu, *vep. e cit.*, f. 621.

2) Niku Zhagu, *Marko Boçari*, f. 137.



## MESOLONGJI FITORJA

Mesolongji, kryevendi i krahinave të Etolisë dhe të Akarnanisë në Greqinë Perëndimore, gjatë tërë historisë mesjetare kishte qenë pushtuar herë prej Venedikut, herë prej osmanëve. Gjatë viteve 1804-1820, ai ishte nën pushtetin e Ali pashë Tepelenës. Popullsia merrej kryesisht me peshkim dhe me tregti. Në gjysmën e muajit maj të vitit 1821, qyteti u bashkua me revolucionin dhe u bë një nga qendrat më të fuqishme të tij. Rrethimi i qytetit zgjati shumë dhe rënia e tij në vitin 1826 në duart e ushtrisë egjiptiane, do të shkaktonte keqardhje të madhe në tërë opinionin përparimtar ndërkombëtar.

Që në fillim, Marko Boçari e kishte parashikuar rrethimin e Mesolongjit. Për t'i shpëtuar këtij rreziku, nuk mjaftonin forcat ushtarake të qytetit. Ai i bëri thirrje parisë së ishullit Hidra, të banuar krejtësisht nga arbëreshët. Në një letër, në korrik të vitit 1822, ai i shkruante: «Para pak ditëve ju shkruajta me bashkëpunëtorin tim Kristo Fotomarën dhe ju tregova rrezikun që kërcënonte Sulin; shpresat tona mbështeten tek anijet tuaja. Tani është në rrezik e tërë Rumelia dhe Moreja. Shpresa qëndron te fisnikëria juaj. O të shpëtoni Greqinë, o ta humbisni. Mos pranoni që të bëni sehir për punë asprash, por të dërgoni anijet tuaja, të vijnë dhe të bllokojnë ushtrinë e armikut... ta mposhtin atë dhe në këtë mënyrë emrat tuaj do të bëhen të pavdekshëm dhe mundimet tuaja nuk do të shkojnë kot, sepse vendi do të

çlirohet. Në këtë rast të tregoni besnikërinë dhe trimërinë tuaj si gjer tani. Po të mos vini sa më parë, gjithçka që kemi bërë deri tani do të shkojë kot.»<sup>1</sup> Flota me furnizimet mbërriti pikërisht kur duhej. Kjo, midis të tjerash, ndodhi edhe për respektin që luftëtarët e atyre ishujve kishin për heroin suliot. Në qershor 1822 Marko Boçari për nevojat e furnizimit të Mesolongjit me luftëtarë suliotë nga Korfuzi, bleu vetë një anije, të cilën e vuri në dispozicion të revolucionit.<sup>2</sup>

Hidra ishte e banuar prej arbëreshëve të vendosur aty që prej vitit 1580. Ata kishin ardhur për t'i shpëtuar sundimit osman nga krahinat e sotme të Greqisë: Atika, Peloponezi, Suli, Arta, por edhe nga viset e Shqipërisë, si: Himara, Vlora. Kështu dëshmojnë studiues të ndryshëm si hidrioti Kriëziu, anglezi Uadington, francezi Rejbo, italianii Barufi e mjaft të tjerë.<sup>3</sup> Banorët e saj, të gjithë të krishterë, janë njerëzit më të guximshëm të Greqisë, shkruan njëri syresh.<sup>4</sup>

Rejbo thotë se gjatë luftës për pavarësinë e Greqisë banorët e Hidrës u bënë krenaria dhe mbështetja e saj. Si marinarë-luftëtarë të paepur, me flotën e tyre, banorët e Hidrës i dhanë një ndihmesë të jashtëzakonshme Revolucionit Grek (1821-1829). Hidra sipas Zhurdenit (Jourdain), ky ishull që mezi duket në hartë, zuri një faqe të ndritur në histori.<sup>5</sup> Nga admiralët e tij sulltani kishte kërkuar «nga Hidra shkrumb, të më sillni vetëm hi»,<sup>6</sup> por më kot. Ishulli qëndroi i patundur mbi det duke

1) Jani Benekos, *vep. e cit.*, f. 391.

2) Dh. A. Ikonomu, *vep. e cit.*, f. 114.

3) Maxime Rayband, *vep. e cit.*, tome second, f. 48; G. F. Baruffi, *Viaggio in Oriente*, Milano MDXXXVLVII, f. 376; G. D. Griésis, *Histoire de l'île de Hydra jusqu'à la Révolution de 1821* Marseille, 1888, f. VII-VIII, *vep. e cit.*, f. 13.

4) George Wedington, *A visit in Greece at 1823 and 1824*, London MDCCCXXV, f. 104.

5) Jourdain, *Mémoires historiques sur les événements de la Grèce*, tome I, Paris, 1828, f. 138-139.

6) Pierre Lebrun, *Le voyage de Grèce*, Paris 1828, f. VIII.

valëvitur flamurin e lirisë. Marko Boçari dinte se ç'kërkonte kur u drejtohej për ndihmë luftëtarëve të Hidrës.

Më 25 tetor 1822 dy komandantë të ushtrisë osmane, Omer Vrioni dhe Qytahiu, me forcat e tyre ushtarake nga Peta mbërritën në muret e Mesolongjit me një ushtri prej 20 000 vetash, të pajisur me artileri. Ajo rrethoi qytetin. Gjatë rrugës, Marko Boçari e kishte goditur atë ushtri osmane ku kishte mundur, por forcat e tij të pakësuara pas betejës së Petës dhe marrëveshjes së Prevezës nuk kishin mundur ta ndalnin. Për mbrojtjen e Mesolongjit kishin ardhur dhe shumë shqiptarë të tjerë nga Shqipëria e Jugut. Banorët e tij, 5-6 mijë veta, ish-peshkatarë të varfër, u kthyen të tërë në luftëtarë.

Një pjesë e banorëve që nuk kishin qenë në gjendje të luftonin shkoi në Shtatë Ishujt. Mesolongji, qyteti më i fortifikuar i Etolisë, ishte çelësi për në Peloponez. Marko Boçari vendosi ta dërgonte familjen e tij, bashkëshorten dhe fëmijët, në Ankona të Italisë. Krisulla e luti më kot që ta lejonte që edhe ajo t'i ndante rreziqet me të. «Që kur, e pyeti ajo, gratë sulioje braktiskan burrat e tyre në prag të betejës? Nuk ditkan ato të zbrazin pushkën apo të lidhin plagët e tyre?».<sup>1</sup> Por Markoja, u tregua i palëkundshëm dhe iu përgjigj «se gjatë kohës së paqes do të jemi bashkë, por, në këtë kohë lufte dua të jem vetëm».<sup>2</sup> U ndanë me lot në sy kur ajo hipi në anije. «Nga trishtimi dhe mallëngjimi, shkruan Jemenizi, këto lamtumira të këmbyera para armikut, në vigjiljen e luftës dhe me parandjenjat më vdekjeprurëse për ta a nuk na sjellin ndër mend lamtumirën e dëgjuar dhe prekëse të Hektorit me Andromakën?»<sup>3</sup> Më 3 janar 1823, nga Mesolongji Markoja i dërgoi një letër Kollokotronit, ku duket shqetësimi i tij i madh për një mbledhje që do të kishte për qëllim forcimin e administratës shtetërore, në të cilën duhej të merrnin pjesë të gjithë përfaqësuesit e krahi-

1) Eugène Yeméniz, *La Grèce moderne, Héros et poètes*, Paris, 1862, f. 36.

2) *Po aty*, f. 96.

3) *Po aty*.

nave: «Ju njoftoj se më 25 të muajit të kaluar, armiku bëri një sulm kundër nesh me dëme shumë të rënda për të. Pas tri ditësh, dolën disa kryengritës për të provuar forcën e tyre dhe iu afruan transheve. Forcat kundërshtare nuk u përgjigjën fare, kaq shumë u kishte hyrë frika. Ato braktisën të gjitha çadrat, topat, xhephanet dhe tërë pajisjet, çka është shumë e çuditshme dhe e pashembullt... Për Asamblenë që më thoni, është e parakohshme, sepse ne nuk jemi në gjendje tani për tani të dërgojmë përfaqësues, mbasi armiku akoma nuk është larguar nga vendet tona dhe, duam s'duam detyrohem të lëvizim bashkë me shkëlqesinë e tij kryetarin (Mavrokordatoni — K. X.) për të rrethuar armiqtë në rast se do të qëndrojnë nëpër krahinat; po të ikin, kemi për të organizuar mbledhje të parisë dhe të komandantëve të Greqisë Perëndimore për të vendosur rregullin, për të fuqizuar së pari administratën dhe pastaj të bëhen zgjedhjet e njerëzve të nderuar e fisnikë, që t'i dërgojmë aty». Markoja vazhdoi: «që me sa të kesh mundësi ta pengosh atë asamble gjersa të vijë tanët dhe puna të bëhet si duhet, të emërohet një administratë (qeveri — K. X.) e rregullt, sipas ligjeve, e cila të fuqizohet dhe të veprojë po sipas ligjeve dhe të mos kërcejë secili siç do vetë, si bëhet tani. Kemi shpresë që së shpejti të dalë edhe vëllai ynë gjeneral Odhisea (Andruco — K. X.), për të biseduar edhe me të, dhe kështu t'i vëmë të gjitha në rrugë të mbarë». <sup>1</sup> Markoja donte të shmangte patjetër lindjen e pakënaqësive dhe për pasojë pri-shjen e unitetit, por njëkohësisht nuk dëshironte të le-jonte asnjë arbitraritet në drejtimin e vendit.

Ndërkaq, Markoja ndiqte me kujdes edhe punët e familjes së vet në Ankona, e cila nuk po bindej që të qëndronte gjatë larg tij. Duke parë se njerëzit e familjes së tij ishin të shqetësuar për të dhe për të vëllanë Kostandinin, Markoja i shkroi hallës së vet nga Mesolongji më 14 nëntor 1822: «Mora letrën tënde dhe u gëzova. Ja pra, po i shkruaj edhe Hirësisë së Tij, pesh-

1) Dh. A. Ikonomu, *vep. e cit. f. 134.*

kopit (Ignatit) dhe zotit Jani Mellait që të mos ju ndërpriten shpenzimet dhe unë jam gati t'u përgjigjem». Pasi i vë në dukje se nuk e konsideron të nevojshme t'i shkruajë për ngjarjet e Luftës që po zhvillohej, sepse ato do t'i merrnin vesh nga të tjerët, ai thekson: «Po ju shkruaj që të mos kenë asnjë dyshim se Kosta me suliotët e tjerë, pas dorëzimit të Sulit, kaloi në Qefallonin dhe është atje. Madje i shkrova që të bëjë çdo përpjekje që të kalojë me gjithë familjen e kapedan Lolos (kunatit të vet — K. X.) dhe të Thanasit (Tushî Boçarit, kushëririt të vet — K. X.) sepse këtu në stere nuk i lënë të zbresin. Të kam shkruar edhe herë të tjera, por si duket letrat e mia nuk i kenë marrë, por edhe unë tuajta i marr pas 3-4 muajsh. Fëmijët të mos shkëputen nga shkolla. Për mua mos kenë asnjë shqetësim».<sup>1</sup>

Në këtë letër shprehet interesimi i një revolucionari të vërtetë dhe të dhëmbshur, që nuk e ndan aspak dashurinë për njerëzimin nga ajo për njerëzit e tij të afërm. Si edhe hallës së vet pak më parë, ai i shkruante bashkëshortes: «Fëmijët të mos shkëputen nga shkolla».<sup>2</sup> Ai dëshironte t'i bënte ata njerëz të kulturuar jo vetëm për të ardhmen e tyre, por me pikësynimin që ata të ishin të aftë për ta cuar përpara shoqërinë, në luftë për dritën kundër errësirës. Dhe këtë ai e kërkonte jo vetëm për fëmijët e tij, por edhe për të gjithë të tjerët. Nda, një kërkesë që i bënte presidentit të Greqisë më vonë, për t'i shtuar mjetet financiare në dobi të arsimit, vëllai i këtij të fundit i përgjigjej: «Si i kërkonti ju të tilla gjëra vëllait tim? Pikërisht tani që grekët janë të varfër dhe të paditur, ai po has kaq vështirësi për t'i qeverisur. Ç'do të ndodhë kur ata të bëhen të pasur e të arsimuar?»<sup>3</sup>

Nga fronti i luftës ai e këshillonte të birin e mitur, Dhimitrin, në Ankonë, që pas shqipes të përpiqej të ki-

1) Niku Zhagu. *Marko Boçari*, f. 160.

2) Flefterias Nikollaidhu. *vep. e cit.*, f. 377.

3) Frederic Thiersch. *De l'État actuel de la Grèce et des moyens d'arriver à sa restauration*. Premier volume, Leipzig, 1833, f. 24.

shte arritje më të mira në gramatikë edhe në elementët e gjuhës greke e italiane, njëkohësisht e porosishte që në asnjë mënyrë të mos harronte traditat familjare. «Dëshiroj të marrësh arsim, por veç kësaj dëshiroj të edukohesh me tradita suliotë, të mbetesh kurdoherë suliot, siç ka mbetur babai yt».<sup>1</sup>

Pas rënies së Tripolicas, Marko Boçari i kishte mbledhur kapedanët në Mesolongj e u kishte shpjeguar rëndësinë e madhe të luftës për të mbrojtur Peloponezin. Ai i këshilloi ata që të mos interesoheshin vetëm për të mbledhur të holla, por të qëndronin fort të bashkuar, të tregoheshin të guximshëm dhe trima sepse vetëm kështu armiku do të shpartallohej. Të gjithë kishin mbetur gojëhapur kur kishin parë se ky suliot, që deri tani njihej vetëm për trim, ishte njëkohësisht dhe shumë i zgjuar, largpamës, i thjeshtë, me aftësi të rralla për t'i tërhequr njerëzit drejt një qëllimi të madh.<sup>2</sup> Aleksandër Mavrokordatoja që ishte në krye të mbrojtësve të Mesolongjit e kishte njohur mirë Marko Boçarin. Në një lehtë që ai i dërgonte primatit të Valtosit, Anagnosti Karajanit, më 13 shtator 1822, midis të tjerash, shkruante se ishte të paktën i kënaqur, që kishte pranë «patriotin e mirë, zotin Marko», i cili ishte shumë i vlefshëm dhe i domosdoshëm.<sup>3</sup>

Dy ditë rresht komandantët osmanë e bombarduan rëndë qytetin, por pa dobi. Të rrethuarit nuk po dorëzoheshin. Një pjesë e flotës osmane në Patra, e komanduar prej Isuf Pashës, merrte pjesë në këtë rrethim nga toka dhe nga deti.

Disa persona kryesorë të qytetit, të frikësuar nga bombardimet, deshën t'ia dorëzonin atë armikut. Merita e madhe e Marko Boçarit është se ai jo vetëm e kundërshtoi këtë, por edhe e kuptoi thellë rëndësinë e mbrojtjes së tij. Në qoftë se qyteti do të binte, atëherë armiku do të përparonte lirisht drejt Peloponezit, që ishte dobësuar nga

1) Elefterias Nikollaidhu, *vep. e cit.*, f. 381.

2) Jani Benekos, *vep. e cit.*, f. 360.

3) Apostolu E. Vakallopullu, *vep. e cit.*, f. 194.

fushatat e shumta kundër osmanëve, dhe gjithçka e arri-  
tur do të shkonte dëm. Markoja vendosi të qëndronte aty.  
Ai punoi me zell për ndërtimin e mureve dhe të transhe-  
ve, i vendosur që të mbronte me çdo kusht qytetin. Krye-  
ngritësit e rrethuar shpresonin çdo ditë që flota e krye-  
ngritësve grekë të arrinte në ndihmë të tyre, të thyente  
anijet osmane, të furnizonte qytetin me ushqime, me njerëz  
e me armë dhe pastaj, nëpërmjet veprimit të kombinuar të  
një kundërsulmi nga qyteti dhe deti, të shpartallonin armi-  
kun. Ndërkohë, qeveria greke revolucionare, me dekretin  
e 12 tetorit 1822, e shpalli Marko Boçarin komandant të  
forcave të Greqisë Perëndimore. «Komisioni e konsideron  
të domosdoshëm të shpallë komandant në të gjithë Greqinë  
Perëndimore një tjetër në vend të të mallkuarit Jorgji  
Varnaqioti (që ishte bashkuar me osmanët — K. X.) dhe  
duke qenë i të njëjtit mendim me qeverinë, miraton që pa-  
triotit të mirë e të denjë suliot Marko Boçarit t'i jepet  
komanda, vendi i së cilës është vakant».<sup>1</sup>

Nëpërmjet Ago Vasjarit osmanët u propozuan krye-  
ngritësve që të dorëzoheshin. Më 15 nëntor 1822 u bë ta-  
kimi midis Marko Boçarit dhe të deleguarit osman, për të  
biseduar lidhur me «dorëzimin» e të rrethuarve dhe kush-  
tet e tij. Heroi suliot dëshironte t'i zgjaste punët. Ai  
s'kishte ndër mend që ta dorëzonte qytetin.

Ago Myhyrdari i premtoi Markos se po të dorëzohej  
do ta shpallnin kapedan të të gjithë Rumelisë, por ai iu  
përgjigj se sapo e kishin bërë gjeneral ata për lirinë e të  
cilëve ai luftonte. Nga ana tjetër, vetë ai, Ago Myhyrdari,  
nuk ishte i siguar as për postin që kishte, as për vetë  
jetën. Markoja i vuri në dukje se ishte betuar të luftonte  
për lirinë e Greqisë dhe se asnjë marrëveshje nuk do të  
kishte midis tyre përveç pushkës.<sup>1</sup>

Historiani grek Trikupis vë në dukje se Ago Vasjari,  
që ishte në ushtrinë e Omer Vrionit, u nxit nga ky i  
fundit për të biseduar me të rrethuarit për dorëzimin

1) Dhionis Kokinu, *I Eleniki Epanastasi*, vëll. 6, Athinë; 1931,  
f. 310.

2) Niku Zhagu, *Markos Boçaris*, f. 157.

e Mesolongjit. Vasjari, që ishte njohur me Markon që kur gjendeshin në oborrin e Aliut, e ftoi për takim. Me miratimin e parisë së Mesolongjit, Markoja u takua me të dhe Vasjari e këshilloi si mik që garnizoni të dorëzohej dhe si shpërblim osmanët do të shpallnin një falje të përgjithshme, duke lejuar parinë dhe vetë Markon të dilnin nga qyteti të paprekur. Por të rrethuarit i zgjatën me qëllim bisedimet, sepse pritnin ndihma nga toka dhe nga deti. Isuf Pasha i Patrës i kërcënonte të rrethuarit që të dorëzoheshin sa më parë; por Omer Vrioni, nëpërmjet Vasjarit, i lajmëroi të kenë besim vetëm tek ai. Prandaj u vendos një pushim luftimesh prej 8 ditësh dhe pas kësaj të dilnin nga Mesolongji rreth 300 familje të parisë që do të shkonin në Peloponez. Por më 8 nëntor, u duk flota e Hidrës si dhe vullnetarët nga Peloponezi. Atëherë të rrethuarit iu përgjigjën prerë Vrionit nëpërmjet Vasjarit: «Po e deshët qytetin, ejani ta merrni».<sup>1</sup>

Marko Boçari i kishte shkruar një letër të tillë kapedan Nikocarës: «Vëlla, ngjarjet e këtushme i keni marrë vesh. Megjithatë, po ju informoj edhe unë se kemi 25 ditë që jemi mbyllur këtu dhe luftojmë pandërprerë me topa, me kobure dhe me pushkë. E keqja erdhi nga Varnakioti, Janaq Rango dhe nga kapedan Gogo, të cilët u tërhoqën pa shtënë asnjë pushkë. Por kam shpresë se do t'ua marrim hakën si turqve ashtu edhe filoturqve. Anijet e Hidrës arritën dhe popullsia mori kurajë. . . Kemi shpresë se do ta mposhtim armikun. . . Detyrojeni Morenë që t'ju dërgojë ushtrinë për ta dërrmuar njëherë e mirë atë dhe të mos flenë se armiku na ka ardhur shumë pranë. Po të shkatërrohet Rumelia, me siguri është e humbur dhe Moreja. Po të më kishte dëgjuar paria e Moresë kur isha atje, nuk do të gjendeshim në një rrezik të tillë.»<sup>2</sup>

Nga kjo letër del se Markoja i kishte dënuar rreptë armatolët kapedanë, që e kishin tradhtuar kryengritjen greke. Këtë të fundit ai e shikonte si një tërësi dhe kundërshtari duhej sulmuar atje ku çështja ishte më në rrezik, sepse fitoret e pjesshme duhej t'i nënshtroheshin

1) Cituar nga Pysros, vëll. VI, f. 47.

2) J. Benekos, *vep. e cit.*, f. 389-390.



asaj së përgjithshmes, vetë revolucionit, përndryshe pritej vetëm dështimi. Ai nuk shqetësohej aspak për armatolitë, siç bënin armatolët e sipërpërmendur. Kur arriti ndihma, më 10 nëntor 1822, Markoja doli dhe u tha osmanëve: «Unë desha që t'ju shërbeja për t'u dorëzuar, por tani nuk mundem sepse erdhi paria e Moresë dhe thuhet se kanë sjellë barut dhe plumba për ju. Pra, veproni si të dëshironi».<sup>1</sup> Ndërsa në një këngë popullore thuhet:

*Markoja u përgjigj me shpatë në dorë:*

*«Te porta e kështjellës i kam varur çelësat,  
Dhe po të jesh trim dhe i mirë eja merri».*<sup>2</sup>

Para se të vinte ndihma, luftëtarët e Mesolongjit ishin vetëm 300 veta, ndërsa osmanët 10 000. Kështu që vetëm marina e Hidrës dhe ndihma e Pelopenezit me këmbësorë luftëtarë mund ta shpëtonte qytetin. Nga ana tjetër, në ushtrinë e rrethuesve, përveç turqve, kishte dhe shqiptarë muhamedanë, të cilët nuk kishin aspak dëshirë të luftonin për të huajin. Omer Vrioni i kishte kërkuar Tahir Abazit që të mblidhte ushtarë të tjerë në Shqipëri dhe t'i sillte sa më shpejt në Mesolongj kurse ai ishte përgjigjur me këto fjalë: «I bëra të gjitha përpjekjet për të mobilizuar 1000 shqiptarë, por nuk ia dola. Ata pranojnë më mirë të vdesin urie sesa të kenë të bëjnë me Marko Boçarin».<sup>3</sup> Muza popullore këtë mungesë dëshire të shqiptarëve myslimanë për të luftuar bashkë me ushtrinë osmane për shtypjen e Revolucionit Grek, e këndon kështu:

*Pa dëgjo or mirjalla,  
Po ne këtu pse na mba?  
S'jemi desh për pastërma,  
Jemi djem, kemi nana,  
Jemi burra me gra.*<sup>4</sup>

1) Apostolu E. Vakadhoppullu, *vep. e cit.*, f. 314.

2) Jani Benekos, *vep. e cit.*, f. 399.

3) Alexandre Soutzo, *vep. e cit.*, f. 258-259.

4) Fatos Mero Rrapaj, *Këngë popullore nga Çamëria, Tiranë, 1983, f. 457.*

Lufta e Portës së Lartë kundër Kryengritjes Greke ishte krejt e huaj për masat shqiptare muhamedane, ndërsa për disa feudalë ishte krejt e ndryshme.

Omer Vrioni u kthye në kampin e rrethuesve. Ago Vasjari e bindi atë që t'i priste. Midis Vrionit dhe pashait turk Reshidit kishte grindje të mëdha, të dy e urrenin njëri-tjetrin dhe secili përpiqej që fitoren e Mesolongjit ta kornte për vete, që të shpërblehej prej qeverisë osmane. Përveç kësaj ngjau edhe grindje midis Omer Vrionit dhe komandantit të flotës osmane, Isuf Pashës, i cili për të përvetësuar nderimet e fitores, e kishte lajmëruar garnizonin e Mesolongjit që ky t'i dorëzohej vetëm atij dhe askujt tjetër.<sup>1</sup> Që të tre pashallarët u bënë në rrethuarve propozime të ndryshme, që të tre ata, duke kundërshtuar njëri-tjetrin, humbisnin kohën në grindje, gjëra këto që Boçari dhe Mavrokordatoja i shfrytëzuan për të zgjatur bisedimet dhe për t'u përgatitur për mbrojtje. De la Zhonker me të drejtë vë në dukje se këto mosmarrëveshje midis kryetarëve osmanë i paralizuan veprimet e rrethimit.<sup>2</sup> Dora d'Istria e shpjegon kështu këtë çështje: «Në vitin 1822 Mesolongji u bllokua nga toka dhe nga deti, mbrojtësit e tij i gjetën mjetet për hir të energjisë së tyre... dhe të mosmarrëveshjeve që ekzistonin midis shqiptarëve dhe aziatikëve, ata i penguan turqit deri në mbërritjen e ushtarëve të Peloponezit, që nuk kursyen asgjë për t'i ndihmuar.»<sup>3</sup>

Kryengritësit e Peloponezit mundën të zbarkonin në Mesolongj, ndërsa 500 të tjerë, me urdhër të kapëdanit suliot, zunë vend jashtë tij, prapa radhëve osmane, të cilët u ndodhën të rrethuar nga të dyja anët, midis dy zjarresh. Energjia e të rrethuarve u dyfishua. Dhe tani ata mund t'i shpinin në kurth armiqtë e tyre.

Dita e 25 dhjetorit, sipas kalendarit të krishterë, ishte festa e krishtlindjeve, Marko Boçari dha urdhër që t'u

1) Alexandre Soutzo, *vep. e cit.*, f. 255.

2) Le V-te De la Jonquièrre, *vep. e cit.*, f. 447.

3) Dora d'Istria, *Excursions en Roumélie et en Morée*, Zurich, Paris, 1863, vol. 2; f. 278.

binin kabanave me qëllim që mbrojtësit të paraqiteshin para armikut sikur po festonin krishtlindjet. Armiqtë kujtuan se gjetën rastin e përshtatshëm për t'i sulmuar mbrojtësit ndaj filluan sulmin. Beteja që e rëndë, armiku pati 500 të vrarë dhe fitorja e kryengritësve që e plotë. Kjo i detyrohej kryesisht Marko Boçarit. Jani Gaziu ka shkruar: «Me zgjuarësinë e tij strategjike, ai e shpëtoi Mesolongjin».<sup>1</sup> Nën shembullin e Markos të rrethuarit luftuan me trimëri të rrallë. Më 13 janar 1823 osmanët u tërhoqën nga kampi i tyre, duke lënë në vend një material lufte të pasur. Garnizoni i Mesolongjit e ndoqi armikun dhe më 24 janar Omer Vrioni u gjend në brigjet e lumit Akelou, që ishte mbushur me ujë për shkak të shirave të shumtë. «Plumbat fishkëllonin në veshët e tij, valët e lumit ushtonin para tij. Ai mundi ta kalojë lumin duke lënë 1700 të mbytur e të vdekur, ndërsa ata që dolën përtej u sulmuan prej fshatarëve të Valtosit dhe të Kseromerosit dhe mezi e mbajtën frymën në Artë.<sup>2</sup> Omer Vrioni arriti në Prevezë me gjysmën e ushtrisë së tij të sakatuar<sup>3</sup>, ndërsa Qytahiu në Artë. Kjo mbrojtje e Mesolongjit e bëri Marko Boçarin të pavdekshëm.<sup>4</sup> Ajo shtoi besimin në radhët e vullnetarëve të huaj dhe në qoftë se në betejën e Petës të gjitha fatkeqësitë kishin rënë mbi kryengritësit, në mbrojtjen dhe luftën e Mesolongjit ato ranë mbi osmanët. Duhet theksuar se kontradiktat midis komandantëve osmanë luajtën një rol të tërthortë në atë fitore, por ai vendimtari u takonte luftëtarëve të udhëhequr nga Marko Boçari.

Qe truri dhe zemra e Markos që ndihmuan në arritjen e asaj fitoreje. Jemenizi shkruan: «Zgjuarsia e Markos dhe vendimi i prerë i tij kishin shpëtuar Mesolongjin dhe

---

1) Jani Gazis, *Biografia e Marko Boçarit*, Egjinë, 1828, f. 11.

2) Dora d'Istria, *vep. e cit.*, f. 278.

3) Auguste Fabre, *Histoire du siège de Messolonghi*, Paris, 1827, f. 87.

4) Dora d'Istria, *Les femmes en Orient*, Zurich, 1859, f. 343.

bashkë me të Greqinë». <sup>1</sup> Kjo ishte arsyeja që parlamenti grek në fund të janarit të vitit 1823 dhe pastaj qeveria e shpalli Marko Boçarin të denjë për mirënjohjen e vendit dhe për gjithçka që e kishte bërë «të dobishëm e të shkëlqyer». <sup>2</sup>

---

1) Eugène Yemèniz, *La Grèce moderne*, vep. e cit., f. 101.

2) Arkios tu Mavrokordatu, vëll. 5, pjesa 3-të, f. 90-92, cituar prej Apostolu E. Vakodhopullu, vep. e cit., f. 338.

## MESOLONGJI. FITORJA DHE FLIJIMI

Pas katastrofës së ushtrisë osmane në Mesolongj, më 1823 sulltani dha urdhër që të niseshin dy ushtri për në Greqi: njëra nga Tesalia dhe tjetra nga Shqipëria e Veriut, të cilat do të bashkoheshin në Lepant, do të kalonin në Patra dhe që andej do të ndërmerinin sulmin kundër Peloponezitet. Qëllimi i tij ishte shtypja e Revolucionit Grek. Në prill të vitit 1823, ekspedita e parë nën komandën e Isuf Pashës arriti në Greqinë Lindore me forca të mëdha këmbësorie dhe kalaverie. Ajo hyri në Fokidë dhe në Beoti. Pas disa luftimesh në Beoti, në Atikë, në Evia, kryengritësit grekë e detyruan të kthehet në Larisa dhe të mos lëvizë më. Isuf Pasha e kishte ndarë ushtrinë në dy kolona, por kryengritësit kishin zënë pritë në grykat e maleve dhe me goditje të njëpasnjëshme e të shpejta, e rraskapitën ushtrinë e tij. Midis kapedanëve që udhëhiqnin ushtrinë kryengritëse ishte edhe arbëreshi Odhise Andruco. Nga ana tjetër, flota osmane që kishte arritur të furnizonte Korintin me armë dhe njerëz, nuk mundi të bëjë asgjë dhe qyteti ra në duart e kryengritësve.

Shumë më e rëndësishme ishte ekspedita osmane që vinte nga Shqipëria Veriore, e drejtuar për në Greqinë Perëndimore dhe e komanduar prej Mustafa pashë Bushatliut. Ajo përbëhej prej mbi 8000 ushtarësh. Mustafa Pasha u bashkua me Omer Vrionin, i cili kishte mundur të mbledhte 4000 ushtarë të tjerë.<sup>1</sup>

1) Kostandin Pagarigopullu, *vep. e cit.*, f. 106.

Markoja u shqetësua shumë. Ai e pa të domosdoshmë të njoftonte qeverinë greke për gjendjen e krijuar në Mesolongj. Në një letër dërguar, më 2 gusht 1823, njërit prej anëtarëve të saj, Andrea Zaimit, midis të tjerash, ai i shkruante: «Më duket e tepërt që t'ju shkruaj tani për gjendjen e Greqisë Perëndimore meqë fisnikëria juaj e pa me sytë e vet dhe e njeh. Greqia Perëndimore, e cila qysh në fillim e vazhdimisht ka qenë në rreziqe, si nga njerëzit e vendit ashtu edhe nga të tjerët, katandisi e shkretuar edhe për shkak të mungesës së çdo materiali të domosdoshëm ushtarak për t'i bërë ballë rrezikut që po e kërcënon nga armiqtë. Këta, duke vënë re dobësitë tona, u grumbulluan tani për të na dhënë përgjigjen vdekjeprurëse. Isuf Pasha erdhi në Kseromeri me 12 mijë, Omer Pasha me 5 mijë mbërriti në Artë dhe po bëhet gati për t'u hedhur në Valtos bashkë me Isuf Pashën. Mustafa pashë Shkodrani arriti në Agrafa me 18 mijë veta dhe të tjerë po vijnë nga krahina të ndryshme. Që të mos zgjatem me fjalë, Greqia Perëndimore po mbushet me rreziqe imediate dhe kam frikë, po, kam frikë, se mos mbytet. E gjykoj si detyrën time patriotike zoti fisnik, që t'ju shkruaj dhe ju t'i tregoni Administratës (Qeverisë — K. X.) së lartë rrezikun e pashmangshëm. Në rast se anijet greke nuk do të vijnë të çajnë bllokadën nga ana e detit, të shumtën brenda 15 ose 20 ditëve, atëherë do të arrijë forca tokësore armike e do të na bllokojnë për zhdukje dhe për vdekje. Mesolongji ka aq forca sa të qëndrojë për disa ditë dhe jo për disa muaj të tërë... Ti o vëlla, si patriot dhe si anëtar i Trupës së nderuar ekzekutive, mos mungo të vësh në dijeni ku duhet për sa të shkruaj, sepse mendohu mirë sa gjë e hidhur do të jetë për Peloponezin kur të shkatërrohen nga armiku parambrojtësit e tij. Shpresoj se tani para rrezikut të fundit Peloponezi do të zgjohet nga gjumi i rëndë i indiferentizmit dhe do të ndihmojë me forca detare e tokësore e me materialin luftarak që duhet e që neve të bllokuarve na mungon krejt. Ardhja e prefektit (e Kostandin Metaksait — K. X.) këtu nuk mund të shërbejë për rregullimin

e gjendjes sonë, megjithëse arriti dhe solli me vete shumë pak peksimete, që nuk i mjaftojnë as për vete dhe çuditë se si ai, kur u nis, nuk u furnizua si duhet, sepse kështu siç u nis, ardhja e tij s'ka asnjë rëndësi.

Shumë i nderuari fisnik, mos mendo se këtu ke ushqime më shumë se për dhjetë ditë, sepse frymët që janë bllokuar arrijnë afro njëzet mijë shpirt dhe duhet të keni parasysh se brenda një kohe të shkurtër, mund të zhduket gjithçka në rast se ju nuk do të dërgoni me kohë forcën e domosdoshme. Greqia Perëndimore, duke shpëtuar nga shpata hakmarrëse e armikut, po bie nën shpatën e urisë, dhe ka për t'u asgjësuar po të mos ndihmohet me kohë».<sup>1</sup>

Qeveria që merrej me grindje s'ishte në gjendje të merrte masa të shpejta për mbrojtjen e Mesolongjit. Markoja duhej të mendonte vetë. Ndihmën ai do ta kërkonte dhe do ta gjente te kurajo e jashtëzakonshme e tij dhe te burrëria e suliotëve të tij.

Kur në fillim të gushtit 1823, duke kaluar nga Agrafa, pashai i Shkodrës arriti dhe pushtoi Karpenisin, rreziku për Mesolongjin u bë i madh. Këtu ai do të ndeshë me Marko Boçarin, për të cilin, duke pasur parasysh veprimtarinë e tij në Plaka, Peta dhe në rrethimin e parë të Mesolongjit, historiani grek Paparigopulli vëren: «Si më 1822 edhe tani në Greqinë Perëndimore protagonistin kryesor ishte sulioti Marko Boçari... Për devotshmërinë dhe trimërinë personale askush nuk krahasoj me të. Mirësia ishte e pikturuar në fytyrën e tij dhe dashamirësia dëshmohej në fjalët e tij. Ishte qenie me shpirt luani. Shqiptarët (muhamedanë — K. X.), thoshin se po të ishte mysliman, do të besonin se profeti Ali ishte kthyer mbi tokë».<sup>2</sup> Ndërsa historiani gjerman Gervinus, po në prag të ndeshjes së Karpenisit, shkruante për suliotin e madh: «ky djalë i ri i shkurtër, i zbehtë nga fytyra dhe i përkorur në fjalë, ishte i vetmi nga kryengritësit që u shpreh me forcë për unitetin në radhët e revolucionit.» Gervinusi e

1) Sh. A. İkonomu, *vepër e cit.*, f. 185-187.

2) Kostandin Paparigopullos, *vep. e cit.*, f. 107.

karakterizon Marko Boçarin të pajisur me të gjitha vetitë dhe epërsitë që mbizotëronin mbi kapedanët e tjerë. «Njeri modest, shumë i dashur, besnik i fjalës së vet, i drejtë dhe i matur fort në sjelljet e tij, ai kapërcente të gjithë pjesëtarët e tjerë të revolucionit për shkak të devotshmërisë së tij pa interes për çështjen që ai kishte përqafuar.»<sup>1</sup> Njeri i vendosur dhe i zjarrtë në luftë, ai dallohej nga kapedanët më të mëdhenj të luftës për pavarësinë e Greqisë edhe për shkak të dokeve të tij ushtarake tepër të thjeshta, por edhe për shkak të trimërisë së tij personale. Gervinusi vazhdon: «Ai adhurohej prej familjes së vet dhe thellësisht nderohej prej suliotëve të tij, zakonet e ashpra të cilëve kishin qenë mbushur me krenari luftarake në një shkallë të lartë për shkak të fatkeqësive të vendit të tyre dhe nga vetëdija e veprave të tyre të lavdishme».<sup>2</sup> Ishte ky nderim i madh i patriotëve të tij që shërbeu si bazë themelore për fitoren dhe njëkohësisht për vdekjen e tij të lavdishme në Karpenisi.

Që më 11 korrik 1823 Mustafa Pasha u kishte shkruar dy kapedanëve kryengritës, Sturnarës dhe Karaiskaqit, që brenda 15 ditëve të bashkoheshin me të.<sup>3</sup> Ai i siguronte se do t'ua falte mëkatet, madje do t'u jepte të gjitha të mirat. Marko Boçarin, simbolin e luftëtarit të paepur dhe të bashkimit brenda radhëve të revolucionit, ai e përjashtonte. Lëvdohej se po ta kapte të gjallë, do ta dërgonte rob në Stamboll «si plaçkën më të çmuar», si një revolucionar të rrezikshëm, mbrojtës të të përvuajturve. Lajmi i mbërritjes së ushtrisë osmane i shqetësoi kryengritësit. Por në radhët e qeverisë dhe të krerëve të luftës për pavarësi kishte grindje të rënda që mund të shpinin deri në një luftë civile, e cila do të ishte vetëm në të mirë të armikut.

Prefektit të Etolisë dhe Akarnanisë, Kostandin Metaksait, që erdhi në Mesolongj, në fillim gjendja iu duk pa

1) G. G. Gervinus, *vep. e cit.*, f. 589.

2) *Po aty*.

3) Apostolu E. Vakallopullu, *vep. e cit.*, vëll. VI, f. 557.



rrugëdalje, por pastaj e rimori veten dhe vendosi të mbetej aty dhe të merrte pjesë në organizimin e qëndresës. Ai i bëri thirrje pleqësisë së qytetit dhe parisë që t'ia shtonin ushqimin luftëtarëve. Veç kësaj mori masa edhe për vendosjen e qetësisë brenda Mesolongjit, mblozhi krerët ushtarakë dhe u foli për rrezikun e madh që kërcënonte revolucionin. Brenda radhëve të suliotëve, si domos te kapedanët e tyre, kishte pakënaqësi për shkak të shpalljes së Marko Boçarit gjeneral, gradë që një pjesë e mirë e tyre e dëshironin për vete. Duke kuptuar rëndësinë e momentit, Markoja, si njeri i urtë që ishte, e hodhi tej vendimin qeveritar që e shpallte atë gjeneral. Ai ishte i vetëdijshëm se fitorja e luftës për pavarësinë e Greqisë, mund të arrihej vetëm duke shtrënguar radhët. Prandaj më 2 shkurt 1823 ai u shkroi një letër kapedanëve të Greqisë Perëndimore.

«Vëllezër e miq të dashur, hiliarkë, trima dhe mbrojtës shumë fisnikë të Greqisë kontinentale Perëndimore. Kur qeshë i rrethuar në Mesolongj, mora nga Administrata qendrore shkresën e emërimit tim si gjeneral i Greqisë kontinentale Perëndimore. Atëherë asnjë nga ju trimat nuk ndodhej atje dhe unë vazhdova detyrën gjersa të vinit ju. Mirëpo nga ajo kohë fillova të vë re një lloj ftohtësie nga ana e disave dhe këtë tani po e kuptoj edhe më shumë. Kisha dëshirë ta lija në heshtje, por armiku ndonëse u mund, nuk është zhdukur ende dhe që të zhduket duhet bashkimi dhe gatishmëria e të gjithëve, gjëra këto që dëmtohen shumë nga ftohtësia dhe mosmarrëveshja. Unë mendoj se gjer tani nuk e kam dëmtuar vendin dhe nuk i lejoj vetes që këtej e tutje të bëhem shkak për ndonjë dëmtim sado të vogël të tij. Prandaj, nëse emërimi im si gjeneral është ai që hidhëron, jam gati të heq dorë nga drejtimi dhe t'ju lë të drejtoni si të dëshironi për të qenë të bashkuar. Nga ana tjetër, nuk dëshiroj që ky akt të duket si shkelje e urdhrave të Administratës Epreore, ose se u bë nga frika e armikut apo nga paaftësia ime, apo për ndonjë tjetër arsye. Prandaj ju lutem të më pa-

raqitni me shkrim nëse emërimi im gjeneral është ai që ju mërzit dhe nëse do të kënaqeni po të jap dorëheqjen.

Vëllai juaj

Marko Boçari». <sup>1</sup>

Kjo letër është shkruar me edukatën e një revolucionari. Në të respektohet dinjiteti i vetë autorit. Gradën që ai e ka marrë e ka merituar, por për hir të çështjes ai bën lëshim. Letra është e çiltër dhe kërkon çiltëri nga të tjerët. Thashethemet që kishin lindur vetëm shtonin përçarjen. Markoja duhej të ngrihej mbi to, duke i hedhur prapa krahëve; ai kishte arritur madhështinë e revolucionarit të vërtetë.

Pasi pa se pas 15 ditësh Sturnare me Karaiskaqin nuk u dorëzuan, më 20 korrik Mustafa Pasha e ndau ushtrinë në tri pjesë. Njërin prej 5000 vetash e nisi kundër Sturnarës, të dytën prej 6000 vetash — kundër Karaiskaqit dhe të fundit së bashku me kalaverinë e dërgoi për në Karpenisi, ndërsa reparti i Omer Vrionit u la në rezervë. Sturnara sillej rreth e rrotull nëpër Agrafa pa i dhënë betejë të hapur, Karaiskaqi i sëmurë, pasi bëri një qëndresë më 24 korrik, u tërhoq edhe ai në Agrafa në manastirin e Prusës. E tërë pesha e luftës do të binte mbi Marko Boçarin dhe suliotët e tij. Ndërkohë, pararoja osmane e vendosur në Karpenisi përbëhej prej 5000 vetash.<sup>2</sup> Markoja e pa të arsyeshme që të godiste një pjesë të forcave të armikut. Me repartin e tij ai shkoi në Katoçi, midis Mesolongjit dhe Vonicës me 1200 veta, ku sulmoi, zuri rob dhe vrau një pjesë të forcave armike<sup>3</sup> e pas

1) Niku Zhagu, *Markos Boçaris*, f. 161-162.

2) Apostolu E. Vakallopullu, *vep. e cit.*, f. 564. Sucoja thotë se ishin 8000 veta (*vep. e cit.*, f. 291), Blekier — 14.000 (*vep. e cit.*, f. 293).

3) Edouard Blekier, *vep. e cit.*, f. 293.

kësaj arriti në fshatin Qefallovrisi pranë Karpensisit. Metaksai e thirri Markon dhe i vuri në dukje se i vetmi shpëtim ishte shtrëngimi i radhëve të suliotëve. Markoja mori përsipër bashkimin kompakt të tyre sepse vetëm kështu mund të ngrihej edhe kurajo e kryengritësve të tjerë. Si edhe në rrethimin e parë, ai kishte vendosur ta shpëtonte edhe një herë Mesolongjin. Metaksai në «Kujtimet» e tij vë në dukje se Markoja i thirri të gjithë kapedanët suliotë në korridorin e një shtëpie të madhe, «u foli atyre shqip, në gjuhën e tyre»<sup>1</sup> dhe u mbajti një fjalim plot entuziazëm. Ai u tha: «Shpirti më copëtohet kur shoh atdhetarët e mi të dyshojnë drejtpërdrejt se unë dashkam të komandoj mbi të gjithë. Përçarjet tona sollën rrënimin e suliotëve dhe pikërisht këtë kërkojnë armiqtë tanë. Ne kemi humbur atdheun tonë dhe po kërkojmë një banesë tjetër, a do t'ia arrijmë duke qenë të përçarë? Ne duam të ruajmë famën tonë luftarake, por a do ta mbajmë duke qenë në mosmarrëveshje? Ne jemi të paktë në numër por për shkak të famës së emrit tonë, shumë të huaj (jo shqiptarë — K. X.) bashkohen me ne dhe lavdia e fitoreve tona na takon neve, megjithëse kemi ndihmën e tyre. Kur ne jemi të bashkuar dhe formojmë një trupë të vetme ushtarake, ne jemi suliotë. Çdo qeveri na ledhaton. Të përçarë, ne do të jemi të detyruar të bashkohemi me të tjerë, emri i suliotëve do të shuhet dhe ne do të bëhemi ushtarë të Iskosit, Rangosit (kapedanë grekë të revolucionit — K. X.). Ne nuk duhet të harrojmë sa i detyrohemi atdheut tonë të veçantë, Sulit, stërgjyshërve tanë. Në qoftë se kemi humbur shtëpitë tona, tokën tonë, ne duhet ta ruajmë emrin e Sulit, por vetëm duke qenë të bashkuar. Ne mbajmë emrin e stërgjyshërve tanë të lavdishëm, të cilët kanë luftuar gjithnjë kundër tiranëve për lirinë e tyre. Ç'emër do të na mbetej? Mua do më mbetej ai i Boçarit, ty ai i Xhavellës, ty ai i Zervës, Fotomarës, Dangëlliut, në qoftë se ne do të ndaheshim dhe

---

1) Const. Metaxas, *Souvenirs de la Guerre de l'indépendance de la Grèce*, Paris, 1879, f. 152.

do të regjistroheshim në radhët e të tjerëve... Vëllezër ne kemi detyra ndaj vetëvetes, ndaj nderit tonë, ndaj famës sonë luftarake, ndaj familjeve tona! Ç'dobi do të kemi ne nga përçarjet tona, ç'dobi do të kenë fëmijët tanë? Vëllazëria, pra, marrëveshja midis nesh, janë të vetmet mjete me të cilat mund të mbrojmë atdheun tonë të shenjtë dhe njëkohësisht të bëhemi të dobishëm për lirinë e Greqisë. Unë, o patriotë, nuk i kam kërkuar grada qeverisë, as kam qenë emëruar kryekomandant, megjithatë një gradë më është dhënë, por a nuk e meritoni ju të gjithë siç e meritova unë? E pra, për t'ju provuar se unë jam larg ndjenjave të egoizmit dhe të ambicies dhe që jam po ai Marko që ju keni parë gjithmonë të luftojë bashkë me ju, po e gris përpara jush diplomën time të gjeneralit dhe po ju betohem se nuk dua asnjë vlerësim tjetër përveç atij që kishin stërgjyshërit tanë dhe ju të gjithë: lavdinë dhe nderin. Ja, armiku po ju pret, vetëm në fushën e betejës ne do të lëvdojmë dhe do të nderojmë trimërinë.»

«Pasi u foli kështu, — vazhdon Metaksai, — Markoja e grisi diplomën e tij të gjeneralit. Fjalimi dhe veprimi i tij i mallëngjeu të gjithë pesëmarrësit, të cilët, aty për aty, u ngritën dhe përqaftuan njëri-tjetrin. Pasi mori me vete Xhavellën dhe kapedanët e tjerë suliotë, ai i solli ata tek unë, që i prita duke derdhur lot gëzimi; ata më lajmëruan se ishin gati të vdisnin në luftë kundër armikut, atje ku unë do ta konsideroja të përshtatshme. Pasi u shpreha gjithë gëzimin për këtë dëshirë të tyre, u thashë që të merrnin me vete Xhongën dhe Makrin,<sup>1</sup> me qëllim që të vendosnin së bashku pozicionet më të përshtatshme në kampet e tyre.»<sup>2</sup>

Kështu, për Marko Boçarin gjithçka ishte uniteti brenda radhëve të suliotëve, ky ishte kushti vendimtar i fitores, të gjitha forcat duheshin kursyer për luftën dhe fitoren e revolucionit, për dekretin e qeverisë dhe gradën e gjeneralit ai nuk shqetësohej.

1) Kapedanë të revolucionit.

2) Const. Metaxas, *vep. e cit.*, f. 181.

Për të marrë masat për gjendjen e krijuar u bë mbledhja e kapedanëve. Disa prej tyre propozuan që të largoheshin nga Mesolongji bashkë me repartet e tyre dhe të zgjidhnin veç e veç pozitat në ngushticat malore, ndërsa disa të tjerë vendosën të mbylleshin në qytet dhe atje të përballonin armikun. Marko Boçari nuk miratoi asnjërin prej këtyre propozimeve. Sipas Nerulos ai tha: «Vëllezër, vendi është në rrezik të madh dhe imediat. Po të qëndrojmë në Mesolongj ne do të vritemi, sepse nuk kemi municione të mjaftueshme as dhe ushqime. Në qoftë se do të zëmë ngushticat e maleve, armiku do ta gjejë rrugën e lirë, do të kalojë në Peloponez dhe do ta pushtojë atë. Të dashur shokë! Do të ishte turp për ne të tërhiqeshim përpara rreziqeve dhe të braktisnim pozitat në këto rrethana kritike. Mua më duket se çasti është i favorshëm jo për fitoren, për të cilën unë nuk jam i sigurt, por për lavdinë që është e pamundur të mos e fitojmë. Sot turqit janë në Karpenisi, brenda dy ditëve do t'i shohim këtu. Duhet, pra, të marshojmë kundër tyre sa më shpejt dhe t'u biem gjatë natës mu në kampin e tyre. Tani ne e dimë se manevra të tilla na kanë dalë me sukses».<sup>1</sup>

Markoja kishte parasysh përvojën e betejave të mëparshme. Në Drameshët, në Rrenjas, në Variadhë, në Rapsistë, në Pesë Puset, në Lelovë dhe në Kanxhë, në Bogoricë, në Lipë dhe në Serjan, në Toskës, në Dervixhan, në Plaka, në Vllahohorë dhe në Kombotë, ai kishte sulmuar në befasi e me guxim armikun që kishte pasur epërsi numerike në krahasim me të. Tani puna qëndronte ndryshe. Epërsia e armikut në numër ishte shumë më e madhe ndaj dhe guximi duhej të ishte i jashtëzakonshëm.

Nga fjala që mbajti Markoja, disa kapedanë u çuditën dhe njëri prej tyre ia priti: «Forcat tona nuk janë në përpjesëtim me ndërmarrjen që propozohet. Po të sulmojmë armikun ne nuk do t'i shkaktojmë atij dështimin përfundimtar dhe kjo përpjekje do t'i shterojë forcat

---

1) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.*, f. 465-467.

tona». Atëherë Markoja u përgjigj: «Unë bëra vetëm propozimin tim, e konsideroj më të mirin dhe do ta zbatoj vetë, pa marrë parasysh asnjë rrezik, ndërsa ju shokë qëndroni këtu dhe gjeni mjettet për të mbrojtur vendin». Markoja doli jashtë dhe mblodhi suliotët e tij. Ai iu drejtua atyre me këto fjalë: «Shokë, ju e dini se deri më sot ndërmarrjet tona janë kurorëzuar me sukses. Ju kujtohet sa herë ndihma hyjnore na ka shpëtuar nga rreziqe më të mëdha. Dhe tani kemi një rast të dëshpëruar, por që do të na bëjë domosdo të pavdekshëm. Pashai i Shkodrës sapo ka zbritur në Karpenisi, ne nuk kemi mjete që ta luftojmë këtu ku jemi. Po ta presim këtu do të humbasim lirinë për të cilën kemi derdhur kaq gjak, do të humbasim familjet tona, njëkohësisht... nderin. Këto janë shkaqet që na detyrojnë të marshojmë sonte kundër osmanëve. Ata nga trimat e mi që do të dëshirojnë të vijnë pas meje, të radhiten që t'i shoh». <sup>1</sup>

Pra, vetëm një aksion i befasishëm, sa i rrezikshëm aq dhe heroik, do ta zgjidhte çështjen për të cilën luftonin. Rrugë tjetër nuk kishte. Gjendja e jashtëzakonshme kërkonte vendime të jashtëzakonshme. Markoja kishte hedhur zaret. Urrejtja kundër pushtuesit shumëshekullor dhe nëpunësve të tij gjakpirës ishte themeli i këtij guximi të papërmbajtur. E tërë jeta nuk mund të shkonte duke rënkuar. Muza popullore shqiptare këndon kështu për këtë vendim:

*Ish një burrë trim i ri,  
I zeshkë mustaqezi,  
Mbaji (mbante — K.X.) dorën mbi harbi,  
Mbaji vesh, s'flit me njeri.  
Marko Boçari qe ky,  
Mbaji vesh dhe dëgjoj,  
Psherëtiu dhe rënkoj,  
Nga trimat e tij vështroj,*

---

1) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.*, f. 465-467.

*Tha: «Ndo të vdes, ndo të rroj,  
Këtë jetë s'mund ta shkoj,  
Nat'e ditë oj e oj».<sup>1</sup>*

Për vendosmërinë dhe guximin në sulm, muza popullore këndon:

*Shokët e tij numëroi,  
Treqind vetë plot mbloi,  
U tha: «shokë, o asllanë  
Mos e gëzofshi dynjanë,  
Si roje (si rroni) ndër turkollarë!  
Sonte do t'u derdhim gjaknë!  
Ta zemë prej mjekre pashanë,  
Kadilerë e agallarë,  
T'i pritni me jataganë,  
Asnjë mos lir' të gjallë,  
Le të shkulet ajo farë,  
Se na poqi na vu në zjarrë.»<sup>2</sup>*

Dy suliotë të cilëve u dukeshin shenjat e plagëve të marra në betejat e mëparshme e pyetën Markon aty për aty: «Përse ti kapedan Marko përpiqesh të na nxitësh me hyrje të gjata? Vetëm një fjalë jotja për ne mjafton; jemi gati të vdesim kur ti të na urdhërosh». Pas tyre u radhitën pranë Markos edhe vullnetarë të tjerë nga qyteti i Pargës dhe tetë nga Shtatë Ishujt: «Edhe ne duam të vdesim me Boçarin.» Por Markoja me çiltërinë e tij të natyrshme u përgjigj: «Nuk do të vdesim, zoti do të na ndihmojë edhe këtë herë». Dhe populli përreth ia priti: «Bekimi i Greqisë, urimet e të gjithë të vuajturve të jenë për ju, o mbrojtësi i atdheut».<sup>3</sup> Sa për numrin e vogël të suliotëve në krahasim me atë të armiqve, Mar-

---

1) Ramadan Sokoli, *Marko Boçari*, «Bashkimi», 15 korrik 1979, f. 3.

2) Ramadan Sokoli, *po aty*, Niku Zhagu, *Markos Boçarit*, f. 189.

3) J. Rizos Nérolos, *vep. e cit.*, f. 467.

koja u përgjigj: «Ashtu sikurse zjarri i paktë triumfon mbi stivën e druve të thata, edhe luftëtari trim triumfon mbi armikun po e gjeti në befasi».<sup>1</sup>

Boçari u kthye për t'u takuar me kapedanët e tjerë, të cilët e pyetën për vendimin që kishte marrë: «Nisem brenda një ore, — u përgjigj ai, — dhe shpresoj se do t'ia dal, ndërsa ju meqenëse nuk dëshironi ta ndani me mua këtë ndërmarrje, armatosni luftëtarët tuaj dhe ndiqmëni nga larg. Po t'ia dal, ju do të plotësoni suksesin tim, ndryshe do të kini kohë që të tërhiqeni».<sup>2</sup>

Markoja u kthye te shokët e tij luftëtarë dhe u shpjegoi atyre planin e veprimit: «Vëllezër, meqenëse ne jemi pak, duhet ta rregullojmë mirë sulmin tonë. Kur të ndodhemi pranë kampit armik, do të shpërndahe mi në disa pika, sipas mënyrës sonë të zakonshme, me qëllim që turqit mos të na vënë re. I vendosur të vdes, apo të kap të gjallë pashanë, unë do të drejtohem në çadrën e tij me dyzet luftëtarë (ishin suliotët më trima — vëren J. Nerulos — K. X.). Shenja e luftimit do të jetë shpërthimi i zjarrit nga të shtënat e pushkëve në çastin kur unë do të hyj në çadrën e pashait; atëherë ju të gjithë, të shpërndarë nëpër kamp, do të bëni të njëjtën gjë, do të zbrazni koburet tuaja, do të zhvishni shpatat tuaja. Errësira e natës do të na ndihmojë dhe armiku i llahtaritur do të shpartallohet, duke besuar se po sulmohet prej një ushtrie të madhe. Parulla do të jetë në gjuhën shqipe: Pyetja do të jetë kjo: «Cili je ti.» dhe përgjigja: «Jam hekuri».<sup>3</sup>

Marko Boçari mendonte që në sulm e sipër të hynte në çadrën e pashait kryesor, pastaj të pashallarëve të tjerë e t'i vriste ose t'i zinte të gjallë ata. Ushtria osmane e mbetur pa kokë, do të shpërbëhej dhe do të shpartallohej. Planin e vet të veprimit ai ia dërgoi Metaksait, me sekre-

---

1) J. Gazis, *Biografia e Marko Boçarit dhe Karaïskaqit*, Egjinë, 1828, f. 16.

2) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.*, f. 467.

3) *Po aty*, f. 468-469.



tarin e tij Vasil Gudën. Me ta lexuar këtë plan Metaksai thirri: «Ky i paska hedhur të gjitha zaret njëherësh».<sup>1</sup>

Disa ditë më parë, më 6-7 gusht, Markoja kishte dërguar në kampin e armikut kushëririn e tij Tushi (Thanas) Boçarin, Thanas Kuconikën dhe Jani Bajraktarin si zbulues. Ata i sollën kapedanit të tyre informata shumë të vlefshme. Në bazë të këtyre ushtria armike ishte përbërë prej fisesh e kombësish, me fe të ndryshme. Mungonte organizimi dhe rregulli, kishte vjedhje në radhët e saj, dhe të gjitha këto elemente që shkaktonin një farë anarkie, e lehtësonin sulmin dhe fitoren e befasishme. Kënga popullore e shpreh kështu këtë përgjigje të Markos:

*Kur u hodhën (osmanët — K. X.) tek Komboti,  
Dëgjoi Marko Sulioti,  
E thirri Dush Bajraktarë (kapedan Tushi Boçarin  
— K. X.)*

*Q'e kish n'asqer të parë.  
Erdhën Markos e i thanë:  
Njëzet mijë gjithë janë  
E thirri Dushnë mënjanë,  
Trimat tanë sa janë?  
Treqind veçse kapedanë.  
Vërtet nuk jemi shumë,  
Po të bëjmë një punë,  
Se janë çadra shumë!  
Ju të hidhni anembanë  
Se u do vras pashanë,  
Të birë dhe qehajanë,  
Të dëgjojnë dhe sulltani  
Ç'është Marko Boçari.  
Marko Boçari Sulioti.<sup>2</sup>*

Pra Marko Boçari vendosi të sulmojë armikun natën në errësirë, sipas zakonit suliot. Plani ishte ky: Nëntëqind

1) Const. Metaxas, *vep. e cit.*, f. 182.

2) Eftim Mitko, *Bleta Shqiptare*, f. 144-145.

suliotë dhe kryengritës të tjerë do të sulmonin natën, ndërsa dy mijë do të vendoseshin në një lartësi aty afër. Ata do të shërbenin si rezervë për të vepruar në mëngjes në rast nevoje dhe për të dhënë goditjen e fundit.<sup>1</sup>

Duke u gdhirë 21 gushti 1823 me 500 veta, Markoja sulmoi krahun e majtë të kundërshtarëve të shumtë, kurse Kiço Xhavela me katërqind veta sulmoi krahun e djathtë.<sup>2</sup> Filloi beteja dhe për shkak të befasisë armiku u trullos. Ai e mori veten vetëm pasi kuptoi se ishin kryengritësit ata që kishin sulmuar dhe pikërisht vetë Marko Boçari. Mbi ta u bë kërdua. Në betejë e sipër Markon e mori një plumb dhe e shtriu përdhe. Aleksandër Sucoja e tregon kështu këtë betejë: «Boçari hyri në mesnatë. Disa ushtarë u zgjuan dhe nisën të thërrasin. Pesë prej tyre u vranë. Boçari dha atëherë shenjën dhe kasaphana filloi në të gjitha pikat... Markoja la midis tyre nja pesëdhjetë suliotë, të cilët vazhduan të qëllojnë me armë zjarri. Të tjerët ai i mori me vete dhe bashkë me ta iu drejtua ushtarëve të pashait, të cilëve u foli në gjuhën shqipe: Ku është pashai?

Gjatë luftimeve të mëtejshme, ndonëse i plagosur, Boçari vazhdon të luftojë, por një plumb i dytë e goditi atë në kokë për vdekje. Ai u rrëzua nga kali duke shqiptuar këto fjalë: «Miq, ma merrni hakën».<sup>3</sup>

Për trimërinë e suliotëve kënga popullore thotë:

*«Në Mesolongjë të shkretë,  
Vate Musta beu vate (Mustafa Pasha — K. X.),  
U përkul kordha xhelate,  
Mbetnë taboret në tabie,  
N'ato tabie plot pëllëmba,  
Luftojn'e s'u tundej këmba*

---

1) Apostolu E. Vakallopullu, *vep. e cit.*, f. 123-127. G. G. Gerwinus, *vep. e cit.*, f. 591-595.

2) Apostolu E. Vakallopullu, *vep. e cit.*, po aty.

3) Alexandre Soutzo, *vep. cit.*, f. 197.

*Ç'kishin lindur ato nëna,  
Kishin pjell'e bërë drëra.<sup>1</sup>*

Në fushën e betejës suliotët lanë gjashtëdhjetë të vdekur e dyzet e dy të plagosur, të cilët mundën t'i merrnin me vete. Ata shtinë në dorë mjaft plaçkë lufte: katër flamurë osmanë, 1600 pushkë, 1800 kobure, 300 jataganë, 1200 kuaj e të tjera.<sup>2</sup>

Për mbrojtjen e trupit të Markos të plagosur për vdekje, suliotët u detyruan të bënin një betejë edhe më të ashpër. 26 veta u vranë pranë komandantit të tyre, por ata mundën ta shpëtonin trupin. Markoja iu drejtua me këto fjalë shokëve të tij: «Vëllezër e kreve detyrën ndaj lirisë dhe po vdes i kënaqur... Qëndroni të bashkuar e besnikë ndaj vendit... Marshoni pa frikë kundër armikut dhe çojeni deri në fund aksionin e filluar.»<sup>3</sup> dhe shtoi: «Mos harroni se një popull nuk mund të fitojë pavarësinë e vet dhe nuk mund të këpusë prangat veçse me çmimin e vetëmohimit dhe të gjakut të një numri të madh të bijve të vet.»<sup>4</sup>

Marko Boçari kishte marrë përsipër dhe kishte kryer një aksion të jashtëzakonshëm. Me një grusht njerëzish të guximshëm ai kishte shpartalluar një ushtri të madhe osmane. Armiku nuk mundi ta merrte Mesolongjin, as të shkelte në Peloponez. Revolucioni kishte shpëtuar.

\*  
\*   \*  
\*

Varrimi i Markos u bë madhështor, siç qe aksioni dhe tërë jeta e tij. Po e japim sipas Dora d'Istrias: «I mbështjellë me kapotën e kuqe, si flaka e luftëtarëve krenarë

1) Mexhit Kokalari, Trima të kryengritjeve popullore Tiranë 1983, f. 22.

2) Apostolu E. Vakallopullu, *vep. e cit.*, f. 126.

3) Brunet de Prêslé, *vep. e cit.*, f. 168; Camillo Paganel, *vep. e cit.*, f. 40.

4) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.*, f. 472.

të Shqipërisë, duke patur pranë shpatën, miken besnike të veprave të tij heroike, Boçari ishte shtrirë mbi një tavolinë që mbahej prej gjashtë trimash suliotë. Përpara tij ecnin robërit të lidhur me pranga, flamurët që u kishin zënë turqve në luftime, kuajt e luftës të pajisur në mënyrë të shkëlqyer. Kortezhi mbyllej prej mushkave të ngarkuara me pushkë dhe kobure, prej 8000 deleve dhe prej municioneve të kapura në kampin e armikut. . . Trupi u vendos në shtëpinë e eparkut të Mesolongjit (prefektit — K. X.). Në mbrëmje hynë gratë e porositura për të kënduar këngën e vajtimit. Ato ishin të veshura sipas zakonit, me të bardha. Flokët e tyre të dendura u valëviteshin mbi supe. Të radhitura përreth Boçarit, ato nuk u munduan shumë të gjenin dhembjen që mbushte të gjithë shpirtërat, as dhe thekset më të larta të të qarave, që improvizohen pranë të vdekurve. Në mesnatë gjithçka hyri në një paqe solemne. Qyteti i heshtur dhe i kapitur përgatitej për ceremoninë e rëndë të së nesërme. Kur mbrojtësi i Mesolongjit u duk në rrugë, futur në një qivur të stolisur me degë selvie, me fytyrë të zbuluar e me krahët e tij të pamposhtur, të kryqëzuar mbi një zemër që nuk ishte dridhur kurrë, tingulli i kabanave dhe zhurma e artilerisë ushtuan që prej bregut deri në luginat e lumit Arasint. Nga dritaret gratë bënë të binin si shi lulet e përziera me ujë trëndafili, mirre dhe aloisi. Kortezhi ecte përpara drejt kishës.»<sup>1</sup> I tërë populli u gjunjëzua para trupit të heroit të tij. Autorja e mësipërme shton: «Pastaj toka e fshehu syve të helenëve trupin e ushtarit më fisnik të Greqisë së rilindur. Ndoshta shembulli i tij do të kishte triumfuar mbi rivalitetet që e çuan (Greqinë — K. X.), dy gishtë pranë humbjes».<sup>2</sup>

Artileria i dha trimit lamtumirën e fundit me 33 të shtëna, aq vjeç sa heroi kishte rrojtur.<sup>3</sup> Peshkopi dhe Metaksai hodhën të parët dhe mbi varrin e të paharruarit

1) Dora d'Istria, *Excursions...*, vep. e cit., f. 283-287,

2) Dora d'Istria; po aty.

3) Jani Benekos, vep. e cit., f. 417.

për të mbuluar «burrin trim dhe shpresat e mëdha që ushqente për të Greqia».<sup>1</sup> Vdekja e Markos ishte një humbje e pazëvendësueshme për Revolucionin Grek.

*Mesolongji u helmua,  
I derdhi lotët si krua,  
Mesolongji ndaj të thonë,  
Ku e ke Marko Sulonë,  
Që s'lëfton si pat zakonë,  
Gjithnjë me kordhë në dorë!*<sup>2</sup>

Le ta japim varrimin e tij sipas Metaksait. Ai shkruan: «Në mëngjesin e datës 10 (23 gusht — K.X.) unë dëgjova britma dhe rënkime jashtë shtëpisë sime dhe pashë të hynte Guda duke qarë fort. Ai më lajmëroi për vdekjen e Markos dhe se po sillnin trupin e tij. Unë mbeta pa gojë nga dhembja e kësaj katastrofe të re. Dola menjëherë dhe pasi mblodha me një shenjë të syve banorët e Mesolongjit, u vërsula jashtë qytetit për ta pritur. E mora në krahët e mi kufomën e këtij njeriu të madh.

Një motër e Markos që quhej Maro... dhe që banonte në Mesolongj, më çoi fjalë nëpërmjet Gudës dhe më lutej ta çoja të vdekurin në shtëpinë e saj për t'ia bërë të gjitha nderimet e përmortshme, siç ishte zakon në Suli. E çuan të vdekurin te Maroja, së cilës i shpreha hidhërimin që më shkaktonte humbja e këtij kryetari, mikut tim dhe njerit nga përkrahësit më të fuqishëm të Revolucionit Grek. Ajo më falenderoi për fjalët e mia miqësore dhe m'u përgjigj: «Ne jemi të mësuar me vdekje të kësaj natyre, sepse që nga çasti që kemi njohur botën, nuk kemi dëgjuar të flitet për tjetër gjë nga baballarët dhe vëllezërit tanë, veçse për luftëra dhe vdekje». Duke thënë këto ra mbi kufomën e të vëllait».<sup>3</sup>

1) Const. Metaxas, *vep. e cit.*, f. 140.

2) Thimi Mitko; *vep. e cit.*, f. 149.

3) Const. Metaxas, *vep. e cit.*, f. 167-168.

Marko Boçari e kishte radhitur veten në lartësinë e luftëtarëve revolucionarë të mëdhenj. Për revolucionin ai kishte dhënë ç'kishte pasur: pasurinë, krahun, gjakun dhe së fundi jetën e tij.

Ndërkaq, rrethanat e brendshme para Karpenisit ishin shumë të rënda për Revolucionin Grek. Krahinat e Akarnanisë dhe të Etolisë, kryeqendra e të cilave ishte Mesolongji, nuk kishin trupa të mjaftueshme. Peloponezi ishte hedhur në grindje, në rrugën e Tripolicasë një re-part nga Arkadia përleshej me një batalion spartanësh, Kollokotroni dhe Mavrokordatoja grindeshin, senati grek kishte mbetur pa kryetar, qeveria nuk kishte autoritet, admiralët e Hidrës, goftë dhe përkohësisht, ishin shkëputur prej saj. Vendi ishte gati të kthehej në anarki. Shteti duhej të bazohej në ligjet dhe këto duheshin mbrojtur siç mbroheshin muret e Mesolongjit. Sipas Markos despotizmi shpinte në degjenerimin moral të njerëzve, sepse veset bëheshin praktikë e përditshme. Ai ëndërronte për një shoqëri të pastër moralisht, mendim ky sa iluminist<sup>1</sup> aq edhe utopik për një shoqëri me klasa antagonistë. Në këto momente kritike, Marko Boçari u mësoi të tjerëve se pa bashkim dhe kompaktësi nuk mund të arrihej në fitore. Në këto rrethana ai nuk mund ta lajmëronte qeverinë për vendimin dhe betejën që do të zhvillonte, aq më pak të priste miratimin e saj. Vonesa për të ishte vdekje. Pritja ishte e barabartë me përplasjen e fortunës mbi Mesolongjin, mbi revolucionin.

Autoritetet e Mesolongjit më 31 gusht 1823 i dërguan qeverisë greke një relacion të hollësishëm mbi zhvillimin e betejës së Karpenisit dhe vdekjen e Marko Boçarit. Midis të tjerash, aty vihej në dukje se plani i Markos për sulmin e befasishtë natën ishte pranuar njëzëri dhe se

---

1) Claude Mossé, *Histoire des doctrines politiques en Grèce*, Paris, 1969, f. 75.

**shkaku kryesor i zbatimit të tij kishte qenë rreziku i madh që i kanosej revolucionit.**

Propozimi i planit dhe zbatimi i tij me flijimin e jetës, tregoi se Markoja kishte besim të pakufishëm te masat e popullit. Bashkëkohësit e ndienë shumë humbjen e këtij burri të shquar. Qeveria Greke e lajmëroi popullin për vdekjen e Markos nëpërmjet një komunikate të posaçme. «E lumtur dhe fri herë e lumtur hieja e gjeneralit të pavdekshëm Marko Boçari... Grekë të dashur! Ja edhe një Leonidhë tjetër në shekullin tonë. Greqia mbeti jetime dhe u vesh me të zeza. Cili grek me ndjenja nuk entuziazmohet dhe nuk dëshiron të luftojë dhe të vdesë nga një vdekje e tillë e lavdishme si Boçari? Rrëmbeni armët! Imitoni stërgjyshin tuaj të pavdekshëm dhe Boçarin e sotëm».<sup>1</sup> Qeveria e shpalli tërë vendin në zi.<sup>2</sup> Për një kohë të gjatë emri i Markos kalonte gojë më gojë. Personaliteti i tij kishte lënë gjurmë të pashlyeshme. «Mjafton njeriu të shikojë arkivat shtetërore dhe private që të bindet për jehonën që pati vdekja e Markos. Në të gjithë korrespondencën që këmbehej midis njerëzve të kohës, ushtarake apo politike, është e pamundur që të mos gjesh fjalë për vdekjen e Markos, çka tregon se sa e nderonin udhëheqësin e shkëlqyer dhe ç'shpresa kishin mbështetur tek ai».<sup>3</sup> Ishte e qartë se «humbja e këtij shqiptari trim qe shumë e ndjeshme për çështjen greke».<sup>4</sup>

\*  
\*   \*  
\*

Jehona e fitores së Boçarit në Karpenisi la mbresa të jashtëzakonshme te bashkëkohësit dhe te studiues të ndryshëm. Që nga fillimi i Revolucionit Grek kurrë nuk ishte

1) Dhionis Kokinos, *vep. e cit.*, vëll. VI, f. 332.

2) C. D. Raffanel, *vep. e cit.*, f. 200.

3) Dhionis Kokinos, *vep. e cit.*, f. 332.

4) Léon Hugonnet. *La Grèce nouvelle, héliénisme, son évolution et son avenir*, Paris, f. 115.

parë një dërrmim i tillë i armikut. Marko Boçari u ngrit më lart edhe nga heronjtë më të mëdhenj të lashtësisë greke. Jorgji Gaziu, një nga pjesëmarrësit veprues të revolucionit dhe sekretari i Gjergj Karaiskaqit, ka shkruar: «Çdo fjalë e tij ishte e barabartë me shprehjet e urta të të diturve të kohës së vjetër».<sup>1</sup> Kostandin Paparigopulli vë në dukje se armiku la në betejë 800 burra, «por Revolucioni Grek humbi një nga luftëtarët më të mirë».<sup>2</sup> Anglezi Blejker, një nga vullnetarët e revolucionit, u shpreh: «Sado e shkëlqyer që të ketë qenë fitorja, ajo u ble shumë shtrenjtë. Pavarësisht nga përfundimet që i jep njeriut shkenca dhe edukata, Marko Boçari ishte i pajisur me të gjitha virtytet që mund t'i jepen njeriut. Këto virtyte ishin të larta tek ai për shkak të karakterit të tij të thjeshtë, shembulli i të cilit gjendet vetëm te heronjtë e Plutarkut... Me siguri akti i fundit i kësaj jete e përballon me epërsi paralelin me njerëzit që janë të denjë për t'u patur zili, si Leonidha apo heroi i Mantine-së.\* Greqia do ta qajë për një kohë të gjatë këtë humbje të pandreqshme, megjithëse s'ka vdekte më të lavdishme. Në qoftë se shpresa për të zëvendësuar një njeri të tillë është vështirë për t'u përmbushur, duhet të jemi në një mendje se ky shembull devotshmërie mund të provojë vetëm efektet më shëndetdhënëse mbi ata që mbajnë sot barrën e fateve të tyre».<sup>3</sup> Pukëvili i bën këtë portret Marko

---

1) J. Gazis, *Leksikon tis Epanaspaseos qe alla erga*, Janinë, 1971, f. 370.

2) Kostandin Paparigopulli, *vep. e cit.*, f. 108.

\*) Epaminonda (418-362 para e.r.), Duhet thënë për sqarim se krahasimi i Marko Boçarit me gjeneralin dhe burrin e shtetit të Tebës (Greqi) së lashtë është vetëm pjesërisht i saktë. Të dy ranë si heronj. I pari në Karpenisi kundër pushtuesit osman, i dyti kundër Spartës në betejën e Mantinesë, dhe të dy betejat i fituan. Por Teba dhe Sparta luftonin për epërsi në Greqi çka çoi në dobësimin e mëtejshëm të saj dhe në rënien në duart e Maqedonisë. Për Marko Boçarin ishte krejt ndryshe.

3) Edouard Blaquières, *vep. e cit.*, f. 398.



Boçarit: «Marko Boçarit, Melpomeni i kishte dhuruar zërin e bukur dhe kitarën për të kënduar në kohën kur ruante kopetë e kapedanit, babait të vet, në brigjet e Sulit. Me një shtat të zakonshëm prej sulioti, rreth pesë këmbësh, ai ishte kaq i lehtë për të vepruar, saqë e krahasonin me zefirin. Asnjë nuk matej me të në mundje, në lojën e diskut, dhe kur sytë e tij të kaltër gjallëroheshin, flokët e tij të gjatë fluturonin mbi shpatullat dhe balli i rrojtur sipas zakonit të lashtë, reflektonte rrezet e diellit. Ai kishte diçka të jashtëzakonshme, saqë e merrnin për pasardhës të pellazgëve, bij të Fedhonit, që qytetëruan Epirin. Ai kishte lënë gruan dhe familjen në tokë të huaj për t'u dhënë me më shumë guxim fatit të luftimeve. Si poet dhe luftëtar, në çastin e çlodhjes ai merrte lirën dhe u tregonte me këngë fëmijëve të Sulit emrat e heronjve, stërgjyshërve të tyre, veprat e tyre, lavdinë e tyre dhe detyrimin për të vdekur si edhe ata për ligjet e shenjta të atdheut.»<sup>1</sup>

Ogyst Fabrë ka shkruar se Marko Boçari me trimërinë dhe vetëmohimin e tij u tregua më lart se Leonidha në betejën e Termopileve.<sup>2</sup> Dora d'Istria shkruan: «I adhuruar prej familjes, fëmijëve dhe gruas së tij, Boçari nuk ishte një stoik i pavlefshëm. Ai e dashuronte jetën, prandaj sakrifica dhe vdekja e tij janë më të admirueshme. Thjeshtësia e tij ishte e barabartë me trimërinë e tij, çinteresimi i tij për vete ishte në lartësinë e patriotizmit të tij, dashuria për detyrën nuk ishte më e vogël nga energjia e tij për të».<sup>3</sup> Në Italinë e robëruar të asaj kohe dhe të copëzuar politikisht opinioni publik ishte i dashuruar pas Boçarit. Ai njihej si njeri i pajisur me të gjitha cilësitë më të mira njerëzore. Shkrimtari italian dhe pjesëmarrësi i luftës për pavarësinë e Italisë, Luixhi Setembrini, tregon se babai i tij lexonte disa gazeta, që bënin fjalë për luftën

1) F. C. H. L. Pouqueville, *Histoire...* livre troisième, f. 153.

2) Auguste Fabre, *vep. e cit.*, f. 93.

3) Dora d'Istria. *Excursions, vep. e cit.*, f. 191-192 dhe *Les femmes en Orient*, f. 369, 370.

e pavarësisë në Greqi dhe i thoshte të birit: «Atje ka burra! Pa më thuaj mos ke ndër mend të bëhesh prift dhe jo një Marko Boçar?»<sup>1</sup> Çampolini theksonte se Markoja jetoi pak por shumë për lavdinë e tij. «Atë pak pasuri që kishte e përdori për të mirën e të gjithëve, duke e lënë familjen në skamje».<sup>2</sup> Ezhen Jemeniz, shkroi për Marko Boçarin se «ai fitonte dashurinë e të gjithë atyre që e njihnin për shkak të edukatës njerëzore, të ëmbëlsisë së zakoneve, për shkak se ishte i zhveshur nga çdo ves dhe jeta e tij sa qe e zhveshur nga ligësitë, aq qe pjellore për veprime të mëdha». Dhe vjen në përfundim se «historia me gjithë ashpërsinë që duhet ta karakterizojë në hulumtimet dhe gjykimet e saj të shëndosha, nuk mund të hedhë asnjë hije që të errësojë shkëlqimin e ndritshëm të Marko Boçarit».<sup>3</sup>

Qeveria greke kur e emëroi Markon komandant të Greqisë Perëndimore e motivoi kështu atë emërim më 11 tetor 1822: «Kapedani Marko Boçari nuk është vetëm i zoti në çështjet e luftës dhe i dëgjuar në të katër anët si trim luftëtar, por ai gëzon një respekt në tërë Greqinë Perëndimore, prandaj këshilli ekzekutiv e gjen të udhës që të emërohet ky suliot i lavdëruar komandant për tërë Greqinë Perëndimore».<sup>4</sup> Bryne de Prel ka theksuar karakterin e lartë të Markos dhe ka pohuar se ai qëndronte mbi udhëheqësit kryesorë të Revolucionit Grek, «disa prej të cilëve nuk e shikonin me sy të mirë sepse nuk futej në grindjet e tyre personale, në dëm të çështjes së çlirimit kombëtar. Humbje më të madhe se vdekja e Markos për Revolucionin nuk kishte».<sup>5</sup> Historiani i njohur grek, Vakallopoulos, i bën këtë karakteristikë Marko Bo-

1) Luigi Settembrini, *Memoranze della mia vita*, f. 13.

2) D. Luigi Ciampolini, *Storia del Risorgimento della Grecia*, Parte seconda. Firenze, 1846, f. 522.

3) Eugène Yemèniz, *vep. e cit.*, f. 62.

4) Përkhithme copash nga arkivi i Kryengritjes Greke, vëll. 1, AIH d. A. III. 86.

5) Brûnet de Presle, *vep. e cit.*,

çarit: «Me vdekjen e Marko Boçarit grekët humbën një burrë luftëtar të posaçëm, të cilin e stolisin shumë cilësi. Donte lavdinë, por qe i zoti i vetvetes dhe i thjeshtë, kombinonte trimërinë dhe aftësinë ushtarake me pjekurinë dhe urtësinë politike. Ishte korrekt dhe konsekuent në sjelljet e tij. E donte shoqërinë, nderonte të diturit dhe ishte i fjalës. Kishte zakon të nderonte njerëzit dhe me fjalë të matura t'i jepte zgjidhje çdo çështjeje».<sup>1</sup> J. Athanasiadis — Novas shkruan: «Ishte një personalitet me cilësi të rralla. Nuk qe vetëm mendje e jashtëzakonshme ushtarake, nuk ishte vetëm një politikan e diplomat i shkathët, nuk ishte vetëm një hero i patrembur, nuk ishte vetëm një luftëtar i zhveshur nga interesat personale, por ishte edhe njeri i larta në shpirt. Nëse ishte i rreptë dhe i egër në luftë, ishte shumë i qetë dhe i bindur në kohë paqeje. Ndoshta pak e dinë që Markoja kishte një natyrë poetike romantike, vizioniste. Në vlerësimin e Markos s'ka anti-teza, s'ka mendime të dyta».<sup>2</sup> Gaston Izamber vë në dukje se ushtria osmane përpara Mesolongjit takoi «një hero të admirueshëm, me një kurajë dhe durim që nuk mposhteshin kurrë, — Marko Boçarin».<sup>3</sup> Atë pak pasuri që kishte e përdori për të mirën e të gjithëve, duke e lënë familjen në skamje.<sup>4</sup> «Ushtria greke me vdekjen e Markos humbi një udhëheqës ushtarak të shkëlqyer».<sup>5</sup> Jorgji Gaziu i cili e ka njohur personalisht Marko Boçarin, thotë se ai ishte i pajisur me veti të shquara. Ai ishte ushtarak dhe njeri politik, nderonte njerëzit e ditur dhe i pëlqente të shoqërohej me ta, në ushtri ishte modest dhe i ndershëm, fliste me takt e delikatesë, fjalët i kishte të pakta dhe të matura, dëgjonte shumë dhe i zgjidhte çështjet shpejt, ishte i sjell-

1) Apostollu Vakallopullu, *vep. e cit.*, f. 369.

2) Cituar prej Jani Benëkos, *vep. e cit.*, f. 423.

3) Gaston Isambert, *vep. e cit.*, f. 173.

4) D. Luigi Ciampolini, *Storia del Risorgimento della Grecia*, parte seconda, Firenze, 1846, f. 522.

5) Jani Kordhatos, *vep. e cit.*, vëll. II, f. 390.

shëm por i rezervuar në mendimet e tij; ndaj vartësve ishte korrekt, i respektueshëm dhe miqësor, ndaj eprorëve i denjë. Nuk i pëlqenin aspak fjalët e pahijshme dhe të sharat, dhe kur i dëgjonte «skuqej dhe e mbërthente turpi sikur të ishte vajzë».<sup>1</sup>

Tani të japim mendimin e kapedanëve kryesorë të Greqisë në atë kohë. Gjergj Karaiskaqi kishte deklaruar: «Markoja që i shquar! Kishte mendje që s'e kishte asnjë tjetër, kishte zemër luani, gjykim të drejtë. Ne s'ja arrijmë atij as te gishti i vogël».<sup>2</sup> Odhise Andruco, një nga udhëheqësit më popullorë të Revolucionit Grek,<sup>3</sup> e quante Markon vëlla dhe në vitin 1821 kërkoi që Marko Boçari të caktohej kryegjeneral i Greqisë Perëndimore, ndërsa Kollokotroni e quante një njeri që «gjykonte shumë».<sup>4</sup> Në vitin 1872 në Athinë u krijua nga qeveria greke komisioni për vlerësimin e luftëtarëve. Më 13 shtator të po atij viti, komisioni vuri në grupin e përshtatshëm të luftëtarëve për pavarësinë e Greqisë, Kollotronin, Andrucon, Karaiskaqin dhe Marko Boçarin, por këtë të fundit e konsideroi midis të katërve më të zgjedhurin dhe më të panjollshmin.<sup>5</sup>

Jorgji Gaziu na jep disa mendime të Markos, të cilat i quan «Fjalë të urta»; këto janë shprehur prej tij gjatë pyetjeve për çështje të ndryshme.

Kur e pyetën Markon: «Si duhet të jetë gjenerali?», ai që përgjigjur: «Profet me dy kokë, profet për të parashikuar e për të marrë masa që më parë, për ato që i duhen, dhe të njohë gjithashtu qysh më parë mjetet e armikut, forcat e tij dhe lëvizjet.

Me dy kokë për të patur mendje të dyfishtë, për të gjykuar se ç'plane luftime i sjellin atij dobi dhe janë të dëmshme për atë vetë e cilat i sjellin atij dobi dhe dëmtojnë armikun.

1) Jorgji Gaziu, *vep. e cit.*, f. 351.

2) Niku Zhagu, *Markos Boçaris*, f. 181.

3) Philip James Green, esq. *Sketches of the war in Greece*, London, 1827, Lettres, XXIV, Zante 9th December, 1822, f. 125.

4) Niku Zhagu, *Markos Boçaris*, f. 182.

5) *Po aty*, f. 181.

Për fitoren Markoja ishte shprehur kështu: «Katër gjëra e mundin armikun: fati, përvoja, nderi dhe trimëria». Për rolin e nderit në jetë ai thoshte: «Sikundër nëpërmjet karemit zihen peshqit, nëpërmjet nderit bëhen për vete njerëzit e thjeshtë». Kur e pyetën se ç'janë gradat, ai qe përgjigjur: «Rrjeta të politikës». «Ç'janë diplomat-ngacmime të sedrës». Pse shumë ushtarakë i përbuzin politikanët? «Sepse gjaku dhe boja e shkrimit nuk kanë të njëjtën vlerë.» Ndërsa për guximin: ka thënë: «Lepurin e nxjerrin langojtë, kurse njeriun trim e nxjerrin në pah cilësitë e tij të mira». Ky mendim i Markos ishte i lidhur ngushtë me shembullin e tij personal si një udhëheqës me aftësi ushtarake.

«Kur mund të qetësohet dhe të mos interesohet për asgjë njeriu? «Kur nuk i ka pasur mendtë në vend dhe ka mbetur pa to». Këtu nuk ishte fjala vetëm për shqetësimet e jetës, por kryesisht për zhvillimin e progresit njerëzor, ndaj të cilit njeriu i vërtetë nuk duhej të qëndronte kurrë indiferent.

E pyetën: Cilët duan luftën? e ai u përgjigj: «Luftën e domosdoshme e duan edhe njerëzit, edhe perëndia, ndërsa atë të paarsyeshmen nuk e do as edhe vetë djalli». Nga ky mendim shohim se Marko Boçari ka qenë besimtar. Ai besonte te «perëndia e mirë», e cila këtu harmonizohet me të drejtën. Perëndinë të cilën klasat sunduese e kishin shfrytëzuar në dëm të punonjësve, duke ua paraqitur si gogol për t'i mbajtur të mpira në jetë, Markoja nuk e besonte. Lufta e arsyeshme për Markon ishte ajo që bëhej për lirinë e popullit, për pavarësinë kombëtare, për zhdukjen e shtypjes kombëtare dhe shoqërore. A kemi të bëjmë këtu me besimin në kultin e arsyes të predikuar nga iluministët e shekullit XVIII, që drejtohej kundër besimit kishtar të kohës? Ndoshta, por gjë e saktë nuk mund të thuhet për shkak se kur e pyetën: Ç'gjëra dhe ç'mjete e bëjnë njeriun të lumtur?, ai qe përgjigjur: «Arsimi, frika e zotit dhe gjendja e mirë ekonomike».<sup>1</sup> Këtu e shohim Marko Boçarin një rilindës të kohës së vet. Arsimimi i

1) J. Gazis, *vep. e cit.*, f. 350-352.

njerëzve konsiderohej prej tij një mjet për t'u çliruar nga padituria dhe shtypja, mungesa e tij ishte vegël në duart e shfrytëzuesve për t'i mbajtur popujt në padituri e në shtypje. Varfëria ekonomike ishte nëna e shumë fatkeqësive shoqërore e morale prej të cilave njeriu i lirë duhej të ishte i çliruar njëherë e mirë, ndërsa frika ndaj perëndisë, domosdo të mirë, gjykohet prej tij si masë për t'i penguar njerëzit mbi tokë të bëheshin të liq njëri me tjetrin, çka e shëmtonte shoqërinë, e cila megjithëse mbe- tej njerëzore nuk ishte e njerëzishme. Ai nuk mund të kuptonte se si një botë njerëzish mund të jetonte pa një pe- rëndi të mirë. Ky pohim është në kundërshtim me kultin e arsyes së iluministëve dhe me deizmin e tyre, sipas të cilit perëndia e ka krijuar botën, por nuk ndërhyr në punët e saj. Markoja nuk ishte një besimtar fanatik që përjashtonte çdo marrëveshje me arsyen. Mendimi i pe- rëndisë së mirë për punonjësit kishte qarkulluar në rreshtat e luftëtarëve të Revolucionit Francez e të Na- poleonit dhe ai, me siguri, kishte ndikuar edhe te Marko Boçari. Arsyja për ata kishte shpeshherë kuptimin e «bi- jës së perëndisë».<sup>1</sup> Përveç kësaj ky botëkuptim kishte një karakter antiklerikal. Njerëzit e thjeshtë, me përvojën e tyre, e kishin kuptuar se kudo, nën mbulesën e varfë- risë, klerikët e kishin gjetur fshehtësinë për t'u pasuruar, për të marrë pjesë në të gjitha gëzimet dhe kënaqësitë e paligjshme.<sup>2</sup> S'mund të ishte ndryshe për Marko Boça- rin revolucionar.

Të gjitha këto mendime të shprehura prej tij kanë vulën e kohës kur ai jetonte, njëkohësisht bukurinë, çiltër- sinë dhe guximin për një botë më të mirë.

Kështu, në qoftë se do të pranojmë mendimin e Lamartinit se «kryengritja e Greqisë kundër shtypësve të

---

1) Norbert Jonard, Le «Jacobinisme de Foscolo», Etudes sur le XVIII<sup>e</sup> siècle. L'Europe et les Révolutions (1770-1800), Bruxelles, 1980, f. 188.

2) Jean Dierickh, *Réflexions sur la traduction anglaise des ruines et son influence*, «Etudes.....», f. 204.

saj barbarë është një nga shfaqjet më të bukura që u është dhënë njerëzve të sodisin»<sup>1</sup>, duhet pohuar me forcë të madhe se Marko Boçari ka qenë një nga aktorët më të mëdhenj të saj. Është për këtë arsye që Gjergj Karaiskaj, pasi ia dorëzoi Markos luftëtarët e tij që të luftonin bashkë me të në Karpenisi, sepse vetë ai ishte sëmurë; pas pak ditësh shkoi e puthi të vdekurin, mik të tij, dhe deklaroi se edhe ai dëshironte të vdiste si Markoja nga një plumb armik<sup>2</sup>, siç do të ndodhte katër vjet më vonë.

Kështu nuk u gjend asnjë njeri cinik që të shpifte kundër këtij luftëtar që për të gjithë ishte burrë i ndershëm, përfaqësues i një epoke të lavdishme krijuese revolucionare, i paaftë edhe për ligësinë më të vogël në atë periudhë kur në Ballkan shumë shinin.

\*  
\*   \*  
\*

Vdekjes së Marko Boçarit, i cili vendosi më mirë të derdhte gjakun për mbrojtjen e qytetit, të cilin ia kishin besuar, sesa të qante i pikëlluar për rënien e tij në duart e armikut, i bëri jehonë jo vetëm muza shqiptare, siç e vumë re më sipër, por edhe ajo greke. Kjo shpeshherë vë përballë të dy komandantët, atë të ushtrisë osmane dhe atë të kryengritësve, Marko Boçarin; i pari kërkon dorëzimin e të dytit, por ky nuk shqetësohet aspak për të parin:

*Të nënshtroheni dhe unë do t'ju fal,  
Dua që Marko Boçarin të lidhur të ma sillni,  
Që ta dërgoj të gjallë te mbreti në Stamboll.  
Marko kur e dëgjon, përdredh mustaqet,  
Thërret Llambro Bejkon dhe e këshillon veçmas:*

---

1) A. de Lamartine, *Le dernier chant*, vep. e cit., f. 139.

2) Georgiu Ep. Papajani, vep. e cit., f. 37.

Ti Llambro mblidh djemtë, trimat e parë,  
Në mbrëmje do të nisemi, në Karpenisi do të  
shkojmë.

Në Karpenisi qëndroi, lart në Livadhakët,  
Këshillonte trimat, qëndron dhe jep urdhër:  
Që të luftojmë pashan o djem nuk mundemi,  
Veçse në sulm, aq më bën që jemi pak.  
Dyqind dalin menjëherë, me shpatat në dorë,  
Sulm të hidhur bëmë, te çadra e Pashait,  
Një mijë e dyqind premë, përveç të plagosurve.

Markoja goditet në kokë dhe i bën thirrje të vëllait,  
Kostës, ta vazhdojë betejën:

Ku je o Kosta, vëllai im, lufta të mos pushojë,  
Ju sulmiotë të mos më qani, as të visheni me të zeza,  
Se mua më qan Greqia, më qan tërë kombi,  
Shkruani gruas sime, gruas sime fatkeqe,  
Që është në Francë (Itali — K.X.) në qytetin e  
Ankonës.

Të ketë kujdes për djalin, ta dërgojë në shkollë.<sup>1</sup>

Të gjithë ata që bien për lirinë e popujve, bëhen të pavdekshëm, të përjetshëm në kujtesën e tyre. Gaziu shkruan: «Për Markon e tërë Greqia u vesh me të zeza, ndërsa emri i tij mbeti i përjetshëm dhe i denjë për admirim. Turqia e tërë ia kishte frikën, Shqipëria e ndëronte dhe bënte be «për shpatën e Markos», i cili kishte për të bërë çudi, po të rronte gjatë gjithë periudhës së Revolucionit Grek, si Karajskaqi».<sup>2</sup> Deri para vitit 1821 në Greqi ishte bërë një luftë komitësh. Marko Boçari u përpoq ta kthente atë në një luftë të ndërgjegjshme çlirimtare. Betejat që u kryen gjatë luftës për pavarësi, nuk ishin më një vazhdim ngjarjesh të izoluar apo episode të shpërndara, me fitore pa përfundime të qarta dhe vendimtare. Marko Boçari i drejtoi ato drejt një qëllimi të për-

1) *Antologjia e re greke*, Athinë, 1927, f. 92-96.

2) J. Gazis, *vep. e cit.*, f. 350.



caktuar mirë: dëbimit të osmanëve, jo si më parë nga një fshat, nga një mal, nga një krahinë, por nga gjithë vendi.



Tani me të drejtë lind pyetja: Ç'ndodhi me Mustafa pashë Bushatliun dhe me ushtrinë e tij të madhe osmane? Mustafa Pasha e rrethoi Mesolongjin, vë në dukje Aravantinoi, por në ushtrinë e tij ra murtaja, ushqimet filluan t'i mungojnë, ndërsa dimri po afrohej. Si rrjedhojë, ai vendosi ta shpërndajë ushtrinë për të shmangur shfarosjen e plotë të saj. Megjithatë, dihet se kjo ushtri ishte rekrutuar në veri të Shqipërisë dhe s'kishte arsye që të shpërndahej në jug. Atëherë pashai u detyrua të kthehej, duke lënë rrugës në Greqi, në Labëri, në Toskëri dhe në Myzeqe mikrobin e murtajës. Nga Durrësi, më 22 tetor 1823, konsulli austriak Tedeskini lajmëronte eprorët e tij: «Dyshoj se do të ketë infektime të reja meqenëse nuk ekziston asnjë kujdes për marrëdhëniet me Krujën dhe me Tesalinë, territori i së cilës, bashkë me qytetin e Beratit, që prej një viti ndodhen nën pasojat e kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse, megjithëse ajo tani e ka humbur forcën e dikurshme. Nënshtrimi i verbër dhe i vazhdueshëm i këtyre popullsive ndaj fatit, nuk lejojnë që të shpresohet për një zhdukje të plotë të kësaj sëmundjeje, prej së cilës zoti na largoftë».<sup>1</sup> Pra, murtaja ishte në Shqipëri para se të nisej Mustafa Pasha në Greqi. Atëherë si shpjegohet që ai nuk ngulmoi për rrethimin e Mesolongjës? Aq më tepër që qyteti ishte dobësuar së tepërmi. Në këtë mënyrë ai do të kishte rast të justifikonte veten para eprorëve të tij në Stamboll siç kishin bërë pashallarët e tjerë si Omer Vrioni me shokë. Si shpjegohet pra që edhe më pas ai nuk pranoi të dërgonte kontingjente të tjera ushtarake kundër Revolucionit Grek?

1) *AIH, Dokumente austriake*, dosja L-422.

Sulmi i suliotëve dhe i kapedanëve të tyre në Karpenisi e kishte detyruar Mustafa pashë Bushatin të vinte në përfundimin se shtypja e Revolucionit Grek nuk do t'i sillte atij asnjë të mirë. Nga ana tjetër, ushtarët shqiptarë myslimanë në radhët e tij dhe nën komandën e tij nuk kishin treguar dëshirë për të marrë pjesë në shtypjen e revolucionit<sup>1</sup> Gazeta «Kronikat greke», që botohej në Mesolongj, vinte në dukje mungesën e dëshirës së shqiptarëve për të luftuar për Turqinë. Ata dezertonin jo vetëm si individë, por me reparte të tëra «për shkak se ka një urrejtje reciproke të madhe midis shqiptarëve myslimanë dhe turqve»<sup>2</sup>

Kështu që edhe ky fakt ka luajtur rolin e vet në largimin e Mustafa Pashës, Nga ana tjetër, siç vazhdon të na thotë Aravantinoi, ai kishte frikë edhe nga ndonjë sulm i rivalëve të tij në Shqipërinë e atëhershme të Jugut, prandaj nuk kaloi nëpër Janinë. Popullsia shqiptare nuk i dha ushqime për njerëzit e për kafshët dhe për t'i siguruar këto ai humbi shumë ushtarë. Zylyftar Poda ngriti krye kundër Omer Vrionit, po ashtu dhe Ago Myhyrdari. «Me fjalë të tjera shqiptarët janë futur në një luftë civile që është në favor të Greqisë dhe pashai i Shkodrës nuk do të ketë më interes që të bëjë ndonjë udhëtim tjetër deri në Mesolongj».<sup>3</sup> Ai kishte mbetur pa aleatë në ato anë. Arsyeya themelore e gjithë këtyre veprimeve ishte fakti se shqiptarët vuanin nga shtypja osmane kaq sa edhe grekët<sup>4</sup> dhe që të dy këta popuj e urrenin njëllë pushtuesin osman. Por me siguri të gjitha këto, me forcat e shumta që ai kishte, mund të shmangeshin, në qoftë se do të ishte i vendosur ta vazhdonte luftën kundër Kryen-

---

1) Stavri Naçi. *Mbi lëvizjen shqiptare për vetëqeverisje dhe lidhjet e saj me kryengritjen për pavarësi të popullit grek (1821-1829)*, «Studime historike», 3, 1980, f. 113.

2) *Helenika kronika*, nr. 18, AIH, dosja A. III, f. 23.

3) Colonel Leicester Stanhoçe, *Greece in 1823, and 1824, Being A. Series of Letters and other documents on the Greek revolution, written during a visit to that Contry*, London, 1825, f. 57.

4) Dionis Skiotis, *vep. e cit.*, f. 107.

gritjes Greke. Pra, ai ishte nisur nga veriu i Shqipërisë vetëm se kishte qenë i detyruar nga sulltani. Kishte parë se Ali pashë Tepelenës i qe prerë koka pak më shumë se një vit më parë; po të shtypej Revolucioni Grek, çfarë do ta priste Mustafa pashë Bushatlliun? Ai e kuptonte qartë se Porta e Lartë nuk do të hiqte dorë nga lufta për centralizimin e perandorisë dhe nga kjo nuk do të shpëronte as pashallëku i tij as ai vetë. Ishte i vetëdijshëm, gjithashtu, se Porta kishte mbetur krejt e pakënaqur nga puna e tij pa dobi në Greqi. Kjo ishte arsyeja që Mustafa pashë Bushatliu nisi të përhapte në vendin e tij idetë e pavarësisë dhe prirjet kryengritëse kundër shtetit osman.<sup>1</sup> Pas kthimit në Shkodër, mësoi se sulltani kërkonte kokën e tij. Atëherë ai shpalli një qarkore të fshehtë, me të cilën u shpjegonte shqiptarëve shkaqet e vrasjes së kaq trimave shqiptarë. Për pasojë, të gjitha familjet feudale të Shqipërisë së Veriut qenë betuar të mos luftonin më për një monark, i cili kishte vendosur t'i kthente në skllëvër.<sup>2</sup> Dihet se Porta e Lartë, për shkak të çështjes së madhe që i kishte hapur Greqia, tani për tani nuk dëshironte të mbërthehej me armiq të tjerë. Ajo nuk donte t'i shpërdante forcat e saj në disa fronte lufte, kur ato ishin të pamjaftueshme për Greqinë, por i shtynte llogaritë me Mustafa Pashën për më tutje. Këtë gjë bëri edhe me feudatë e tjerë të mëdhenj shqiptarë. Heqja e Mustafa pashë Bushatlliut nga Shkodra dhe, më vonë, masakrat e Manastirit janë të njohura. Në këto masakra luajti rolin e vetë edhe fakti se shumica e kryetarëve myslimanë feudalë të dërguar në Greqi, nuk e kishin ndihmuar qeverinë e sulltanit si duhej dhe sa duhej kundër Revolucionit Grek. Ata qenë larguar prej andej në një formë ose në një tjetër.

Megjithatë, po japim edhe mendimin e Ipenit për këtë problem. Ai vë në dukje se murtaja që kishte rënë në

1) G. G. Gervinus, *vep. e cit.*, vëll. I, f. 581,

2) *Compendio delle storie del risorgimento della Grecia dal 1740 al 1824*, *Compilato da M. P. C. Parte seconda, Italia MDV*, f. 398-399.

trupat osmane, si dhe pakujdesia e komandës ushtarake, e cila i linte këto trupa pa ushqime dhe pa mbrojtje në ashpërsinë e dimrit, e detyruan Mustafa Pashën që të largohej nga Mesolongji së bashku me ushtrinë e tij. Mëgenëse ai nuk gjeti në Shqipërinë e Jugut vend të përshatshëm për të dimëruar, iu desh të shpejtohej e të kthehej në krahinat e tij. Sulltan Mahmuti u zemërua shumë nga ky veprim i vezirit të Shkodrës, ndaj vendosi që ta zhdukte siç kishte bërë pak më parë me vezirin e Janinës, i cili qe bërë pengesë për centralizimin e perandorisë. Përveç kësaj Mustafa Pasha ishte shprehur edhe për autonominë e krahinës së tij, gjë që ishte në kundërshtim me politikën e sulltanit. Mustafa Pasha nuk u nis më kundër Revolucionit Grek. Kur Rusia Cariste i shpalli luftë Turqisë, pesë vjet më vonë, në prill 1828, ai e vonoi nisjen e tij dhe u duk në sheshin e betejës vetëm pas pushtimit të Edrenesë.<sup>1</sup> Vetëkuptohej se në të dy rastet kjo ishte një ndihmë jo e vogël për Revolucionin Grek, prandaj dhe mëria e sulltanit do të shtohej kundër tij. Të gjitha këto vërtetohen nga këto rreshta të Ami Buesë: «Kur sulltani i dha urdhër (Mustafa pashë Bushatliut — K. X.) që të nisej kundër grekëve, u nis me të vërtetë më 1823, por veproi me vonesë shumë të madhe. Sikur Boçari, në vend që të vritej vetë, t'ia arrinte qëllimit të tij dhe ta vriste (pashanë — K.X.) në tendën e tij në luginën e Karpenisit, ai do të kishte zhdukur më tepër një armik të sulltanit».<sup>2</sup> Kjo kuptohet po të kemi parasysh faktin e njohur se shqiptarët, si rregull, megjithëse pjesa dërrmuese i përkiste fesë muhamedane, nuk qenë të lidhur me Portën e Lartë.<sup>3</sup>

1) Teodor Ippen, *Kontribut për historinë e brendshme të Shqipërisë*, AIH, dosja A. III. 28.

2) Ami Boué, *La Turquie d'Europe*, vëll. 4, f. 142.

3) Colonel Leicester Stanhope, *vep. e cit.*, f. 20.

## TAKTIKA

Sulmi i befasishëm i Marko Boçarit kundër ushtrisë së Mustafa pashë Bushatit ka qenë pjesë përbërëse e taktikës së luftës partizane të asaj kohe. Por deri më sot nuk dimë që kleftët në Greqi të kenë bërë një diversion të fuqishëm si ai i Markos dhe të kenë shpartalluar një ushtri të tërë. Sulmet e tyre kundër reparteve të vogla osmane synonin në dëbimin nga një fshat, shumë-shumë nga një krahinë, por jo më tepër. Atëherë ku e ka zanafillën kjo taktikë e Markos? I vetmi personalitet dhe luftëtar anti-osman i shquar e i fuqishëm në Ballkan nga gjysma e dytë e shekullit XV deri në shpërthimin e Revolucionit Grek (1821) dhe që kishte lënë një ndikim të madh shpirtëror në ato vise kishte qenë Skënderbeu. Kjo dëshmohet nga mendimtarë seriozë, që e kanë njohur mirë historinë e Greqisë, të Shqipërisë dhe atë të Ballkanit. Taktika e Skënderbeut ishte ajo e luftës guerile e partizane dhe ushtria e tij përbëhej kryesisht nga reparte të shpejta kalorësish, të armatosur lehtë, që kishin për detyrë ta shqetësonin kundërshtarin me luftime të pandërprera, ta mbanin atë në alarm të vazhdueshëm, t'i ndërprisnin rrugët e furnizimit. Ushtria armike sulmohej papritur dhe në mënyrë të rrafshme. Kjo taktikë e kishte zanafillën te qëndresa e armatosur e fshatarësisë së lirë shqiptare<sup>1</sup>. Ajo duhej plotësuar me një element tjetër, me zbu-

1) Aleks Buda, *Fytyra e Skënderbeut në dritën e studimeve të reja*, «Buletin i Institutit të Shkencave», nr. 3-4, Tiranë, 1951, f. 145-46.



Theodor Kollakotroni me luftëtarët e tij.




Gjergj Karaiskaqi



Odhise Andruco


Shtëpia e Mavrokordatos që shërbente edhe si Shtab i Revolucionit në Mesolongj, më 1922, gjatë rrethimit të parë.





Riga Fereo  
duke ekzekutuar  
hinnin e tij

### Mesolongji








Vrasja e Marko Boçarit



Bajroni nisët për në varrin e  
Marko Boçarit

Busti i Marko Boçarit në Mesolongj.



limin e numrit të forcave të armikut, të armatimeve, ushqimeve dhe pozicioneve të tij, të kontradiktave në kampin kundërshtar etj. Kështu organizimi i zbulimit ishte pjesë përbërëse e asaj taktike.

Një nga heronjtë e Revolucionit Grek, Teodor Kollokotroni, i quajtur edhe «Plaku i Moresë», ka shkruar se librin «Historia e Skënderbeut» e mbante në gji, ndërsa Dora d'Istria theksonte se sapo Skënderbeu mbylli sytë njëherë e përgjithmonë, malet e Shqipërisë e të Greqisë, grykat e Olimpikut dhe të Parnasit, krahinat e larta të Manjës dhe Kseromerit, majat e Valtosit, u mbushën me çeta të pamposhtura, që e godisnin pushtuesin me një këmbëngulje të tmerrshme. «Prandaj Skënderbeu u bë ideali i atyre kleftëve, muza popullore e të cilëve ia ka ngritur kaq lart portretin, sepse çështja e tyre në themel njësohej me atë të atdheut.»<sup>1</sup> Terzeti, nga ishulli grek i detit Jon, Zante ose Zakynthi, vëren: «Fryma e pavarësisë ndihej në këto krahina ku kishte buçitur emri i Skënderbeut. Deri në zgjimin e Greqisë, hija e heroit duket se fluturon mbi ato male, grykat e pangjithshme të të cilave kanë parë të kalojnë një numër të madh brezash kleftësh».<sup>2</sup> Historiani i Revolucionit Grek Joan Filimoni nënvizon se «Mësimet e Skënderbeut mbi luftën popullore i ndoqën me sukses grekët në kryengritjen e fundit.»<sup>3</sup> Prandaj dhe Ilo Mitkë Qafëzezi me të drejtë shkruan se Marko Boçari në Karpenisi përdori taktikën e Skënderbeut kundër turqve: «T'i turret befas natën ushtërisë së Mustafait vet i treqind me planin guximtar, që t'i vriste rojet e Mustafait, të hynte në çadrën e tij, ta vriste atë dhe pasi të bëhej një rrëmujë e madhe, do të vijnë të tjerët që ta mbaronin davanë.»<sup>4</sup> Pra, me një go-

1) Dora d'Istria, *La nationalité hellénique d'après les chants populaires*, «Revue des deux mondes», f. 591.

2) Mme Ad. Terzeti, *La Grèce ancienne et moderne considérée sous l'aspect religieux*, Paris, 1884, f. 119.

3) Jon Filimoni, *vep. e cit.*, f. 19, shënimi 6.

4) Ilo Mitkë Qafëzezi, *Marko Boçari dhe Llesh Ziu i Mirditës*, «Gazeta e Korçës», 4 shkurt 1932, f. 1.

ditje të fortë, Markoja donte të bënte të kotë çdo përpjekje të Mustafa Pashës për të shtënë në dorë Mesolongjin.

Po nga ishin njohur udhëheqësit kryesorë të Revolucionit Grek me historinë e Skënderbeut? Për një histori të Skënderbeut ka shkruar dhe Kollokotroni. Cili ishte ky libër historie? Biografia e parë e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, është botuar greqisht dhe anonime në Moskë, në vitin 1812. Ajo ishte një përkthim i veprës së francezit P. D. Dyponse me titullin «Historia e Skënderbeut, mbret i Shqipërisë,» që doli nga shtypi në Paris në vitin 1709, e bazuar te vepra e Barletit. Ky libër kishte hyrë edhe në Greqi. Nga ana tjetër, kjo vepër u përkthye greqisht edhe nga Andrea Papadhopulli-Vreto, dhe u botua në Napoli në vitin 1820.<sup>1</sup> Përveç kësaj, pas revolucionit u botuan në Greqi pesë biografi, dy tragjedi, një epos dhe një novelë e shkurtër për Skënderbeun. Tragjedia e parë kushtuar Skënderbeut u hartua në gjuhën e re greke në vitin 1818 prej G. Zambellas, poeti nga Lefkada (Santa Maura), por doli nga shtypi vetëm më 1830.<sup>2</sup> Këto botime nuk ishin të rastit, por një domosdoshmëri që do t'i shërbente lëvizjes nacionalçlirimtare të popullit grek.

Gjatë shekujve të shtypjes osmane deri më 1821, çdo lëvizje sado e vogël kundër pushtuesit osman ishte shtypur me terrorin më të egër. Në këto kushte, e vetmja figurë që do të ndihmonte në ringjalljen me një forcë të organizuar të qëndrësës antiosmane ishte figura e Skënderbeut. Kryengritësit grekë panë te figura e tij frymëzimin, për grekët dhe për shqiptarët, që do t'i bashkonte në luftën për liri.<sup>3</sup> Po të shtojmë se edhe në Mesolongji, në periudhën më të vështirë të tij (1824-1826), midis baterive të ndryshme që mbanin emrat e personaliteteve

1) Titos Jochallas, Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia letteraria greca del 19 secolo. Në «Actes du II Congrès international des études du sud-est européen, tome V, Athinë, 1978, f. 56.

2) Titu P. Johalla, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, në historio-grafinë dhe letërsinë e Greqisë së Re; Selanik, 1975, f. 164-65.

3) Po aty.

të mëdha historike, të Greqisë dhe të vendeve të botës, ishte edhe bateria me emrin e Skënderbeut, që sipas francezit Ogyst Fabré, mbrojtësit e qytetit i jepnin meritën gjenisë së fatosit shqiptar,<sup>1</sup> atëherë duhet pohuar se fryma e heroit kishte mbetur me kohë dhe ishte bërë më se e gjallë në ato anë.

Të japim disa mendime të Barletit për taktikën e Skënderbeut, që u përdor prej tij gjatë luftimeve të ndryshme kundër ushtrisë osmane dhe komandantëve të saj. «Kur vuri re mbi të gjitha atë rojen në rrëzë të Malit, u lëshua para të tjerëve, me jo më shumë se 8 kalorës, duke zbritur pa u ndier nga ana e përkundërt dhe disa i vrau në gjumë e sipër, të tjerët atje ku s'e prisnin». «Skënderbeu, duke ndrydhur pa prerë ata që ishin në vijë të parë, po përpiqej me të madhe të gjuante kapedanin e tyre; ai e kishte zakon të thoshte se duhej prerë gjithmonë më parë koka se trupi rrëzohet e zhduket pastaj vetiu.» «Skënderbeu, duke iu kthyer Jakupit dhe duke çarë të gjitha radhët e armiqve, e shpoi atë së pari me heshtë, pastaj i këputi kokën. Barbarët kur panë Jakupin të vdekur, morën të gjithë arratinë dhe u shkoqën duke u vrarë e duke u zënë të gjallë.» Mbreti i Napolit, Ferdinandi i Aragonës, i shkruante Skënderbeut: «Ti o princ Skënderbe... Ke vrarë vetë me dorën tënde duke luftuar mbi tre mijë turq. Unë them o trim i trimave se askush s'ka parë ndonjëherë një njeri më të gatshëm e më të shpejtë se ti në një betejë të stuhishme e të papandehur... Me këto, ti i vetmi në shekullin tonë mund të matesh pa dyshim me tërë lashtësinë», «Skënderbeut nuk i shpëtonte asgjë nga këto sepse në një anë ai kishte zbuluesit, që i shikonin të gjitha dhe ia parashtronin si t'i kishte para syve, në anë tjetër, të arratisurit»<sup>2</sup>.

Taktika e Markos në betejën e Karpënisit ishte e njëjtë me atë të Skënderbeut. Kushtet më të rëndësishme për

1) August Fabre, *Histoire du siège de Missolunghi*, Paris, 1827, f. 280.

2) Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë, 1983, f. 404, 497, 555, 609, 622-623.

zbatimin me sukses të asaj taktike ishin vendosmëria, guximi, trimëria, largpamësia e komandantit. E gjithë kjo ishte e lidhur ngushtë me një kusht tjetër vendimtar: me çështjen e drejtë që mbrohej dhe për të cilën luftohej. Vetëm kështu do të fitohej dashamirësia dhe dashuria e luftëtarëve, njëkohësisht edhe vetmohimi i tyre. Pa këta luftëtarë heroi nuk mund të bënte asgjë, ishin këta pa ishte ai. Të gjitha këto i vëmë re te Skënderbeu e te Marko Boçari, domosdo pa vënë aspak shenjën e barazimit midis tyre. Prandaj nuk është e rastit që Jorgji Gaziu në një epigram kushtuar Marko Boçarit shkruan: «Pirroja u tregua i mrekullueshëm kundër romakëve dhe Skënderbeu përsëri i tmerrshëm kundër turqve. Si ky ishte edhe Marko Boçari.<sup>1</sup>

\*  
\*   \*  
\*

Ali Pasha nuk arriti të bashkëpunonte me Mustafa pashë Bushatllin, për të përballuar bashkarisht politikën centralizuese të Mahmutit II, që do të shpinte në likuidimin e të dy pashallëqeve. Mustafa Pasha u bashkua me qeverinë osmane kundër Ali Pashës dhe mori pjesë në rrethimin e tij. A u përpoq Marko Boçari për një bashkëpunim midis dy pashallëqeve dhe të pashallarëve të mësipërm të Shqipërisë? Në një këngë popullore dëgjojmë:

*Medet për vezir Alinë,  
Që kur s'dëgjoji Boçarinë,  
Të mbliidhej me Bushatllinë,  
Për ta bërë Shqipërinë.  
Marko Boçari i tha:  
— Dëgjomë Ali Pasha,  
Po s'u bëmë me ata,  
Do grihem i lakëra,  
Do këndoje qyqeja.<sup>2</sup>*

1) J. Gazis, *vep. cit.*, f. 350-351.

2) Fatos Mero Rrapaj, *vep. e cit.*, f. 449.

Në qoftë se kjo përçapje e vendosur e Markos pranë Ali Pashës do të vërtetohej historikisht, atëherë biografia e Markos nga pikëpamja e historisë kombëtare shqiptare do të pasurohej edhe me hollësi të tjera, por deri më sot ndonjë dokument i shkruar për këtë çështje nuk është gjetur. Prandaj do të kemi parasysh vetëm logjikën e gjërave. Si çdo anëtar i Heterisë, Markoja i kishte vënë vetes detyrë që të luftonte për të ngritur në këmbë kundër pushtuesit të gjithë popujt e Ballkanit pa dallim feje. Në rastin e Shqipërisë, bashkimi i dy pashallëqeve do t'i shërbente shumë kësaj çështjeje të madhe dhe lirisë së shqiptarëve. Përveç kësaj, pamë edhe ndikimin e Riga Fereosit te Markoja. Rigasi dëshironte të krijonte Federatën Ballkanike në bazë të marrëdhënieve të barabarta midis popujve të gadishullit. Në nenin 3 të kushtetutës së tij theksohej: «Të gjithë njerëzit të krishterë e turq (në këtë rast myslimanë — K. X.) janë të barabartë midis tyre». Në nenin 7 thuhej se «populli sovran përbëhet nga të gjithë banorët e këtij shteti pa dallim feje dhe gjuhe». Për të e vetmja rrugë që çonte në fitoren e sigurt të lirisë ishte ajo nëpërmjet revolucionit të armatosur pa kompromis me armikun. Çdo rrugë tjetër ishte e caktuar të dështonte, çlirimi duhej të ishte vepër e të gjithë popujve të Ballkanit, përfshirë dhe atë turk.<sup>1</sup>

Më sipër kemi vënë në dukje se Markoja ishte partizan i vendosur i këtyre ideve, prandaj bashkimi i dy pashallëqeve të Shqipërisë në luftën e përbashkët çlirimtare vetëm mund të përshëndetej prej tij. Ky bashkim do t'i hapte horizonte të reja vendit sepse ai do t'i dobësonte forcat osmane në Ballkan. Megjithatë, këto elemente, sado të rëndësishme, përbëjnë, siç thamë, vetëm logjikën, e cila pa dokumentin e shkruar historik mbetet një hamendje.

---

1) A. J. Manassis, L'activité et les projets politiques d'un patriote grec dans les Balkans vers la fin du XVIII siècle, «Balkans Studies», volume 3, number one, Thesaloniki, 1962, f. 75-79.

## RILINDASIT SHQIPTARË DHE MARKO BOÇARI

Rilindasit shqiptarë i kanë kushtuar vëmendje të veçantë pjesëmarrjes së shqiptarëve në Revolucionin Grek dhe në radhë të parë Marko Boçarit. Do të marrim më kryesoret prej tyre. Në librin e tij «Studime mbi Shqipërinë dhe shqiptarët», Pashko Vasa shkruan: «Qenë kleftët dhe kapedanët shqiptarë ortodoksë në shërbim të Ali Pashës, që i dhanë Greqisë së re kampionët më trima në luftën për pavarësinë. Boçarët, Karaïskaqët, Xhavellat, Miaulët, Vulgarët e shumë luftëtarë të tjerë, ishin të gjithë shqiptarë që u bashkuan me Greqinë, të udhëhequr në fillim prej shpirtit të tyre luftarak, të uritur për aventura e luftime, dhe pastaj nga ndjenja fetare, që e kishin të përbashkët me grekët. Lufta për pavarësinë e Greqisë nuk mund të kuptohej që në fillim si një luftë kombëtare prej këtyre luftëtarëve të ashpër shqiptarë, por si një luftë thjesht fetare. Ata ishin të krishterë dhe luftuan kundër myslimanëve. Ishte kryqi kundër gjysmëhënës dhe, ndodhi çfarë ka ngjarë te pothuajse të gjithë popujt evropianë, që qytetarët e të njëjtit atdhe u kacafytën me njëri-tjetrin në emër të një feje, që nuk pajtohet aspak me atë që predikohej nga të tjerët».<sup>1</sup>

Pra, sipas Pashko Vasës, ideologjia udhëheqëse e Re-

1) Vasa Effendi, *Études sur l'Albanie et les albanais*, Constantinople, 1879, f. 49-50.

volucionit Grek nuk ka qenë ajo iluministe, e çlirimit kombëtar, por ajo fetare dhe për pasojë, shqiptarët myslimanë e të krishterë në atë revolucion janë vrarë njëri me tjetrin në emër të kuranit apo të ungjillit. Pa mohuar aspak besimin e masës së popullsisë greke dhe të arbëreshëve të Greqisë në fenë ortodokse, këto mendime të rilindësit të shquar shqiptar duhen marrë me rezervë, sepse nuk i përgjigjen plotësisht të vërtetës historike dhe përveç kësaj janë kontradiktore. Njësimi i luftës për pavarësinë e Greqisë dhe i pjesëmarrjes së shqiptarëve atje me luftën fetare të Evropës Perëndimore nuk mund të konsiderohet me vend. Është e vërtetë se në këtë kontinentin evropian në shekullin XVI dhe XVII janë bërë lufta të ashpra midis katolicizmit dhe protestantizmit. E tillë ka qenë ajo në Gjermani midis katolikëve dhe luteranëve, që shpërtheu me rastin e shpalljes së 95 tezave të Luterit më 1517 në Universitetin e Vyrtenbergut. Kjo ishte një luftë klase midis një pjese të klasës sunduese feudale dhe Papës së Romës, që predikonin fenë katolike, nga njëra anë, dhe ideologjisë luterane, fetare, që përfaqësonte interesat ekonomike e politike të byrgërve gjermanë, nga ana tjetër, të cilët përpiqeshin për bashkimin e Gjermanisë në një shtet të vetëm dhe për zhvillimin e kapitalizmit. Në këtë luftë u futën më vonë edhe mjaft feudale gjermanë, që përfaqëuan luteranizmin për të rrëmbyer tokat e kishës katolike. Pashko Vasa nuk e ka fjalën për luftën fshatare në Gjermani, të udhëhequr nga Tomas Mynzeri, as për reformën popullore të përfaqësuar prej këtij. Kjo luftë nuk drejtohej kundër pushtuesit të huaj, ajo bëhej për interesat ekonomike të klasave e të shtresave të ndryshme.

Në qoftë se kemi parasysh se kleftët dhe kapedanët shqiptarë, përfshirë edhe Marko Boçarin, të krishterë, ishin në shërbim të Ali Pashës mysliman, që, nënkuptohet, në themel ishin edukuar me frymën antiosmane, atëherë këtu lidhja fetare mungon krejt. Është fakt se, pavarësisht nga feja, midis shqiptarëve të Greqisë dhe atyre të Shqipërisë ishte përhapur shumë vëllamëria. Atëherë del se lufta midis dy elementëve të kundërt fetarë nuk mund të ishte



e fortë. Më 24 gusht 1823, konsulli francez De Shantel i shkruante qeverisë së tij se «fakti që shqiptarët myslimanë nuk duan të luftojnë kundër grekëve u vërtetua plotësisht».<sup>1</sup>

Është fakt, siç e kemi vënë re më sipër, se tre mijë shqiptarë myslimanë, partizanë të Ali Pashës, luftuan në aleancë me suliotët e krishterë e me grekët kryengritës të Akarnanisë dhe të Etolisë kundër osmanëve; përveç kësaj, pati edhe shumë shqiptarë myslimanë të tjerë që luftuan krah për krah me kryengritësit grekë. Pra, del se të gjithë këta e kishin kuptuar se Kryengritja Greke kishte për qëllim çlirimin e Greqisë. Pas kësaj do t'i vinte radha Shqipërisë. Është fjala për masat më të përparuara të popullit shqiptar, të cilave përvoja historike u kishte mësuar të mos qëndronin indiferentë ndaj luftës së popujve të tjerë dhe jo për feudalët shqiptarë, që ishin të lidhur me interesat ekonomike dhe politike të Perandorisë Osmane. Luftëtarët shqiptarë për lirinë e Greqisë, të dalë nga gjiri i popullit, përfaqësonin botën e madhe liridashëse të shqiptarëve në atë kohë.

Fanariotët dhe koxhabashët e paraqitën luftën për pavarësi para Fuqive të Mëdha të «Lidhjes së Shenjtë» gjoja të udhëhequr nga kisha dhe nga vetë ata. Por të gjitha këto kishin për qëllim që revolucioni të përfundonte vetëm me shpalljen e pavarësisë. A nuk ishin kleftët ata që kishin luftuar kundër feudalëve osmanë pushtues dhe njëherësh kundër koxhabashëve dhe klerikëve të lartë grekë? Kjo luftë, e hapur dhe e fshehur, vazhdoi gjatë gjithë Revolucionit Grek. Ajo nuk kishte karakter fetar, por thjesht nacionalçlirimtar dhe Marko Boçari përfaqësonte këtë karakter të kësaj lufte. Ai kurrë nuk që dëgjuar të fliste seriozisht për karakterin fetar ortodoks të Kryengritjes Greke. Rrallëherë përdorte fjalën «të pabesët» për armiqtë, dhe kjo bëhej me qëllimin e caktuar që

---

1) Cituar nga Stavri Naçi, *Mbi lëvizjen shqiptare për vetëqeverisje dhe lidhjet e saj me kryengritjen për pavarësi të popullit grek. (1821-1829)*, «Studime historike», 1980, f. 101.

të tërhiqeshin me vete masat e luftëtarëve besimtarë suliotë. Ndikimi i Riga Fereosit dhe i Revolucionit Francëz e kishte mësuar ndryshe atë. Shoku Enver Hoxha ka shkruar: «Kapedanët shqiptarë të Revolucionit Grek të vitit 1821, që luftonin nën komandën e Ipsilantit, populli grek i cilëson «arvanitës penemeni e palikaria arvanitias»<sup>1</sup>. Kapo d'Istria dhe carët rusë, kralët serbë e vojvodët moldavë e tradhtuan Revolucionin Grek, por arvanitasit me Marko Boçarin në krye e me Ali Pashë Tepelenën dhe me Çaparajt, i qëndruan deri në vdekje besnik atij»<sup>2</sup>.

Marko Boçari gëzonte respektin dhe nderimin e shqiptarëve myslimanë, madje edhe të feudalëve shqiptarë, që luftonin në radhët e ushtrisë osmane, falë karakterit burrëror dhe famës së tij si luftëtar antiosman. Kosta Biri vëren se shqiptarët muhamedanë dhe të krishterë në Kryengritjen Greke e konsideronin veten shumë afër njëri-tjetrit. Ai shkruan: «Nëse toskët në shërbim të turqve tregonin një simpati të tillë për grekët në përgjithësi, për krerët e Greqisë me origjinë shqiptare ushqenin një admirim të vërtetë. I konsideronin të tyret dhe mburreshin me vlerën e tyre luftarake... Kur pas rënies së Mesolongjit (1826 — K.X.) ushtarët e Ibrahimit (Ibrahim pashë Egjiptit — K.X.) hapën varret e heronjve që kishin rënë për mbrojtjen e tij dhe i plaçkitën, toskët muhamedanë arritën të varri i Markos dhe i ndaluan. Ata mblodhën pjesët e trupit të nderuar të suliotit, i varrosën përsëri me respekt dhe kryetari i tyre Mustafa Beu foli mbi varrin me fjalë shumë prekëse, duke përfunduar me këtë epilog: «Oh, more Marko, të isha trim si ti, por të mos kisha besën tënde»<sup>3</sup>.

Rilindësit shqiptarë, të dhënë pas dëshirës që ta shikonin atdheun e tyre të pavarur dhe në një radhë me vendet më të përparuara të Evropës, bënë të gjitha përpjek-

1) Arvanitë të lavdishëm, shqiptarë trima.

2) Enver Hoxha, *Fjala para zgjedhësve*, nëntor, 1982, Tiranë, 1982, f. 36.

3) Kosta Biri, *vep. cit.*, f. 94.

jet që kombin e tyre dhe historinë e tij t'i lartësonin para opinionit publik përparimtar ndërkombëtar e liridashës, por edhe para Fuqive të Mëdha të Evropës. Në këtë kuadër ata nuk mungonin të vinin në dukje para opinionit botëror figurat e mëdha historike të popullit shqiptar, përfshirë këtu edhe disa nga ata që i kishin shërbyer Perandorisë Osmane. Dihet se shumë vezirë të mëdhenj, madje shumë të shquar, si Qyprilinjë, kanë qenë shqiptarë. Është fakt i njohur se ata nuk kanë qenë aspak faktorë përparimi për Shqipërinë. Ata nuk bënë asgjë për zhvillimin e ndjenjave kombëtare shqiptare. Por, pavarësisht se i shërbenin shtetit osman, ata nuk e mohuan emrin shqiptar. Ky fakt ka qenë i njohur edhe nga studiues të huaj. Rëne Pinoni shprehet kështu: «Shqipëria ka nxjerrë burra shteti dhe gjeneralë të mëdhenj, ajo nuk i ka dhënë shenjtorë apo dëshmorë asnjë feje».<sup>1</sup> Po ky autor vlerëson aftësitë e Qyprilinjve dhe të Mehmet Aliut të Egjiptit. «Shqiptari qeveris Perandorinë (Osmane — K.X.) në shekullin XVIII, i rijep shkëlqimin e fitores me dinastinë e vezirëve të mëdhenj Qyprilinj... me Mehmet Aliun ai i dha energji Egjiptit».<sup>2</sup> Në poemën «Dëshir e vërtetë e Shqiptarëve», Naim Frashëri shkruante:

*Si mjer'ay njeri që ndih' armiqt e Mëmëdhesë  
Oh! Sa punuanë kështu burra, trima me besë!  
Cilët s'kursyen jetënë, ja falën kot Turqisë!  
Oh! Ishin gjithë Qyprilinj, fëmij' e Shqipërisë!<sup>3</sup>*

Pra kemi këtë ide: përderisa shqiptarët i kanë dhënë njerëz të shquar Perandorisë Osmane, këtej e tutje, kudo që të jenë të bashkohen për të mirën e vendit të tyre, në kundërshtim me mendimet e shovinistëve që ngulin këmbë se shqiptarët janë të paaftë të vetqeverisen. Atdhetarët shqiptarë dëshironin t'i tregonin botës që «Kombi Shqip-

1) René Pinon, *L'Europe et la Jeune Turquie*, Paris, 1913, f. 303.

2) *Po aty*, f. 304.

3) Naim Frashëri, *Dëshir' e vërtetë e Shqiptarëve*, vepra II, Prishtinë, 1978, f. 63.

tar është i zoti të qeverisë vetë dhe meriton shortët e një shteti të qytetëruar». <sup>1</sup>

I ndryshëm ishte qëndrimi i rilindësve tanë ndaj shqiptarëve të mëdhenj që kishin luftuar për vendin e tyre, por edhe për vendet e tjera. Dihet se si ata e lartësuuan me të drejtë figurën e Skënderbeut duke i dhënë asaj vendin e merituar dhe duke treguar se një popull nga gjiri i të cilit ka dalë një fatos i tillë, meriton të jetojë plotësisht i lirë.

Kështu qëndronte puna edhe për Marko Boçarin. Ai ishte një luftëtar shqiptar nga Suli, vatra e pushuar e qëndresës kundër osmanëve. Ai kishte bërë gjithçka që të lidhej sa më ngushtë me Ali Pashën dhe të ngrinte shqiptarët për liri. Në qoftë se ai e kishte dhënë jetën për Revolucionin Grek, si një bazë çlirimtare në Ballkan, kurrë nuk e kishte lënë mënjanë Sulin, që për të ishte atdheu i tij, Shqipëria. Marko Boçari nuk ishte figurë lokale, por kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai kishte rënë për vëllazërimin e popujve, dhe kjo ishte dëshira e pushuar e rilindësve tanë. Naim Frashëri shkruante:

*Në thoni pra si fqinj, në mes tënë të rrojmë,  
Në paqen të sosur, në vëllazëri të shkojmë,  
Fort na pëlqen kjo mendje, e mir'edh'e dëshëruar,  
Të rrojmë pors i fqinj, si miq'e të gëzuar.* <sup>2</sup>

Naim Frashëri respekton të drejtat e kombeve të tjera duke i kërkuar këto edhe për kombin e vet.

*Siç është i vyerë për ju emri grek, i ndjerë  
Ashtu edhe emri «Shqiptar» është për ne m'i vlerë!» <sup>3</sup>*

Pra, çdo popull ka krenarinë e vet kombëtare pavarësisht nga numri i banorëve të tij. Kjo është arsyeja pse

---

1) «Atdheu», Konstancë, 8 shkurt 1913, nr. 3, artikulli *Simpatia e Shqipërisë*.

2) Naim Frashëri, *vep. e cit.*, f. 2.

3) *Po aty*, f. 155.

shpërthen me hov që heronjve t'u jepet e drejta dhe merita, në radhë të parë Marko Boçarit. Në «Parajsa», ai shkruan:

*S'ish shqiptarë Marko Suli?*

*Xhavela e Miauli ?*

*Bubulina dhe Kanari?*

*Shqiptar bir shqiptari.<sup>1</sup>*

Naimi si demokrat revolucionar mban qëndrim internacionalist ndaj trajtimit të çështjes kombëtare në Ballkan. Personaliteti i Marko Boçarit por edhe i shqiptarëve të tjerë, lufta e tyre për fitoren e Revolucionit Grek, duhet të jenë, sipas mendimit të tij, elementë stimulues në forcimin e miqësisë midis popullit shqiptar dhe atij grek në bazë të respektit reciprok. Tërthorazi ai e konsideron Marko Boçarin si njërin nga përfaqësuesit e zgjidhjes demokratike të asaj çështjeje.

Sami Frashëri i ka bërë këtë karakteristikë Marko Boçarit: «Marko Boçari ka qenë një nga pjesëmarrësit kryesorë të kryengritjes (greke — K.X.), që përfundoi me fitoren e pavarësisë së Greqisë. Ai ka lindur më 1789 në krahinën Suli të Shqipërisë (vepra është botuar më 1896 — K.X.). Është i kombësisë shqiptare dhe njëri nga njerëzit e Ali pashë Tepelenës. Pas ekzekutimit të këtij të fundit, ai mori pjesë në kryengritje bashkë me shokë të tij. Më 1823 u rrethua nga ushtria turke në Mesolongj dhe në sulmin që bëri bashkë me 240 veta, u plagos dhe vdiq të nesërmen».<sup>2</sup> Në një vend tjetër të po kësaj vepre ai flet për kontributin shqiptar në Revolucionin Grek dhe vë në dukje se nga luftëtarët më të shquar ishin Marko Boçari dhe disa të tjerë.<sup>3</sup>

Pra, për Sami Frashërin Markoja është bashkëpunëtori

---

1) Naim Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, vëll. I, Tiranë, 1980, f. 224-225.

2) Sami Frashëri, *Kamus-ul-Alam*, vëll. 2, f. 1368.

3) Sami Frashëri, *vep. e cit.*, vëll. I, f. 143.

i ngushtë i Ali pashë Tepelenës në luftën e tij antiosmane; këtë luftë, ai nuk e ndërpreu. Pas vdekjes së tij u bashkua me Revolucionin Grek dhe u flijua për të. Në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit atdhetarët shqiptarë krenoheshin përpara Fuqive të Mëdha me emrin e Markos, të cilin e radhitnin krah për krah me atë të Skënderbeut. Në memorandumun dërguar më 13 qershor 1878 Kongresit të Berlinit nga Dega e Lidhjes së Shkodrës, midis të tjerash, theksohej: «Shqiptarët kanë patur karakterin e tyre kombëtar, traditat dhe gjuhën e tyre, historia e shqiptarëve nga Skënderbeu deri te Marko Boçari është e lavdishme.<sup>1</sup>

Edhe Jani Vreto i ka kushtuar vëmendje të posaçme Marko Boçarit dhe shqiptarëve të tjerë në luftën për pavarësinë e Greqisë. Ai e trajton këtë problem në shumë vepra të tij. Në «Apologjia» thotë: «Është raca shqiptare ajo që lindi heroin e patrembur Marko Boçarin».<sup>2</sup> Ai është i mendimit, dhe me të drejtë, se shqiptarët në atë luftë nuk e kishin mohuar kurrë kombësinë e tyre. Duke iu përgjigjur një artikulli të shkruar nga një autor me qëndrim antishqiptar, ai shkruante i dëshpëruar: «Sikur ndonjë grek t'u thoshte shqiptarëve që luftonin e bëheshin fli gjatë Kryengritjes Greke të vitit 1321... ato që na thotë tani ky neve, bijve dhe vëllezërve shqiptarë, a nuk kishite për t'u rënë nga dora pushka dhe a nuk do t'i vinin gishtin kokës për punët që bënin?»<sup>3</sup> Ai nguli këmbë se nuk mund të shkëputen nga lëvizja çlirimtare greke shqiptarët, si: Marko Boçari, Andrea Miauli, Bubulina, Kostë Malëshova, Haxhimihali nga fshati Lipivan i Përmetit dhe të tjerë heronj pa lënë mënjanë dhe vetë Ali pashë Tepeleenën.<sup>4</sup>

---

1) Cituar nga Vico Montegazza, *Albania*, Roma, 1912, f. 45-46; Peter Barll, *Muslimanët shqiptarë në kohën e lëvizjes për pavarësinë kombëtare (1878-1912)*, Wiesbaden, 1968, f. 118.

2) Jani Vreto, *vepra të zgjedhura, mbledhur dhe përgatitur nga A. Uçi*. Tiranë, 1973, f. 223.

3) *Po aty*, f. 228.

4) *Po aty*, f. 216.

Për Jani Vreton, Marko Boçari, mbeti në historinë e popullit shqiptar dhe të atij grek, «Marko burri».<sup>1</sup>

Jo më pak krenoheshin me Marko Boçarin edhe arbëreshët e Italisë. Ai u kujtonte atyre Skënderbeun, sepse që të dy ishin të të njëjtit brumë. Shkrimtari arbëresh Odoaldo Valio jep shkaqet e ngjashmërisë së dy fatosave. «Marko Boçari është hero shqiptar i kohërave të reja, i cili me mendimet e tij, me veprat e shkencën e tij strategjike, dhe me ndërmarrjet e mëdha, rikujtoi në mos ri-prodhoi pikë për pikë burimin e lavdishëm të paraardhësit të tij shumëshekullor, Gjergj Kastriotit, që njihet më shumë me emrin Skënderbeu, ose siç quhet zakonisht ndryshe «Heroi i Madh».<sup>2</sup> Ndërsa poeti arbëresh dhe luftëtari i shquar garibaldin, Vinçenco Stratigo, ngazëllehej me Marko Boçarin në poemën e tij «Unë jam shqiptar»:

*Nuk jam i pasur, e përbuz paranë  
Dhe shpatën e Boçarit e kam pranë,  
Boçari, nderi i vendit tim krenar,  
Unë jam shqiptar.<sup>3</sup>*

Kështu për rilindësit shqiptarë, heroi suliot nuk është vetëm pjesë përbërëse e historisë së Greqisë po edhe e asaj të Shqipërisë. Ai është edhe një figurë e shquar e historisë së përgjithshme, që njëkohësisht u nderua dhe u këndua nga shumë poetë të mëdhenj gjenialë.

---

1) *Po aty*, f. 348.

2) *Ili i arbëreshëve*, janar 1896, f. 38-39.

3) «*Parliamo di Lungro*», Corigliano Calabro, 1963, f. 62.

## POETË TË MËDHENJ PËR MARKO BOÇARIN

VILHELM MYLERI, poeti lirik romantik gjerman lindi në Desau (në Gjermaninë Lindore, Prusi) më 7 tetor 1794 dhe vdiq tridhjetë e tre vjeç më 30 shtator 1827. Vepra kryesore e tij dhe që na intereson këtu është «Këngët e grekëve».

Ai është një nga përfaqësuesit e intelektualëve gjermanë të përparuar të asaj periudhe, kundërshtar i rreptë i regjimit në fuqi. Në vitin 1813, në prag të betejës së Lajpcigut kundër ushtrisë së Napoleonit dhe para asaj të Vaterlosë, mbreti i Prusisë Fridrih-Vilhelmi III kishte premtuar vendosjen e kushtetutës, por pas fitores premtimi u harrua. Përçarja dhe copëzimi i vendit mbetën ashtu si dhe më parë, regjimi absolut gjithashtu.

Iluminizmi dhe Revolucioni Francez (1789-1794) si dhe idhtarët e tyre në Gjermani dhe në Austri u shpallën jashtë ligjit si armiq të betuar.

Në moshën 19-vjeçare (1813) Vilhelm Myleri kishte marrë pjesë në luftën e popullit gjerman për liri (si luftëtar me armë në betejat e Lycenit, Baukenit, Hanaut, Kulmit duke e shoqëruar ushtrinë prusiane deri në kufijtë e Vendeve të Ulëta) kundër ushtrisë së Napoleonit, por tani një shtypje e re kishte zëvendësuar të parën. Grekët a nuk ishin ngritur për fitoren e lirisë së tyre nga një shtypje edhe më poshtëruese, më 1821?

Në përkrahje të Revolucionit Grek rryma të ndryshme



u krijuan në Gjermani. Disa intelektualë mendonin se grekët duheshin mbrojtur për shkaqe fetare, sepse feja ortodokse e tyre nuk ishte shumë larg asaj protestane, të tjerë, shumë të dhënë ndaj historisë dhe kulturës së lashtë helene, ishin të mendimit se këto të fundit do të përtëriheshin dhe më me vrull me fitoren e pavarësisë. Të fundit, luftëtarët për të drejtat demokratike të njeriut, ishin të bindur se fitorja e Revolucionit Grek do të ndikonte drejtpërsëdrejti në tokën gjermane dhe austriake.<sup>1</sup> Vilhelm Myleri i përkiste kësaj rryme.

Himnet që ai i ngriti Revolucionit Grek dhe disa udhëheqësve kryesorë luftëtarë të tij, ku fjala liri valëvitej në çdo varg, priteshin në Gjermani nga revolucionarët si një jehonë që do të kontribuonte edhe në atdheun e tyre. Për Mylerin ishte e qartë se popujt më të zhvilluar po ecnin me të shpejtë drejt lirisë dhe kjo lëvizje e tyre ndikonte pozitivisht edhe në atdheun e tij. Derisa Revolucionit Grek kishte nxjerrë Boçar, Bubulinë, Kanar e të tjerë, pse të mos ndodhte kështu edhe për Gjermaninë? Myleri dëshironte me ngulm që tingulli i këngëve të tij të ushtonte edhe në Gjermani.

Që në vitin 1812, kur ishte regjistruar në kursin e filozofisë në Berlin, ai kishte filluar të studionte lashtësinë greke duke filluar me veprat e njohura të Homerit. Megjithatë, nuk qe lashtësia greke që e bëri atë revolucionar, por në radhë të parë politika. Sa e donte atdheun e tij, aq i urrente ai ata që e shtypin.

Në pamundësi të luftonte me armë në Greqi, ai rrëmbëu pendën si një shpatë me disa presa.

Tetë prej këngëve të veprës së tij të mësipërme, midis të cilave edhe «Hidrioti i vogël», dolën nga botimi në mars 1822; në nëntor, shtatë të tjera përfshirë «Boçarin». Më 4 janar 1823 Myleri i dërgoi botuesit Brokhauz në Lajpcig tetë këngë të tjera, përfshirë «Hidra», «Bubulina», «Suliotja». Më 4 dhjetor ai çoi për botim poezinë «Marko Boçari» që u botua në prill 1824 në vëllimin «Këngë të

1) Gaston Caminade, *Les Chants des Grecs et le philhellénisme de Wilhem Müller*, Paris, 1913, f. 2-3.

reja të grekëve». Në këtë vëllim përfshihet edhe poezia kushtuar arbëreshit Kostandin Kanari nga ishulli grek Psara. Më 1826 ai shkroi një cikël poezish me titullin e përbashkët «Mesolongji». Një vit më vonë Myleri vdiq pa mundur të botojë vëllimin me veprat e tij të plota. Kjo u realizua tre vjet më vonë.<sup>1</sup> Të tëra ato shquhen për energjinë e stilit, për mënyrën dinamike të tregimit, siç ishin vetë luftëtarët për të cilët ai shkruante.

Të gjitha figurat e Mylerit janë lidhur me historinë e vendit ku ata kanë lindur dhe për të cilin ata bëhen fli. «Suliotja», ishte gruaja e Sulit, pasardhësja e bashkëshortes së Xhavellës, e cila i njuh mirë të gjitha dhiaret e qoshet e Sulit. Ajo është e lehtë si sorkadhja dhe e gatshme të luftojë si luanshë krah për krah me burrin. Ky e ka për mburrje ta lërë në shtëpi, por ajo turpërohet po të mos i qëndrojë atij pranë. «Suliotja» është pikërisht ajo që përshkruan Pukëvili: «Shpirti popullor ishte kaq luftarak, sa edhe vetë gratë, në ditët e rrezikut, ndanin entuziazmin e përgjithshëm dhe luftonin shpeshherë pranë bashkëshortëve, vëllezërve dhe fëmijëve të tyre.»<sup>2</sup> Poema «Plaku i Hidrës» simbolizon pasionin për liri të luftëtarit që nuk pranon të vdesë pa e parë atdheun të çliruar, ndërsa «Hidrioti i vogël» përfaqëson edukatën e rreptë që arbëreshët e Hidrës u japin fëmijëve të tyre për të përballuar rreziqet e detit në luftën për të jetuar dhe për liri. Myleri, si edhe Bajroni, kishte ardhur në përfundimin se Revolucioni Grek mund të dilte fitimtar vetëm duke bashkuar forcat tokësore me ato detare. Ka pak të ngjarë që Myleri të ketë arritur në këtë përfundim, duke u mbështetur në përvojën e luftës së anglezëve kundër Napoleonit, sepse pothuajse vetëm në Vaterlo ushtria angleze mori pjesë në betejë tokësore. Në rastet e tjera qeveria e Anglisë kishte furnizuar koalicionet feudale vetëm financiarisht. Si njohës i mirë i historisë së Evropës Perëndimore, ai ka parasysh luftën e Vendeve të Ulëta në gjysmën e dytë të shek. XVI dhe në fillim të shek. XVII kundër push-

1) Gaston Caminade, *vep. e cit.*, f. 19.

2) Cituar nga Gaston Caminade, *vep. e cit.*, f. 45.

tuesve spanjollë kur «gëzët» e detit u bashkuan me ata të pyllit. Fitorja çoi, siç dihet, në formimin e Republikës së Provincave të Bashkuara (Holandës) dhe vetëm kaq. Po me siguri në atë përfundim të Mylerit kanë patur rëndësi jo të vogël edhe luftërat greko-prusiane në lashtësi. Betejat e Salaminës dhe të Mikales vendosën njëherë e mirë për fitoren e grekëve. Myleri e njihte mirë Herodotin. U duhej bërë thirrje ngjarjeve të kaluara, fatosave të vdekur, Miltiadhëve, Themistoklinjve të djeshëm për t'u dhënë kurajë luftëtarëve të ditës. Kështu vepronin francezët liridashës me Zhanë D'Arkën dhe rilindësit tanë me Pïrron e Skënderbeun. Shumë gjëra në histori përsëriten në kohë, hapësirë dhe rrethana të reja. Greqia e re nuk mund të mjaftohej me kurajën e komitëve dhe të sulotëve. Asaj i duhej edhe guximi i marinarëve, siç ishin në Revolucionin Grek arbëreshët e Hidrës, të Specës dhe të Psaras veriore. Pra, logjika e thjeshtë për Mylerin kërkonte që grekët të luftonin dhe të derdhnin gjakun vetë për lirinë e tyre. Ajo nuk mund të dhurohej prej askujt. Forcat materiale e morale të popullit do të shpinin në formimin e shtetit të pavarur grek.

Myleri i urrente utopitë. Në një letër dërguar një mi-kut të vet, ai i shkruante më 15 dhjetor 1821: «Edhe sikur Rusia t'i shpallë luftë tani Turqisë, ajo do të ishte mjerisht një luftë kundër Portës, jo një luftë për njerëzimin, për Greqinë. As parullat, as deklaratat nuk mund të më verbojnë».<sup>1</sup>

Më 4 janar 1823 Myleri dërgoi për botim bashkë me të tjera poezinë kushtuar Bubulinës. Hidriotët kishin një marinë të shquar, edhe vetë Bubulina ishte hidriote, pronare anijesh. Përveç kësaj ajo ishte grua. Ai e njihte mirë faktin se revolucioni bëhej më i gjerë, më i thellë, në qoftë se në të merrnin pjesë edhe gratë. Gruaja kishte qenë skllavja e parë në historinë e njerëzimit dhe me çlirimin e saj shtypja kombëtare dhe shoqërore do të goditej rëndë.

Marko Boçarit, këtij burri me një karakter të lartë e

---

1) Gaston Caminade, *vep. e cit.*, f. 61-62.

trimëri të rrallë, i këndoi Vilhem Myleri. Ai i kushtoi heroit edhe «Skicën biografike», në të cilën jep disa hollësi, sidomos për betejën e Karpenisit: «Kështu të praruar me kurora dhe buçeta lulësh, të veshur me armët më të bukura, ushtarët u paraqitën pranë kryetarit të tyre për të marrë urdhra. Marko Boçari iu drejtua me këto fjalë: «Të dashur vëllezër dhe shokë armësh!... Në qoftë se ne krahasojmë fuqinë tonë me atë të barbarëve, pa dyshim që jemi pak, por masat e marra prej meje ju lejojnë të mendoni se po ta kemi të pamundur të përballojmë tërë ushtrinë e armiqve, ne jemi në gjendje të sulmojmë dhe të mposhtim disa elementë përbërës të saj. Tani ne jemi të rrethuar dhe nuk na mbetet veçse t'i japim një goditje vendimtare... Atdheu dhe brezi i ardhshëm presin prej nesh një shembull të madh.

Sonte, vëllezër, pikërisht sonte, meqenëse është errësirë, ne do të shpërthejmë në kampin e armiqve pa zbrazur asnjë pushkë. Shpatat dhe thikat do të jenë të vetmet armë me të cilat ne do të përhapim vdekjen, tmerrin, masakrën. Goditja është e guximshme. E kuptoj dhe jam krenar. Secili nga ju të mendohet për rrezikun dhe të vendosë lirisht, sepse unë dua të marr me vete për këtë luftim të bukur vetëm njerëz të denjë për të marrë pjesë.» Të gjithë i dolën përpara dhe thirrën: «Do të të vijmë pas! Perëndia na ndihmoftë!».

Por Boçari përmban zjarrin e tyre dhe i këshillon trimat që të formojnë praparojën. Pararoja turke kishte shtënë në dorë qytetin e Karpenisit dhe e kishte vendosur kampin e vet pranë mureve të tij. Ishte një terren i sheshtë, i rrethuar me vreshta dhe hendeqe. Boçari mbeti disa orë larg këtij kampi dhe filloi marshimin pas perëndimit të diellit. Ai u kishte caktuar kapedanëve të tjerë pozitat e tyre, për aq kohë sa trompeta do të trondiste pushimin e natës... Trimat... filluan marshimin kundër armikut. Ishte mesnatë kur Boçari iu vërsul pararojave turke, ku mbretëronte gjumi. Brenda një ore mbi 500 trupa barbarësh qenë shtrirë mbi tokë. Kampi i turqve u mbush me zhurmë. Gjysmë të zgjuar nga gjumi, barbarët mbërthyen armët. Në hutimin e çasteve të para, osmanët be-

suan se ishin tradhtuar nga shqiptarët e ushtrisë së tyre dhe filloi luftimi brenda kampit, para se grekët të depërtonin.

Kur Boçari dëgjoi të shtënat në gjirin e ushtrisë armike, u tha ushtarëve: «A dëgjoni vëllezër! Perëndia po na i dorëzon të pabesët! Përpara! Ndiqmëni!» Ai marshoi dhe fjalët e tij buçisnin: «Ku janë pashallarët?». Hyri në tendën e të agrid Ago Vasjari. «O xhelat i suliotëve, thirri, nuk do të më shpëtosh!» Dhe pastaj e kapi për mjekre dhe e shpoi me thikë. ... «Ku janë pashallarët?» Këto fjalë oshëtinin përmes kampit. Boçari kishte arritur në tendën e Mustafa Pashës, satelitët e të cilit i kishte vrarë me dorën e vet.»

Pasi tregon se si Marko Boçari u plagos për herë të parë, dhe u largua për pak kohë për të lidhur plagën e vet, ai vazhdon: «Markoja kishte dëgjuar komandantët osmanë të thërrisnin se nuk ishte e vërtetë që kryengritësit gjendeshin brenda në kamp. Atëherë thirri me zërin e tij të kumbueshëm: «Nuk është gabim të pabesë! Marko Boçari ka hyrë në kampin tuaj dhe asnjë nuk do t'i shpëtojë». Trompetat buçitën, turqit u sulën në masë drejt vendit ku zëri i luftëtarit kishte ushtuar. Atëherë një plumb vdekjeprurës e mori Boçarin në kokë. Ai ra në tokë pa ndjenja».<sup>1</sup>

Me këtë shpjegim të vrasjes, që është shumë afër të vërtetës, ndihet fort simpatia e Mylerit për luftën çlirimtare dhe heroin e saj. Përmbajtja e kësaj skice do t'i shërbente atij për dy poemat kushtuar Markos. Këtu do të japim poemën e dytë, në të cilën ai i fton të gjithë luftëtarët e vërtetë të lirisë të mos lëshojnë lot mbi varrin e heroit sepse jehona e veprës së tij do të ushtojë larg e përjetësisht dhe trimat «na mësojnë të vdesim të gëzuar». Heroin e paharruar shqiptar ai e vendos krahas me vullnetarin e shquar gjerman Norman që ra dëshmor si Marko Boçari në Mesolongj. Po e japim të plotë.

1) Cituar nga Gaston Caminade, *Les chants des grecs et le philhellénisme de Wilhelm Muller*, Paris, 1913, f. 93-95.

## Marko Boçari

Mesolongj portat e tua hapi, qyteti i nderuar,  
Ku prehen trimat që na mësojnë si të vdesim të gëzuar,  
Portat e tua të larta hapi dhe varret e thellë  
Hapi! Hidh gjethe dafine nëpër rrugë, ajrin mbush!  
Trupin e Marko Boçarit te ti sjellim. Po kush vallë  
Do të kish guxim të qante për Markon, trimin e rrallë?  
Ç'ti numërosh më parë? Plagët e fitores? Ç'dëshironi?  
Në çdo plagë një fitore. Plaga n'fitore s'mungon.  
Shih mbi çallma se si derdhen heshtat tona nga çdo anë;  
Shih mbi vigun e tij, shih, valviten flamuj osmanë.  
Shih pa shih veprat e fundit, që dor'e burrit ka shkruar!  
Shih Karpenisin ku shpatës, me gjak etjen ia ka shuar!  
Oh! dhe në takim na thirri në orën mynxyrëzezë!  
Xixa na lëshonin sytë, si natën flak'e rrufesë.  
Dhe të ngazëllyer shpatat, mbi gju bërë copë-copë.  
Trupat e majmur osmanë do të kositnin me kosë.  
Dhe në këmbë hijerëndë erdhi dhe shpatën fërkoj,  
«Para mbi çadra barbarësh», zëri Boçarit kumboi.  
«Po më deshët do t'më gjeni te çadr'e pashait turk.  
Ngrihuni me Zotin! se dhe vdekjen me të kush s'e mund!  
Shkojmë! Trumpetën nga dora i rrëmbëu borizanit  
Dhe i fryu vet me forcë. Po pastaj faqja e malit  
Dyfish e rriti më shumë. Dhe larg u përcoll jehona/  
Dhe më fort ajo u ndie në zemrat tona.  
Si rrufe e gjëmim zoti, që u japin reve zjarr  
Natën, shpat' e çlirimtarit ra mbi tiran' e vasal  
Dhe ndonjë dit', gjynafqarin, zëri së drejtës do zgjojë,  
Ndaç dhe në kampin osman, thirrja e tmerrit ushtoi.  
O-ii! Marko Boçari! Suliotët nga na mbinë!  
Një urim i tillë mëngjezi te të përgjumët arrin,  
Zgjojen e brofin në këmbë. Dhe si delet pa çobanë  
Nëpër udhë marrin vrapin, me shoq-shoqin: ç'është, ç'po  
ngjan?

I hutojn, engjëjt e vdekjes që mes tyre uragan  
U derdh në ata përmbys nga tehu i shpatës ranë,  
Si luftuan? Pyet natën, ajo ç'pa, le ta tregojë

Po se ç'ngjau këtë natë, dita a do ta besojë?  
 Në fushën e Karpenisit, njëqind grekër, turq një mijë  
 Korri vdekja, sa agimi i fliste ditës të vijë  
 O, dhe ty atje, të gjetëm Marko Boçar, Marko Boçar.  
 Të njohëm nga shpata jote, nga plagët që pate marrë.  
 Nga plagët që ty të dhanë, nga plagët që hape vetë,  
 Ashtu siç pate premtuar o Marko, trimi me fletë.  
 Mesologj, portat e tua hapi, qytet i nderuar,  
 Ku prehen trimat. Na mësojn' si të vdesim të gëzuar!  
 Hap varret e tu të thellë, hapi të vendosim pranë,  
 Trimave të tu për gjumin e gjatë, edhe trimat tanë!  
 Me gjermanin Kont Norman, fli shkëmb i nderit Boçar,  
 Derisa zemrat e gjyggjit të boshatisin çdo varr.\*1)

**XHON GORDON BAJRONI.** Vdekja e Bajronit në luftën për pavarësinë e Greqisë më 1824 dhe respekti i madh që kishte ai për një nga heronjtë kryesorë të saj, Marko Boçarin, dhe për shqiptarët në përgjithësi, nuk mund të konsiderohet e rastit. Revolucioni industrial që kishte shpërthyer në Angli në shekullin XVIII, që në kohën e Bajronit nuk kishte përfunduar, dhe varfëria e madhe që e shoqëroi atë, e kishte zhgënjyer dhe tërbuar poetin. Vallë kjo pritej nga gjaku i derdhur që në gjysmën e parë të shekullit XVII? Lufta që punëtorët anglezë bënin për ekzistencë a ishte e ligjshme dhe a duhej të mbrohej me patos kundër atyre që i shtypnin me egërsi? A duhej mbrojtur populli irlandez që ngrihej herë pas here kundër lëndlordëve anglezë për autonominë dhe lirinë e tij? Po Revolucioni Spanjoll (1820-1823), lufta e italianëve në vitet 1820-1821 dhe më në fund Revolucioni Grek (1821-1829)? Ka qenë botëkuptimi i tij demokratik-revolucionar burimi themelor i luftës së tij për lirinë e popujve kundër «Lidhjes së Shenjtë», që e bëri atë të përjetshëm. Këtu i ka rrënjët dhe respekti i tij i madh për shqiptarët, për karak-

\*. Shqipëroi Xhevat Beqaraj.

1) Wilhelm Müller, Griechenlieder, Leipzig, 1844, f. 87-89.

terin e tyre burrëror e njerëzor. Megjithëse të prapambetur ekonomikisht, ata ishin të etur për liri dhe të dhënë për të.

*Të rreptë bijt e shqipës! Po vetitë  
Nuk u mungojnë veç t'ishin më të arrira,  
Armiku s'ua pa kurrizin ndonjëherë!*

*Ç'armiq për vdekje, po sa miq besnikë!<sup>1</sup>*

Historia e kishte mësuar Bajronin se dashuria për liri dhe urrejtja për shtypësin e saj shkonin paralelisht. Dy janë shtyllat që e kalitën Bajronin: vetë lufta shoqërore e popujve për liri dhe për një jetë më të mirë, këmbëngulja e tyre drejt lumturisë. Nga ana tjetër, iluminizmi francez i shekullit XVIII dhe pjella e tij Revolucionit i madh. Furtuna e këtij revolucioni nuk kishte kaluar më kot. Parullat e tij «liri, bashkim, vëllazëri» u përhapën kudo, gjaku i derdhur për mbrojtjen e Revolucionit dhe të Republikës kishte vaditur pemën e lirisë, gjithmonë të lulëzuar në vetëdijen e popujve.

Bajroni shkroi për shqiptarët ato që pa, që ndjeu dhe që mendoi. Ai që nga të parët që e bëri të njohur Shqipërinë në botë. Kur erdhi në Greqi për të marrë pjesë në luftën për pavarësi, suliotët do të bëheshin bashkëluftëtarët dhe miqtë e tij më të ngushtë. Ata do ta shoqëronin dhe do ta mbronin nga çdo rrezik.

Pasi kishte arritur në ishullin e Qefalonisë në Greqi, Bajroni shkruante në ditarin e vet të 17 dhjetorit se suliotët kishin simpati për të, ai u kishte dhënë atyre dhe familjeve të tyre gjithë ndihmën që i kishin lejuar rrethanat. Ata dëshëronin që të ishte komandant i tyre; Bajroni do ta pranonte këtë detyrë po të ishte e domosdoshme, sepse «nga të gjithë luftëtarët e këtushëm ata njihen si më të mirët dhe më trimat».<sup>2</sup>

1) Bajron. *Çajld Harold*, Tiranë, 1956, *vep. cit.*, f. 6.

2) *Ditari i Qefalonisë* (28.9 — 17.12.1823), f. 319-320.



Marko Boçari ishte një nga kapedanët më të mëdhenj të suliotëve. Në ditarin e 28 shtatorit ai bën fjalë për letrën që Marko Boçari i kishte shkruar në prag të vrasjes në betejë e sipër: «Dhashë porosi që t'i shkruhej një letër Marko Boçarit, komandantit të reparteve greke në Akarnani, për të cilin kisha letra rekomandimi. Përgjigjja e tij ka qenë me siguri shkrimi i fundit nga ata që nënshkruante apo diktonte, sepse ai u vra në luftë të nesërmen, duke i lënë vetes lavdinë e ushtarit trim dhe të njeriut të ndershëm, gjë që nuk takohen gjithnjë së bashku, madje edhe veç e veç».<sup>1</sup>

Me këto fjalë Bajroni thekson meritat e suliotit të madh. Trimëria dhe ndershmëria të revolucionarët e vërtetë gjithmonë ishin bashkuar dhe në themel të tyre ata kishin drejtësinë e çështjes që mbronin. Morua shkruante për Bajronin: «Ai i dashuronte luftëtarët shqiptarë, i gjen-te ata të thjeshtë e besnikë... Midis tyre në Janinë ai filloi të shkruajë «Çajld Burunin» e tij, i cili u bë pas Këngës së I, «Çajld Haroldi».<sup>2</sup>

Si pothuajse në të gjithë Evropën Perëndimore, edhe në Londër, në fillim të vitit 1823, u krijua Komiteti për mbështetjen e luftës për pavarësinë e Greqisë. Bajroni u zgjodh, pa qenë i pranishëm, anëtar i tij. Komiteti nuk i kuptonte nevojat e Kryengritjes Greke dhe përpiqej të dërgonte atje mësues, tekste shkollore, libra për bujqësi dhe për çështje ushtarake. Në letrën që i dërgonte sekretarit të Komitetit, Xhon Bauringut, më 18 maj 1823 nga Gjenova, Bajroni kërkonte që të dërgohej në Greqi artileri e lehtë, barut, mjekime, armë të tjera, oficerë të mirë, sidomos artilierë, inxhinierë. Në këtë letër Bajroni i vë në dukje Bauringut se Britania e Madhe do të përfi-

1) *Ditari i Qefalonisë* (28.IX-17.XII.1823), po aty, f. 316-317.

2) Andre Maurois, *vep e cit.*, vëll. I, f. 169.

tonte shumë nga fitorja e grekëve, midis dy vendeve do të vendoseshin lidhje tregtare, «sepse unë jam i bindur që qëllimi kryesor i Komitetit është çlirimi i vendit dhe jo dërgimi i disa lloj sendesh të dobishme»<sup>1</sup>. Ai përpiquej t'i mbushte mendjen Komitetit se anglezët interesoheshin për tregti dhe s'kishte arsye që ata të lundronin përtej Oqeanit Atlantik, kur Greqia ishte afër dhe kishte produkte të shumta të konsumit të gjerë, më të lira sesa në kolonitë.<sup>2</sup>

Bajroni kishte vendosur të shkonte në Greqi. «Po të arrij në Greqi, unë do t'i jap çështjes së saj të madhe gjithçka që kam mundësi»<sup>3</sup>. Ai ishte mësuar të jetonte me luftë dhe në Greqi do të flijohej për lirinë. Më 16 korrik 1823 ai u nis me anijen «Herkul» nga Gjenova dhe më 3 gusht arriti në Argostoli, në skelën kryesore të Qefalonisë. Kur kapiteni i anijes gjatë udhëtimit kishte pyetur përse lordi shkonte në Greqi, «në vendin e pleshtave, të mizave dhe të hajdutëve», Bajroni i qe përgjigjur se kjo ishte e vërtetë «për ata që i shikojnë gjërat me syrin e derri-cëve dhe që nuk mund të shikojnë asgjë tjetër»<sup>4</sup>. Ai u informua se udhëheqësit e Revolucionit Grek kishin mosmarrëveshje midis tyre dhe vendosi të priste, sepse nuk dëshironte që të merrte pjesë në njërin apo në tjetrën parti. Qëllimi i udhëtimit të tij ishte që të luftonte krahas popullit grek për liri. Nga ana tjetër, Komiteti i Londrës e porositi që të nisej për në Greqi si përfaqësues i tij pranë qeverisë greke<sup>5</sup>.

Në Qefaloni ai mori në shërbim të tij 40 suliotë, nën komandën e kapedanëve Fotomara, Xhavella dhe Drako. Bajroni u takua edhe me njërin nga udhëheqësit e luftës për pavarësinë e Greqisë, Aleksandër Mavrokordatton, që shoqërohej nga një repart arbëreshësh të ishullit Hidra. Bajroni i dha atij nga pasuria e vet 200 000 piastra, një

1) Bajron, *Ditare e letra*, 1963, f. 306-307.

2) *Po aty*, f. 307.

3) *Po aty*, f. 306.

4) André Maurois, *vep. e cit. vëll. II*, f. 262.

5) *Ditari i Qefalonisë, po aty*, f. 316.

shumë që përbënte dyfishin e asaj që kishte Napoleoni kur filloi fushatën në Itali.<sup>1</sup>

Duhet thënë se për nisjen e Bajronit në Greqi ka luajtur rolin e vet edhe adhurimi që ai kishte për kulturën e lashtë greke. Ai ishte njohur me të jo vetëm në bankat e shkollës, por edhe në librat që kishte lexuar. Bajroni kishte bindjen se qytetërimi modern i detyrohej shumë asaj kulture. Ishte fjala kryesisht për qendrën kryesore të saj, Athinën, dhe për shekullin e Perikliut. Ai dënon rëndë barbarët osmanë që kishin dëmtuar Partenonin e Fidiasit:

*Po më mizor se shpatë e flaga e shekuj  
Që skeptri dhe sundimi i njerëzve  
Që nuk e ndiejnë zjarrin që ka ndezur  
Kujtimi yt në zemrën e qytetërimit<sup>2</sup>.*

Bajroni revoltohej kur e akuzonin popullin grek si mosmirënjohës. «Kujt duhej t'i tregonte mirënjohje populli grek, — shkruante ai, — turqve që e shtypnin, anglezëve që e zhvishnin Akropolin nga kryeveprat, apo francezëve që i jepnin këshilla dhe asnjë ndihmë»<sup>3</sup>.

Për Bajronin, kultura materiale dhe shpirtërore e një vendi ishte pjesë përbërëse e thesarit të kulturës botërore. Ata që e rrëmbenin dhe e grabisnin atë meritonin që të ndëshkoheshin. Bajroni ishte internacionalist i kohës së vet.

*Britania, Mbretëreshë e detit, mori,  
Plaçkën e fundit të vendit të gjakosur*

*Mallkuar ora kur e nisën udhën  
Dhe ta lënduan zemrën e këputur<sup>4</sup>.*

1) *Ditari i Qefalonisë*, f. 319.

2) Bajron, *Çajld Harold*, f. 38.

3) André Maurois, *vep. e cit.*, vëll I. f. 176.

4) Bajron, *Çajld Harold*, f. 41.

Gjatë udhëtimit të tij të parë në Greqi (1809-1811), ai kishte bindjen se populli grek ende nuk ishte pjekur për kryengritjen çlirimtare. Bijtë e Trasibulit:

*Nuk ngrihen, vetëm shajnë,  
Dhe dridhen nga kërbaci i dorës turke*

*Po ngashërojnë për armë e ndihmë të huaj.  
S'guzojnë ta përballin vetm' armikun<sup>1</sup>.*

Ishte një pohim në kundërshtim me faktet historike. Lufta kundër pushtuesit në formën e asaj kleftike, ashtu sikurse kryengritjet, nuk kishte pushuar kurrë në Greqi. Bajroni i kujtonte popullit grek se liria është bijë e vetë popullit.

*Skillevër trashëgimtarë! A nuk' e dini!  
Kush do lirinë, i thyen hallkat vetë.  
Me krahn' e djathtë e farkëton fitoren!  
T'ju a japë frëngu a Moskovi? Jo!  
Ata mund t'i përkulin zullumqartë,  
Por nuk iu ndezin flagën e lirisë!  
Greqi! Me këmbim zotërish nuk shpëton!<sup>2</sup>*

Bajroni i bënte thirrje popullit grek të merrte shembull nga historia e tij e lashtë.

Dëshira për fitoren e lirisë ishte e pamposhtur tek ai. Kjo dëshirë e kishte kthyer atë në një poet të fuqishëm, për të cilin Gëteja do të shkruante: «Unë kurrë nuk kam hasur te asnjë tjetër një fuqi poetike kaq të madhe sa tek ai»<sup>3</sup>, dhe theksonte mprehtësinë e tij për të nuhatur dhe për të kuptuar domosdoshmërinë historike të fitores së lirisë për çdo popull. Pa këtë luftë jeta s'kishte asnjë kuptim për të.

1) Bajron, *Çajld Harold*, f. 57.

2) *Po aty*, f. 58.

3) J. Barbay d'Aureville. *Dictionnaire biographique*, f. 242.

Kjo shpresë e detyroi Bajronin që më 1811 të hartonte poemën «Kënga e kryengritësve grekë», thelbi i së cilës ishte thirrja që koha e lashtë i bënte së resë, që të mos pajtohej me gjendjen e mjeruar:

O Greqi, ngreu!  
Shkëlqimi i lavdisë së lashtë  
Luftëtarët t'i ftonjë në betejë,  
Në ndërmarrjen madhështore.  
Në armë! Në Fitore!

Heronjtë frikën nuk e njohin.  
Le të rrjedhë pas nesh gjaku i tiranëve

Spartë, Spartë, për jetën e re ngrehu nga honi,  
Bëju thirrje për luftën e ashpër  
Banorëve të lirë të Athinës.

Le të ringjallet në zemrat tona  
Dhe të na bashkojë  
Heroi i këngës së pavdekshme  
Spartani Leonidha.  
Ai pranoi betejën e pabarabartë  
Në ngushticën e Termopileve  
Dhe me një grusht njerëzish të lavdishëm  
Atdheun e mbroi<sup>1</sup>.

Populli grek kishte ngritur krye sepse besonte në fitoren e luftës që bënte. Ai do të çlirohej vetë, gjë që nuk përjashtonte edhe ndihmën e vërtetë të luftëtarëve të lirisë. Një luftëtar i tillë ishte Bajroni, i cili kishte ndjekur me kujdes ngjarjet e kryengritjes. Para sulmit vendimtar kundër forcave armike, Marko Boçari e pa të arsyeshme t'i shkruante Bajronit që po përgatitej të nisej në Mesolongj. Ai e dinte mendimin e Bajronit për udhëheqësit e revolucionit dhe grindjet e tyre. Marko Boçari shpresonte se personaliteti i Bajronit do t'u jepte fund. Me të arritur në

1) Xhorxh Gordon Bajron, *Vepra me tri vëllime*, vëll. I, 1973, f. 75.

Qefaloni, poeti luftëtar i dërgoi Marko Boçarit në Mesolongj një letër rekomandimi nga mitropolit i grek, Ignati, në Ankona. Bajroni çoi një njeri për ta takuar Markon dhe për t'ia dhënë letrën. Markoja u gëzua shumë nga kjo letër jo vetëm për nderin personal që i bënte poeti i madh, por kryesisht për mbështetjen e fuqishme që po merrte Revolucionit Grek. Më 12 gusht 1823 ai i rekomandoi Metaksait që si përfaqësues i qeverisë ta ftonte Bajronin. Por prefekti iu përgjigj se nuk mund të priste një njeri kaq të shquar pa autorizimin e qeverisë. Atëherë Markoja vendosi t'i shkruante anglezit Blejker, mikut të Bajronit në Qefaloni, me të cilin kishte pasur letërkëmbim edhe më parë. Në letrën e 14 gushtit thuhej: «Jam entuziazuar shumë nga sa më thoni për mendimin e lordit Bajron ndaj vendit tonë. Këshillat që i dhatë milordit për ta përqendruar vëmendjen e tij mbi Greqinë Perëndimore më shkaktuan një kënaqësi të thellë. Ju jam mirënjohës për përpjekjet tuaja të vazhdueshme për vendin tonë dhe ndiej një gëzim të vërtetë për dashamirësinë që treguat për bashkatdhetarët e mi trimë, për sulmuesit që mikun tuaj pati nderin që t'i zgjedhë në formimin e gardës së vet. Përfitojmë nga këto dëshira të shkëlqesishme të tij për ta bindur që të vijë sa më parë në Mesolongj ku do ta presim me të gjitha nderimet që i takojnë personit të tij. Menjëherë, sa të marr vesh mbërritjen e tij, do ta le ushtrinë dhe do të vrapoj pranë tij bashkë me disa shokë. Të gjitha do të rregullohen shumë shpejt. Turbullirat e Rumelisë janë të kapërcyeshme dhe do të pakësohen së shpejti. E di që i keni marrë vesh ato që po ndodhin këtu. Pashai i Shkodrës kaloi nga Apropotamaja dhe Agrafa drejt Karpenisit. Po shkojmë ta presim. Jemi zotër të pikave më të rëndësishme dhe kam shpresë që armiku do të përballohet»<sup>1</sup>. Kjo letër është shumë e ngrohtë, por njëkohësisht shumë optimiste jo vetëm për besimin që ka në fitoren mbi armikun por edhe për fitoren e Revolucionit.

Pas pak ditësh Marko Boçari vendosi t'i shkruante vetë Bajronit: «Shkëlqesia e juaj është pikërisht njeriu për

1) Sh. A. Ikonomi, *vep. cit.*, f. 147-148.

të cilin kemi nevojë. Asgjë nuk duhet të bëhet pengesë për ardhjen tuaj në këtë vend të Greqisë. Një ushtri e panumërt po na kërcënon... Sonte kam në plan të bëj diçka kundër një trupe... prej shtatë mijë vetash, që janë rreshtuar afër këtij vendi. Pasnesër do të vij të takoj Shkëlqesinë tuaj. Mos u vononi shumë. Ju falenderoj për përshtypjen e mirë që keni për atdhetarët e mi dhe shpresoj se ata do të justifikojnë besimin tuaj. Ju falenderoj për kujdesin, që po tregoni për ta»<sup>1</sup>.

Bajroni e mori vesh lajmin e vdekjes së trimit suljot në Mesolongj dhe në shënimin që kemi përmendur pak më lart foli për tiparet e tij të rralla. Vdekja e Marko Boçarit ia dyfishoi forcat, sepse figurën e Markos dhe atë të arbëreshit Odise Andruco, pjesëmarrës tjetër i shquar i Revolucionit Grek, e kishte parë përherë me admirim<sup>2</sup>. Në ditarin e Qefalonisë ai shkruante:

*Të vdekurit u zgjuan, unë do fle?*

*Lufta zjen kundër tiranëve — Do të përulem?*

*Nuk dremis; gjëmbi shtratin po ma shpon,*

*Ditë për ditë, trompa kumbon në veshin tim*

*Dhe jehona e saj është në zemrën time.*<sup>3</sup>

E njëjta gjë kishte ndodhur edhe me Marko Boçarin, sepse po ajo ide i bashkonte të dy.

Tani, më fort se kurrë, Bajroni besonte se grekët vetëm lufta do t'i çlironte nga skllavëria. Në Qefaloni, kur ai mori pjesë në një mbledhje besimtarësh të organizuar nga një klerik anglez, Bajroni u tha dëgjuesve se e ëma e kishte edukuar fetar, por kishte takuar shumë klerikë që nuk u qëndronin besnikë parimeve që predikonin, se në jetë kishte shumë të këqija dhe shumë njerëz që e kalonin jetën plot mjerim; të gjitha këto nuk pajtoheshin me ekzistencën e perëndisë së mirë. «Ku e kanë fyer ata krijuesin e tyre që trajtohen kaq keq?... Shumë prej tyre

1) Dhionis Kokinos, *vep. cit.*, f. 148.

2) Georgiu Ep. Papajani, *vep. cit.*, f. 14.

3) André Maurois, vëll. II, f. 253.

vuajnë nga dhimbjet e trupit, nga presioni i vazhdueshëm i varfërisë... Janë kredhur në padituri dhe supersticion». Dhe kur doktori në teologji e takoi një ditë dhe iu lut të sillej si i krishterë i mirë, Bajroni iu përgjigj: «Çfarë kërkonti më shumë nga unë, doktor, për të më njohur si një krishter i mirë? Të gjunjëzohem e t'i lutem zotit? Kërkonti tepër nga unë i dashur doktor»<sup>1</sup>. Për Bajronin liria nuk fitohej me lutje. Atij i pëlqente më mirë të ishte në Mesolongj, duke jetuar thjesht si vetë kryengritësit, sesa në Londër duke bërë një jetë vetëm duke ngrënë e duke pirë. «Varfëria është vuajtje, por ndoshta ajo duhet pëlqyer po të krahasohet me dëfrimet absurde të të ashtuquajturave klasa të larta të zhveshura nga zemra dhe ndjenjat njëkohësisht»<sup>2</sup>. Për të, të gjithë ata që i nënshtroheshin pasioneve të ulëta kurrë nuk mund të ishin të denjë për të vendosur për lirinë e të tjerëve, sepse atyre u mungonin dy cilësitë më të mëdha njerëzore: liria dhe ndershmëria.

Bajroni prej kohësh qe ushqyer me urrejtjen për klerikët e lartë, dhe sektet e tyre. «Do të doja më mirë të isha njeri i rëndomtë, sesa njëri nga shtatëdhjetë e dy sektet që çjerrin njëri-tjetrin për hir të dashurisë së perëndisë»<sup>3</sup>. Ai besonte në perëndinë, por jo në fetë, ishte deist volterian dhe deizmi kishte qenë armik i fesë zyrtare të çdo sekti.

Bajroni u nis për në Mesolongj më 28 dhjetor 1823 dhe arriti më 5 janar 1824, disa muaj pas humbjes së Marko Boçarit. Pritja që i bënë qe e papërshkruar. I tërë qyteti buçiste nga të shtënat e topave dhe të pushkëve. Kur kishte hipur në anijen e luftëtarit të shquar arbëresh nga Hidra, Andon Kryeziut, që e solli në Mesolongj, Bajroni kishte puthur drurin e saj. Ekuipazhi mbeti syhapur, por ai ia priti aty për aty: «Nëpërmjet këtij druri ju do të arrini dhe do të përforconi pavarësinë tuaj»<sup>4</sup>. A kishte

1) André Maurois, *vep. e cit.*, vëll. II, f. 268-269, 270.

2) *Po aty*, f. 283.

3) *Po aty*, f. 206.

4) J. Rizo Néroulos, *Histoire de l'inurrection Grecque, Genève*, 1834, f. 482.



parasysh rolin e flotës angleze nga ndonjë sulm i Napoleo-  
nit? Ka mundësi. Por më shumë duhet besuar se ai kishte  
ndër mend luftën e Vendeve të Ulëta në gjysmën e dytë të  
shekullit XVI, kur luftëtarët — gëzë («të leckosurit», siç  
i kishin quajtur me përbuzje pushtuesit), të pyllit dhe të  
defit, me veprime të përbashkëta u kishin dhënë dërrmën  
pushtuesve spanjollë.

Miku i tij, Pietro Gamba, jep shkaku themelor që e  
bëri Bajronin të merrte suliotët në shërbimin e tij. «Tri-  
mëria dhe këmbëngulja me të cilat ata kishin mbrojtur  
shkëmbin e tyre të lindjes, vendimi i tyre fisnik për të  
pëlqyer syrgjynimin në vend të skllavërisë, e kishin bërë  
(Bajronin, — K.X.) të ishte në favor të këtij fisi trim dhe  
fatkeq. Suliotët shquheshin midis luftëtarëve të Rumelisë  
për kurajën, përvojën dhe mbi të gjitha për besnikërinë e  
tyre»<sup>1</sup>. Dhe po aty shton për ta: «Një ndjenjë e vërtetë  
dashurie i bën që të mos e pranojnë emrin e grekëve,  
po të mbajnë vetëm atë të fisit të tyre. Asnjëherë nuk e  
kthejnë vështrimin në drejtim të shkëmbinjve të Sulit që  
ngrihen thikë në retë e kurrë nuk e shqiptojnë emrin e  
atdheut të tyre para se lotët t'u njomin sytë dhe një pshe-  
rëtimë t'u shpëtojnë nga goja»<sup>2</sup>.

Suliotët kishin me të vërtetë një dashuri të madhe  
për atdheun e tyre, Shqipërinë. Për ta, fitorja e Revolu-  
cionit Grek ishte dobësimi i Perandorisë Osmane, dhe si  
pasojë edhe çlirimi i shqiptarëve dhe i gjithë Gadishullit  
Ballkanik. Ata ishin analfabetë, por këtë e kishin mësuar  
nga përvoja luftarake. Kjo ishte arsyeja që ndaj Bajronit  
ushqenin një dashuri të zjarrtë.

Kur Bajroni mbërriti në Mesolongj ishte mbledhur i  
tërë populli. Sapo u ngjit në ndërtesën, ku ishte vendosur  
administrata e qytetit, — thotë Nerulos, — Bajroni bëri  
këtë pyetje: «Ku është vëllai i Leonidhës së sotëm?». Atë-  
herë Kostandin Boçari, vëllai i Markos, i doli përpara dhe

---

1) Pierre Gamba, *Relation de l'expédition de Lord Byron en  
Grèce*, Paris, 1825, f. 28.

2) *Po aty*, f. 273.

Bajroni iu drejtua me këto fjalë: «O njeri i lumtur!.. Ti je vëllai i një heroi, emri i të cilit nuk do të fshihet kurrë prej trashëgimit të shekujve». Dhe pastaj u kthye nga masa e popullit: «Helenë! Ju po shikoni midis jush një anglez, që nuk ka pushuar së studiuar kurrë Greqinë e Lashtë e të mendojë për të renë; një anglez që ka uruar gjithmonë për këtë liri, për të cilën ju po bëni sot kaq përpjekje heroike. Jam mirënjohës për ndjenjat që po më dëshmoni; pas pak kohe, ju do të më shikoni në mes të falangave për të fituar apo për të vdekur me ju».<sup>1</sup> Ai u vendos në një shtëpi të mbrojtur nga suliotët, ku filloi të ushqehet si dhe gjithë luftëtarët e tjerë.<sup>2</sup> Bajroni shpreste se me suliotët dhe vullnetarët e huaj do të krijonte një ushtri të paparë ndonjëherë.

Pas një muaji qeveria greke vendosi që Bajroni të shpallej qytetar grek, t'i jepej atij shpata e luftës dhe qyteti i Mesolongjit ta regjistronte qytetar nderi në librin e vet. Për këtë u përgatit një ceremoni solemne. Ditën e caktuar Bajroni, i veshur me kostum kombëtar, i shoqëruar prej një reparti suliotësh, shkoi në kishë, ku kryepeshkopi i dha shpatën dhe diplomën e qytetarit. Por poeti kërkoi që shpatën ta merrte mbi varrin e Marko Boçarit. Aty për aty kortezhi i tërë, me gjithë masën e popullit, kaluan nga kisha në varrin e Boçarit, i cili që stolitur me mermer të çmuar, me shpenzimet e anglezit të madh.<sup>3</sup> Bajroni nuk kishte harruar se një rol të rëndësishëm për ardhjen e tij në Greqi kishte luajtur këmbëngulja e «Heroit Marko Boçari».<sup>4</sup>

Kryepeshkopi e vendosi shpatën mbi varrin e heroit dhe Bajroni mbajti këtë fjalim në gjuhën greke: «Cili është ai që pushon nën këtë gur? Cili zë madhështor del nga ky varr? Ç'është ky varr prej na buron lumturia e Greqisë? Ç'po them? A nuk është ky varri i Marko Boçarit,

1) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.*, f. 182.

2) André Mauro 13, *vep. e cit.*, vëll. II, f. 277-281.

3) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.*, f. 493.

4) Alphonse de la de Lamartine, *Le dernier chant du pèlerinage de Child en Orient*, A Genève, 1825, f. 145.

*i xdekur para pak muajsh që me një grusht trimash u vër-  
sul mbi radhët e shumta të armiqve të llahtarshëm të  
Greqisë? Si mundem unë të guxoj t'i afrohem këtij vendi  
të shenjtë ku prehet ai, unë që nuk kam as heroizmin, as  
virtytet e tij? Megjithatë, duke prekur këtë varr, unë  
shpresoj se këto flurime do ta flakërojnë gjithnjë zemrën  
time me patriotizëm». Pastaj, duke iu afruar varrit të ci-  
lin e puthi dhe derdhi lot, i tërë populli thirri: «Rroftë lor-  
di Bajron!» «Unë shoh, — shtoi ai, — shpatën dhe diplo-  
mën e këtij heroi dhe të gjithë trimave që më rrethojnë:  
Helenë! Shpresoj të jetoj me ju, të luftoj armikun me ju,  
po të jetë nevoja, — të vdes me ju».<sup>1</sup>*

Bajroni e kishte njohur mirë figurën e heroit shqiptar.  
Ata të dy i lidhte i njëjti ideal. Që të dy kishin qenë të  
bindur se për lirinë e popujve nuk mjaftonin vetëm fjalët,  
sado të bukura të ishin ato, por duheshin vepra, madje  
deri në flijimin e jetës. Këtu e kishte zanafillën admirimi  
i Bajronit për këtë shqiptar të shquar.

Bajroni, revolucionar i madh i çerekut të parë të she-  
kullit XIX, dhe Marko Boçari ishin një në luftën për  
liri. I pari nuk mund të mos admironte të dytin. Bajroni  
shkruante:

*Mbi ujërat e gëzuara të detit të kaltër,  
Mendimi dhe shpirti ynë barabar të lirë,  
A dëftojnë Perandorinë tonë, atdheun tonë?  
Këto janë mbretëritë tona që s'njohin kufij,  
Dhe flamuri ynë tmerrri i lundërtarëve është spektri  
ynë.*

*E stuhishme, e vështirë, e paqëndrueshme,  
Në mundime e paqë është jeta jonë,  
Por e gëzuar është ajo në çdo ndryshim që pëson».<sup>2</sup>*

Ai ishte i bindur se pas fitores, populli grek nuk do të  
lejonte që të vendosej monarkia. Monarkun absolut ai e

1) J. Rizos Néroulos, *vep. e cit.*, f. 484.

2) Harold Spender, *Byron and Greece*, London, 1924, f. 190.

quante tiran dhe përbindësh, që do t'ua shtypte kokën fatosave, që kishin shpëtuar atdheun nga osmanët.<sup>1</sup>

Më 9 prill 1824 kur, megjithëse i sëmurë, po përgatitej për një ekspeditë kundër Lepantit, Bajroni u shtri në shtrat i ndërgjegjshëm se nuk do të ngrihej më. Ai kishte deklaruar pak më parë: «Në goftë se Greqia do të humbasë, unë do të mbulohem nën gërmadhat e saj».<sup>2</sup> Dëshira më e madhe e tij ishte të çlironte Lepantin. Ai kishte mësuar se atje shqiptarët myslimanë në shërbim të ushtrisë osmane nuk shkonin mirë me turqit dhe «shumë gjak ishte derdhur midis trupave evropiane (shqiptare — K.X.) dhe aziatike... Një spiun i ynë na vuri në dijeni se kishte patur bisedë me një kryetar shqiptar të Lepantit dhe se ky i kishte thënë që ushtarët do t'i dorëzoheshin lordit Bajron, me kusht që të mos u prekej jeta dhe t'u paguhej rroga e prapambetur».<sup>3</sup> Beteja fitimtare e Lepantit pritej me ankth nga miqtë e tij në Angli, Hobhaūzi i shkruante: «Kjo fushatë me siguri është më e lavdishmja që një njeri mund të ndërmarrë. Kembel më thoshte dje se ju kishte zili më shumë për atë që po bëni tani, sesa për të gjitha dafinat tuaja sado të bukura që ato të jenë».<sup>4</sup> Por Bajroni nuk e arriti këtë fitore. Vdekja e parakohshme e rrëmbeu. Ai e kuptoi dhe shkroi «Vargjet e fundit drejtuar Greqisë»:

*C'është për mua vendi që ka shpërthyer prangat,  
Për hir të mirësisë dhe laudisë së ardhme?*

*Unë çdo lloj kurore (veç jo dafinash)*

*Jam gati Greqisë t'i blatoj.*

*Të dua! Mos ji me mua e ashpër!*

*Sa më hedh ti shikimin, sikur më vështron me inat,*

*Dhe si një zog para nepërkës laramane*

1) Harold Spender, Byron and Greece, London, 1924, f. 317.

2) Pierre Gamba, Relation de l'expédition, f. 158.

3) Po aty, vep. e cit., f. 159.

4) André Maurois, vep. e cit., f. 305.

*Unë shtangem e vuaj përsëri.*

*Dashuria ime ka një themel që nuk shuhet!*

*Jam i yti dhe s'kam forca veten ta përmbaj.<sup>1</sup>*

Qeveria revolucionare greke, e kryesuar nga arbëreshi hidriot Gjergj Kundurioti, shpalli zinë dhe ceremoninë kombëtare. Përveç kësaj i dërgoi edhe një letër vajzës së tij, Adës, ku, midis të tjerash, thuhej: «Në zinë tënde ti ke shoqe Greqinë, që babai yt i pavdekshëm e dashuronte. Jehonat e qyteteve tona buçasin nga oshëtimat e miqve të Greqisë. Të gjithë kërkojnë me keqardhje mikun, mirëbërësin e Greqisë. Ky pikëllim publik dhe ideja se ti je bija e tij, lavdia e të cilit është përhapur në Argolidë dhe në të gjithë Greqinë, duhet të të ngushëllojë dhimbjen tënde të drejtë. Emri i respektuar i bashkëqytetarit tonë, Bajronit, i helenistit të dashur, është skalitur në zemrat tona me gërma të pashlyeshme, historia e atdheut tonë të rilindur do t'ia transmetojë admirimit të pasardhësve tanë. Ç'dëshirë tjetër më të zjarrtë do të kishte në këtë botë për njerëzit e mëdhenj, të cilët duke jetuar mbi shekullin e tyre, synojnë pavdeksinë?»<sup>2</sup> Bija e tij u shpall vajzë e adoptuar e Greqisë. E tërë popullsia vazhdoi të vishej me të zeza për 20 ditë. Qeveria dha urdhër të bëheshin 36 të shtëna artilerie. sa vjeç kishte rrojtur Bajroni, Qeveria e shpalli Bajronin baba dhe mirënjohës të kombit, sepse ai, duke flijuar veten për Greqinë, e kishte pasuruar atdheun e vet me një emër të madh. Ishte më i madhi anglez, që i kishte shërbyer çështjes së shenjtë të lirisë së popujve me dinjitet dhe vetëmohim. Ashtu sikurse Marko Boçari, që të dy mbetën të pavdekshëm, jo vetëm për historinë e Greqisë, të cilën ata me aftësinë, burrërinë, therrorinë e ndershmërinë e tyre e ndihmuan të transformohej, por edhe për çdo njeri me ndjenja fisnike e përparimtare. Sot monumentet e të dyve gjenden në Mesolongji.

Perandoria Osmane nuk kishte më shpresë të ngrihej

1) Xhorxh Gordon Bajron, *vepra në tri vëllime*, vëll. I, f. 136.

2) Alexandre Soutsos, *Histoire de la révolution grecque, 1829*, f. 323-324.

nga honi ku ishte kredhur. Dy burrat e mëdhenj të rënë për Greqinë, Boçari dhe Bajroni, kishin lënë amanetin se Greqia domosdo do të dilte e përtëritur prej kalvarit disa-shekullor, pavarësisht nga rreziqet e reja që do t'i kapërcente për hir të gjakut të dëshmorëve. Marko Boçari dhe Xhorxh Bajroni kanë qenë dy figurat më të mëdha dhe më të shquara që ranë për çlirimin e Greqisë. Ata ishin me kombësi të ndryshme, por me ideal të përbashkët. Me gjakun e tij Marko Boçari kishte vaditur tokën e mbjellë bimët e së cilës do të mbinin dhe vjelja do të bëhej prej të tjerëve. Asdreni në vitin 1932 e përkujtoi vdekjen e Bajronit në vjershën: «Vdekja e lordit Byron»:

*Fatlum o lord Byron! Me ndjenjat e larta,  
Me vdekjen ti prure ndër vise të shkreta,  
Liri — Perëndeshën me rreze të zjarra,  
Që shpallet e ndritshme jot-vepër sa jeta.<sup>1</sup>*

Dikur koloneli Napie i kishte thënë Bajronit: «Është e vështirë të hysh në Greqi, por shumë më e vështirë të dalësh prej saj».<sup>2</sup> Ai kishte hyrë lehtë, duke dalë i vdekur dhe i lavdishëm. Jeta e tij kishte qenë një oqean në shtrëngatë. Ai kishte rënë për lirinë e një populli, duke u përulur përpara një shqiptari të madh, shembullin e të cilit dëshironte të ndiqte. Më 24 korrik 1823, i kishte shkruar Gëtes: «Po nisem për në Greqi për të parë sa mund të jem qoftë edhe pak i dobishëm për të. Në qoftë se ndonjëherë kam për t'u rikthyer, do t'ju bëj një vizitë në Vajmar dhe do t'ju shpreh nderimin e çiltër të njërit prej shumë miliona njerëzve që ju admirojnë».<sup>3</sup>

Për vendosmërinë e Bajronit që të vdiste për lirinë e çdo populli, sado larg që të ishte, poeti Alfred de Myse, shkruante në vitin 1834:

- 
- 1) «Shqipëria e re», Konstancë, 27 prill 1930.
  - 2) André Maurois, *vep. e cit.*, vëll. II, f. 265.
  - 3) Harold Spender, *vep. e cit.*, f. 242.

Dhjetë vjet kish që përbuzte fam' e lavdi!  
 Me vetminë e tij universin mbushi ai,  
 Dehja e lodhte, therror e bënte atë.  
 I ngopur që nga madhështia njerëzore e çdo gjë,  
 Me këngën e vet që si mjellma vdekjen ndjell  
 Të vdiste donte për atë që lumturi botës i sjell.<sup>1</sup>

Vargje këto të përshtatshme për Bajronin, për të cilin «vetëm revolucioni me siguri, do ta çlirojë botën e vjetër nga çdo ndyrësi».<sup>2</sup>

Tani të vëmë në dukje një ngjarje për të cilën francezi Zhozef d'Eturmel thotë se Bajroni u dëshpërua shumë. Gjatë udhëtimit të tij nëpër Greqi, D'Eturmeli u ndal në ishullin Kulluri, që ishte i banuar nga arbëreshët. Për këtë tregon: «Ai (mikpritësi — K.X.) u tregua interesant sidomos për disa hollësi që më dha për lordin Bajron, në vdekjen e të cilit kishte marrë pjesë dhe që e quante gjithmonë gjeneral. Kishte, na tha, një kopësht me lule dhe kënaqej të kujdesej për të. Një shqiptar erdhi të hynte, mbante një fëmijë të vogël përdore dhe ky ishte pikërisht biri i trimit Marko Boçari. Me siguri, gjenerali do të kishte kënaqësi ta priste, por një shërbyes i tij e shtyu brutalisht fëmijën dhe shoqëruesin, pastaj e goditi këtë të fundit. Por nuk mund të ngrihet dora kundër një shqiptari pa u ndëshkuar. Ai e zbrazi koburen mbi shërbyesin që ra i vdekur. Lordi Bajron u dëshpërua nga kjo ngjarje. Gjatë disa ditëve ai qëndroi i mbyllur».<sup>3</sup> Megjithatë, ai e kuptoi shpejt se faji binte mbi shërbyesin e tij që nuk ishte treguar mikpritës ndaj dy personave, të cilët kishin qenë shumë të njerëzishëm, duke dëshiruar t'i bënë një vizitë miqësore mikut të madh të Marko Boçarit. Bajroni dhe Marko Boçari i kishin rezistuar shtypjes dhe dhunës,

1) Barbier d'Aureville, *Dictionnaire biographique, vep. e cit.*, f. 242.

2) Xhorxh Gordon Bajron, *vepra të zgjedhura*, vëll. 1, f. 26.

3) Le Comte Josef d'Estournel, *Journal d'un voyage en Orient*, tome premier, Paris, 1848, f. 24.

kishin jetuar duke luftuar kundër tyre, kishin vdekur për lirinë e popujve:

VIKTOR HYGOS. Madhështia e Viktor Hygoit qëndron pikërisht në besimin e patundur të progresi shoqëror, të lufta e popullit për ta çuar atë përpara. E mira dhe populli punëtor e luftëtar, për të ishin një. Gjithçka që pengonte zhvillimin drejt lumturisë, shfrytëzimi, bestytnitë, padituria, krimi, prapambetja, tirania duheshin flakur tej me përpjekje të pandërprera; po të ishte e domosdoshmë edhe me goditje të rrufëshme. Për Hygonë, historia, pa popullin, nuk mund të bënte asnjë çap.

Bir i një nëne vandeane dhe i një ati të cilin Revolucioni Francez (1789-1794) e kishte bërë kolonel dhe Napoleoni gjeneral, Hygoi, u gjend para grindjeve të ashpra midis dy prindërve, jo për gjëra të rëndomta por botëkuptimore dhe u bë dishepulli i Revolucionit të madh, veprimtarinë e Konventës të të cilit e shpalli në majë të Himalajeve në veprën «Viti 93». Po ashtu mbrojti edhe revolucionet e shekullit të tij, veprimtarët e tyre të mëdhenj, me fuqinë e burrërinë shpirtërore si burime të frymëzimit të pëndës së tij plot pasion. Dashuria për lirinë kombëtare dhe shoqërore kundër armiqve të saj ndihmoi shumë që ai të bëhej «një artist i pakrahasueshëm», siç e ka përcaktuar Anatol Fransi.<sup>1</sup>

Hygoi ishte nxënës i iluministëve të mëdhenj të shekullit XVIII, Volterit, Rusoit, Dideroit, D'Alamberit e të tjerëve. Ai do t'i kthente sytë nga Revolucioni Grek (1821-1829) dhe njëri nga figurat më të mëdha të tij, Marko Boçarit, «Shqipësi së Sulit». Kësaj figure do t'i kushtonte vëmendjen më të madhe e plot dashuri në disa shkrime të tij. Kjo nuk ishte e rastit, «Lidhja e shenjtë», të cilën ai e ironizonte në vëllimin e dytë të veprës «Të mjerët», nuk kishte mundur ta përballonte atë revolucion siç kishte bërë me ato të Evropës Perëndimore. Për Hygoin Kryengritja Greke për pavarësi nuk ishte lufta vetëm e një populli. Ajo i kapërcente kufijtë e një vendi dhe fi-

1) André Maurois, *Olympio ou la vie de Victor Hugo*, f. 195.



torja do të godiste hidrën ndërkombëtare, duke ndihmuar, shkallë-shkallë, të këputeshin kokat gjakpirëse të saj. Një-rëzit në krye të kësaj kryengritjeje do të ishin edhe pjesë e varrmihësve të botës së vjetër absolutiste në Evropë, në Ballkan e kudo. I tillë për të kishte qenë edhe Marko Boçari që në flijimin e vet, në një betejë të përgjakshme por-fitimtare, kishte shpëtuar Mesolongjin, njërën nga qendrat më të rëndësishme të Kryengritjes Greke.

Hygoi vërente se si heroizmi i Markos dhe figura e tij, e një kalorësi pa frikë e pa njollë, kishte marrë dhenë, Shkrimtarë e gazetarë të shumtë kishin shkruar për të, Bajroni, poeti i dashur i tij kishte vdekur atje në Greqi dhe e kishte admiruar Marko Boçarin, «Leonidhën e ri». Ngjarjet e zhvilluara në territorin e lashtë të Greqisë ai i ndiqte me vëmendje të madhe. Në poezinë «Entuziazmi» (1827) Hygoi do t'u bënte thirrje vullnetarëve francezë të çoheshin sa më parë dhe të ndihmonin popullin grek me armët e tyre.

*Në Greqi! Në Greqi! Gjithëve lamtumirë!  
Shkojmë! Pas gjakut derdhur nga ky vend martir  
Të derdhet më në fund edhe gjak xhelatësh! Shkojmë  
Në Greqi miq! Hakmarrje! Liri! Kushtrim!  
Festja mbi ballin tim! Shpata mbi krahun tim!  
Të nisemi burra! Kuajt të shalojmë!  
Kur nisemi? Sonte! Nesër do të jetë vonë.  
Armë! Kua! Një anije në Tulon!  
Me vete ca nga të vjetrit ushtarë tanë!  
Dhe do të shohim atëherë se si tigrat osmanë  
Këmbëve, si drerët, pa pritur t'ua mbathin.<sup>1</sup>*

Edhe Marko Boçari ishte një vullnetar, por i një brumi të veçantë.

Për herë të parë, me sa dimë deri më sot, Hygoi e ngre lart figurën e suliotit shqiptar në poezitë e tij të përfshira në vëllimin «Motive orientale». Deri më 1829, kur Hygoi ishte vetëm 26 vjeç, kjo vepër ishte botuar

1) Victor Hugo, *Les Orientales*, Paris, 1829, f. 36.

katërmbëdhjetë herë. Një dëshmitar i kohës, Viktor Pavi, shkruante: «Viktori më lexoi «Motive orientale», krejt të padëgjyara... Nuk ka asnjë varg të dobët! Ai të shëmb»,<sup>2</sup> ndërsa Zhyl Zhanen: «Më kot do të kërkonim në të gjithë Evropën një princ, një mbret, një kapiten më të denjë për t'u patur zili ose më të lumtur se Viktor Hygoi».<sup>3</sup> Historia kishte provuar tanimë se princat ose mbretërit e rëndomtë shkonin e vinin, ndërsa artistët e vërtetë të mëdhenj mbeteshin të pashlyer në kujtesën njerëzore.

Që në shkurt të vitit 1829, në parathënien e vëllimit «Motive orientale», Hygoi vinte në dukje me ngulm se ai nuk do të merrte parasysh asnjë kritikë për formën e të shkruarit, por vetëm për përmbajtjen, sepse sipas tij kjo i shërben njeriut, përparimit.

Në «Motive Orientale» janë përfshirë poezi të ndryshme. Në to autori hedh sytë nga Lindja (pjesë përbërëse e së cilës për të është edhe Ballkani), të cilën klasat sunduese të Evropës e shikonin si një krahinë të prapambetur, gjoja pa të kaluar historike e pa kulturë. Hygoi protestonte me forcë kundër këtij denigrimi. Për të, Lindja pret të ringjallet sepse ajo ka një kulturë të pasur dhe të drejtë e qytetarisë. «Lindja, — thotë ai, — do të luajë rolin e vet jo vetëm për letërsinë por edhe për vetë perandoritë».<sup>3</sup> Kështu për Hygonë çdo lëvizje revolucionare në Lindje do të ndikonte pozitivisht në Perëndim dhe anasjelltas: Marko Boçari me zgjuarësinë, ndershmërinë, burrërinë dhe flijimin e vet për një çështje që e konsideronte pjesë të luftës për çlirimin e të gjithë Ballkanit, përfshirë këtu edhe atdheun e vet, përfaqësonte atë ringjallje, apo rilindje të Lindjes.

Për herë të parë Hygoi flet për Marko Bocarin në noemat «Kokat e sarajit». Ai e shkroi këtë poemë fill pas lajmit që u përhap në Evropë për rënien e Mesolongjit (1826) në duart e ushtrisë egjiptiane të Ibrahim Pashës, e mbështetur nga ushtria osmane. «Kokat e varura» në sa-

1) André Maurois; *Olympio ou la vie de Victor Hugo*, 1904, f. 153.

2) André Maurois, *po aty*, f. 158.

3) Victor Hugo, *Les Orientales*, f. 3.

rajin e sulltanit, në qendrën e korrupsionit, të ligësisë dhe të egërsisë, janë të Markos, të Kostandin Kanarit dhe të peshkopit grek, Josifit, që u vra nga armiqtë. Nga gëzimi i kësaj fitoreje sulltani organizoi ahengje e orgji në pallatin e vet por të «Tri kokat» bëjnë thirrje për vazhdimin e qëndresës. Marko Boçari zgjohet nga gjumi në të ftohtit e përjetshëm dhe dëgjon lajmin e kobshëm të dështimit në Mesolongj. Luftëtarët e ftojnë që të ngrihet nga varri dhe t'i shpëtojë.

*Mes qytetarësh pllakosur dëgjoj*

*Klithmë zërash: O hije Boçarit mbroi  
nga kjo kordhë robërish, grekët e pafat.<sup>2</sup>*

Si për Hygoin e gjallë ashtu edhe për Marko Boçarin e vdekur të gjithë ata që ndihmojnë pushtuesin kundër lirisë së një populli nuk janë veçse xhelatë të rëndomtë. Në varr Markoja kujton të vëllanë, Kosta trimin, suliotin Kiço Xhavella «që aq shumë e donte Bajroni, poeti i pavdekshëm». Markoja mallkonte të vrrarët osmanë në Mesolongj, «Bijtë e mallkuar të shejtanit», «skllevërit që luftojnë për të plotësuar tekat e sulltanit»; «Koka e tigrin perandorak» nuk është e kurorëzuar me dafina, po me kokat e gjakosura të mbrojtësve heroikë të Mesolongjit dhe për këtë, ky sulltan ishte fodull dhe arrogant. Sulltanin mund ta adhurojnë vetëm skllevërit. Dëshmorët mbeten të pavdekshëm:

*O hije t'shenjta Boçar, Josif, Kanar  
ajo do t'ua ndiej zërat nga vdekja vrrarë  
dhe shenjën do ta shoh ballit tuaj bërë  
një këngë të paligjshme do t'u sjellë  
t'gjakosurve lavdinë dy herë  
me harp e lahutë dy Greqitë kanë për të thënë:  
O ju të shenjtat, madhështore, viktima  
të hakmarrjes! O ju apostuj! në luftim  
krahu juaj në çdo kohë është shquar.*

---

1) Victor Hugo, *Les Orientales*, f. 29.

*Ju vdiqët që të tre nga e poshtra dorë  
Për Termopilat tuaj mbetët karakoll  
ju për to, s'kursyet gjakun e kulluar,<sup>1</sup>*

Në veprën e tij «Këngët e muzgut» botuar në vitin 1835, Hygoi rikujton Boçarin në poemën e dytë kushtuar Kostandin Kanarit. Jemi në periudhën kur dinastia e Bourbonëve në Revolucionin e Korrikut (1830) është përmbysur dhe është zëvendësuar me atë të Orleanit (1830-1848). Pushtetin e kanë shtënë në dorë bankierët dhe financierët, masat rënkojnë nën një shtypje të re, borgjezia është turrrur pas parasë dhe duket sikur çdo ideal mungon:

*Greqia, Athina!*

*Sparta Leonidha! Boçari! Demosteni!*

*Kanari, gjysmëperëndi nga lavdia ndritur!...<sup>2</sup>*

Athina dhe Sparta përfaqësojnë luftën heroike të grekëve kundër persianëve, Leonidha është heroi i mbrojtjes së ngushticës së Termopileve, i rënë si fatos me 300 spartanët e vet. Demosteni është luftëtari konsekuent i mbrojtjes së Athinës nga pushtuesit maqedonas me në krye Filipin II dhe Aleksandrin. Marko Boçari është lavdia e Mesolongjit, mbrojtës dhe shpëtimtar i revolucionit dhe i qytetërimit.

Hygoi flet për Marko Boçarin edhe në veprën e tij madhore «Të mjerët», botuar për herë të parë në vitin 1862. Si shkrimtar që simbolizon progresin e njeriut, në veprat e veta ai i bën një analizë të thellë rolit përparimtar të Revolucionit Francez (1789-1794). Hygoi thekson se ky revolucion i hapi horizonte të reja njerëzimit, sepse idetë e tij u përhapën në mbarë botën. Kryeqyteti i atdheut të tij, Parisi, u bë zemra, rreth së cilës u mblodh e tërë Franca revolucionare. Për këtë rol të lavdishëm të kryeqytetit shkrimtari flet me krenari: «Ai është i madhërishtëm, ai ka një 14 korrik», ditën e përmbysjes së regjimit absolut

1) Victor Hugo, Les Orientales, f. 29.

2) Les Chants du crépuscule, f. 120.

në Francë. Të gjitha lëvizjet revolucionare në botë kanë ndikimin e iluminizmit francez dhe të Revolucionit të madh të tij. Lufta për pavarësinë e kolonive angleze në Amerikën e Veriut në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, që shpuri në shpalljen e fitoren e shtetit të pavarur (SHBA), Xhorxh Uashington (1732-1799), presidenti i parë i atij vendi; Kostjushko (1746-1877), heroi i popullit polak në luftën për pavarësinë kundër carizmit rus; venezeluani Bolivari (1783-1830), udhëheqës i luftës për pavarësinë e vendeve të Amerikës latine kundër pushtuesit spanjoll, që arriti të mposhtë armikun por që nuk shpuri në bashkimin e pjesës jugore e qendrore të kontinentit amerikan në një shtet të vetëm; Boçari, fatosi më fisnik i Revolucionit Grek; Riego (1785-1823), heroi i Revolucionit Spanjoll të viteve 1820-1823, autori i marshit «Himni i Riegos»; Manini (1804-1857), presidenti i Republikës së Venedikut (1848-1849), themeluar në luftën kundër Perandorisë Austriake; Françesko Solano Lopezi (1827-1870), burrë shteti i Paraguit, mbrojtës i vendit nga koalicioni i Brazilit, Argjentinës dhe Uruguajit të mbështetur nga Anglia. Franca dhe SHBA në luftën kundër të cilit edhe u vra: Xhon Brausi (1800-1859), kryengritësi për çlirimin e zezakëve nga skllavëria në SHBA dhe që u ekzekutua; Garibaldi (1807-1882), heroi i krijimit të shtetit të bashkuar italian me luftën e paepur kundër pushtuesit të huaj, të gjithë këta burra dhe këto lëvizje kanë patur frymëzimin e iluminizmit francez dhe pjellës së tij të natyrshme — revolucionit.

Kështu Hygoi e vendosi Marko Boçarin në panteonin e heronjve më të mëdhenj të kohës së re, madje në radhët e para të tyre. Të gjithë këta burra të shquar ishin republikanë, demokratë, të gjithë revolucionarë. Hygoi ashtu sikurse Bajroni e urrente monarkinë dhe pëlqente republikën demokratike. Dhe heronjtë e mësipërm, përfshirë dhe Marko Boçarin, ishin frymëzuar nga Republika Franceze e Revolucionit dhe jo nga Napoleoni. Ata nuk janë vetëm atdhetarë të vendit të tyre, por edhe revolucionarë botërorë. Sinas Hygoit Revolucionin Francez krijoi Kostandin Kanarin, Marko Boçarin. Në luftën për liri, ata

i shtyu fryma e Parisit. Dhe virtyti themelor i këtyre heronjve është guximi. Heroi i vendit dhe i popullit të vet, pohon Hygoi, është ai që guxon, guximtari. Guximi është drita që u hap sytë dhe mendjen masave, ai çon në kthesën e madhe të shoqërisë njerëzore. «Të guxosh, përparimi fitohet vetëm me këtë çmim».<sup>1</sup>

Hygoi nuk mohon rolin e teorisë revolucionare por kjo, sipas tij, vetëm na i përgatit revolucionet. Guximtarët e pashoq janë ata që i çojnë në fitore. Gjithë fitoret njerëzore, i tërë progresi i arritur është vetëm çmimi i guximit. Dhe guximtarët nuk janë mercenarët, aventurierët, por ata që luftojnë për-çështjen e drejtë dhe vdesin pa u trembur për të. «Të orvatesh t'i vësh gjoksin rrezikut, të ngulësh këmbë, të shkosh gjer në fund, të jesh besnik i vetvetes, të kapesh fytazi me fatin, ta mahnitësh katastrofën, duke i treguar se s'ia ke frikën dhe, nga ana tjetër; t'i bësh ballë fuqisë së padrejtë, t'i qëndrosh si trim, të përballosh gjithçka, ja ky është shembulli për të cilin popujt kanë nevojë, kjo është drita që i elektrizon.»<sup>2</sup>

I tillë për Hygoin kishte qenë revolucionari francez Zhorzh Zhak Dantoni, të cilin të nesërmen e Kryengritjes së 10 Gushtit 1792, që rrëzoi mbretin Luigji XVI, Asambleja Legjislative e zgjodhi ministër të Drejtësisë. Para dyndjes së ushtrisë prusiane që gjendej në dyert e Parisit, Dantoni vuri re se qeveria revolucionare anonte nga mendimi që ta linte kryeqytetin dhe të vendosej në ndonjë qytet të krahinës së Luarës, por ai kundërshtoi dhe shpalli para Asamblesë së për të mposhtur armikun duhej «guxim, guxim, gjithnjë guxim dhe Franca shpëton». Ajo shpëtoi e armiku u thye.

Për Hygoin në kategorinë e guximtarëve të mëdhenj bënte pjesë edhe Marko Boçari që me gjakun e tij kishte shpëtuar Mesolongjin dhe Kryengritjen Greke për pavarësi. Në çastet e fundit të jetës së tij ai kishte deklaruar: «Mos harroni se asnjë popull nuk mund të fitojë pavarë-

1) Viktor Hugo, Të mjerët, vëll. II, f. 162-163.

2) Po aty, vep. e cit., f. 163.

sinë e vet dhe nuk mund t'i këpusë prangat veçse me çmimin e vetëmohimit dhe të gjakut të një numri të madh bijsh të tij». <sup>1</sup> Ai i kishte hedhur të gjithë zarët menjëherë <sup>2</sup>, thotë për Boçarin eparku i atëhershëm i Mesolongjit, Kostandin Metaksaj. Boçari nuk kishte pritur vendimet e qeverisë. Para rrezikut imediat ai kishte guxuar, kishte dërrmuar armikun dhe e kishte shpëtuar pavarësinë e Greqisë. Pritja do të ishte vdekje. Për Hygoin që shpallte se vdekja për liri ishte fati më i bukur, Marko Boçari guximtar ishte një Danton në rrethanat dhe kushtet e Revolucionit Grek. Ndryshimi qëndronte se Dantoni në fund të fundit u vra nga vetë revolucioni, Markoja ishte flijuar për të.

Hygoi, Boçarin e vendos jo vetëm krahas Leonidhës së lashtë, por edhe luftëtarëve të kohës së re Kostjushkos, Bajronit, suliotit shqiptar, Kiço Xhavellës. Ai nuk e harron kalvarin e Mesolongjit të pushtuar. Tiranët lë të fërkojnë duart, hakmarrja e popullit nuk do të mungojë, e ardhmja nëpërmjet guximtarëve si Boçari u përket punonjësve. Hygoi ishte i bindur se e mira dhe e bukura një ditë do të ngadhënjë nëpërmjet osmozës popull-hero.

*«Para këmbëve të fatit kaq të madh,  
Pa pritur Boçari do të sulmojë sallën,  
Do të ngrihet më këmbë Bajroni, poeti hero,  
Xhavella i xhindosur nga fitorja e xhelatëve  
Do të qëllojë turmën e tmerruar nga sukseset».*

Në veprën «Vite të kobshme» kushtuar demaskimit të Napoleonit III, Hygoi vazhdon të mos e ndajë Boçarin nga Bajroni. Flijimi i tij lidhet ngushtë me atë të anglezit të madh. «Kur humbet Boçari, kur vdes Bajroni» <sup>3</sup>, liria nuk mund të zhduket, ajo shpërthen me sulm të ri dhe të pandalshëm. Me një forcë edhe më të madhe Hygoi e për-

1) Brûnët de Presle, *vep. e cit.*, f. 182.

2) Const. Metaxas, *Souvenirs de la guerre de l'indépendance de la Grèce*. Paris, 1885, f. 169.

3) Victor Hugo, *Années Funestes*, f. 53.

mend Marko Boçarin në veprën «Viti i tmerrshëm» (1870), viti i humbjes së luftës së Francës kundër prusianëve, i pushtimit të saj por edhe i përpjekjeve për riorganizimin e qëndresës. Francezët në këtë rast duhet të marrin shembull nga heronjtë e mëdhenj, përfshirë edhe Boçarin, i cili shkon në betejat me hare.

*Kur me treqind burra të pjekur apo të mitur,  
Leonidha shkon të vdesë në Termopilet,  
Kur shpërthen Boçari... kur mbrrin Bolivari  
kur Garibaldi...<sup>1</sup>*

liria është në prag të derës, njerëzit do të ngazëlleen, zemrat e tyre do të rrahin me gëzim.

Adhurimi i Hygoit për Marko Boçarin është ai për lirinë e popujve. Si luftëtarë të paepur për gjënë më të shtrenjtë, lirinë e vërtetë kombëtare dhe shoqërore, për progresin njerëzor, Hygoi dhe Boçari nuk ishin bij të lavdishëm vetëm të popujve të tyre, por të rruzullit mbarë.

\*  
\*  
\*

Flijimi i Markos ishte kënga melodioze që mjelma, sipas legjendës, e këndon në çastet e fundit të jetës së saj. Ai u tha revolucionarëve mbarë: Unë vdes por edhe këndo. Megjithatë botës së përparuar të atëhershme i erdhi shumë keq për vdekjen e tij. Lavdi dhe dhimbje njëkohësisht. «Mors acerba», «vdekja është e hidhur», thuhej në periudhën e Rilindjes evropiane perëndimore, por kur ajo bëhej për liri dhe për ditë më të bardha shtohesh: «Gloria perpetua», «Lavdia është e përjetshme». Heroi i rënë për lirinë e popujve gjen vdekje të ëmbël dhe mirënjohje të paharruar. Kështu edhe për Marko Boçarin. Studiuesi grek Spiro Llambro shkruante më 1898 për rëndësinë e fjalorit greqisht-shqip të Marko Boçarit: «Unë

1) Victor Hugo, *L'année terrible*, Paris, 1971, f. 22.



shpresoj se botimi i këtij dorëshkrimi të Boçarit do të kontribuojë sidomos në afrimin më të ngushtë të lidhjeve vëllazërore të shqiptarëve dhe helenëve, të cilët prej shekujsh janë shquar për bashkëpunim midis tyre». <sup>1</sup> Atëherë, ç'mund të thuhet për luftën dhe gjakun e derdhur prej Marko Boçarit për lirinë e Greqisë? Jeta dhe vepra e tij do të mbeten një simbol ku do të mbështetet dhe do të fuqizohet miqësia midis dy popujve. Për këtë flet historia, ky kandil i pashuar i popujve.

---

1) Cituar nga Ilo Mitkë Qafëzezi; AIH, D, nr. 11, pjesa 4.

## PËRMBAJTJA

1. Suli dhe suliotët .....	3
2. Rinia .....	19
3. Marko Boçari dhe Ali Pasha .....	36
4. Mesolongji. Fitorja .....	68
5. Mesolongji. Fitorja dhe flijimi .....	80
6. Taktika .....	112
7. Rilindasit shqiptarë dhe Marko Boçari .....	118
8. Poetë të mëdhenj për Marko Boçarin .....	127